




HARUN JAHJA

# FATKEQËSITË QË SOLLI DARVINIZMI PËR NJERËZIMIN



**S**hekulli i njëzetë, të cilin sapo e kemi lënë pas, ishte shekull lufrtrash e konfliktesh, që çuan në katastrofa, dhimbje, masakra, varfëri e shkatërrime të pallogaritshme. Miliona njerëz u vranë, u masakruan, u braktisën e u lanë në kthetrat e urisë e të vdekjes, në mëshirë të fatit, pa shtëpi a një vend ku të fusnin kokën, pa mbrojtje apo mbështetje. Të gjitha këto: në emër të disa ideologjive të gabuara. Pothuajse të gjitha vuajtjet dhe katastrofat mbajnë vulën e tiranëve dhe diktatorëve: Stalin, Lenin, Trocki, Mao Ce Dun, Pol Pot, Hitler, Musolin, Franko...

Për arsyen e thjeshtë se ideologjitë e tyre binin në kundërshtim me njerëz-tjetrën, ata e zhytën shoqërinë njerëzore në konflikte dhe nxitën vëllavrasjen.

Fashizmi dhe komunizmi zënë vendin e parë në listën e ideologjive që i bënë njerëzit të vuajnë ato ditë të zeza. Këto ideologji konsiderohen armike të përbeutara të njerëz-tjetrës, por e vërteta është se ato ushqeheshin nga një burim i vetëm. Falë tij, ato ishin në gjendje të bënin për vete një pjesë të madhe të shoqërive ku u shfaqën. Ky burim s'ë ka tërhequr kurrë vëmendjen e opininit publik, por ka qëndruar gjithmonë në prapaskenë dhe u ka treguar përherë njerëzve fytyrën e tij, në dukje, të pafajshme. Ky burim është filozofia materialiste dhe »përshtatja në natyrë e saj«, e cila njihet me emrin **DARVINIZEM**.

Nëse njerëzimi do të kuptojë mungesën e bazës shkencore të kësaj teorie, kjo do shënojë fundin e këtyre ideologjive të dëmshme. Në të njëjtën kohë, edhe ata që bëjnë keq nuk do të kenë më mbështetje të ashtuquajtur shkencore për botëkuptimin e tyre egoist.



**RRETH AUTORIT:** Autori, i cili shkruan me pseudonimin Harun Jahja, ka lindur në Ankara në vitin 1956. Ka studiuar artet në universitetin Mimar Sinan të Stambollit, si dhe filozofi në Universitetin e Stambollit. Që nga viti 1980, autori ka publikuar libra të shumtë në fusha të ndryshme, si ato politike, fetare dhe shkencore. Harun Jahja njihet si një autor që ka shkruar punime tepër të rëndësishme për të nxjerrë në shesh mashttrimet e evolucionistëve, pavlefshmërinë e pretendimeve të tyre, si dhe anët e errëta që lidhin Darwinizmin me disa

ideologji shkatërrimtare. Shumë prej librave të tij janë përkthyer në Anglisht, Gjermanisht, Frengjisht, Italisht, Spanjisht, Portugalisht, Shqip, Arabisht, Polonisht, Rusisht, Boshnjakisht, Indonezisht, Tatarisht, Urdu dhe Malaj. Librat e Harun Jahjas u drejtohen të gjithë njerëzve, muslimanëve dhe jomuslimanëve, pavarësisht nga raca, mosha e kombësia, sepse ata përqendrohen në një qëllim të vetëm, i cili është zgjerimi i diapazonit të mendjes së lexuesve nëpërmjet paraqitjes së shenjave të ekzistencës së përvetshme të Zotit.

بسم الله الرحمن الرحيم

---

FATKEQËSITË  
QË SOLLI  
DARVINIZMI  
PËR NJERËZIMIN



HARUN JAHJA

2003

## Rreth autorit dhe veprave të tij

Autori, i cili shkruan me pseudonimin HARUN JAHJA, ka lindur në Ankara në vitin 1956. Pasi mbaroi shkollën tetëvjeçare dhe të mesme në Ankara, ai studioi artet në universitetin Mimar Sinan të Stambollit, si dhe filozofi në Universitetin e Stambollit. Që nga viti 1980, autori ka publikuar libra të shumtë në fusha të ndryshme, si ato politike, fetare dhe shkencore. Harun Jahja njihet si një autor që ka shkruar punime tepër të rëndësishme për nxjerrë në shesh mashtimet e evolucionistëve, pavlefshmërinë e pretendimeve të tyre, si dhe anët e errëta që lidhin Darwinizmin me disa ideologji shkatërrimtare.

Pseudonimi i tij përbëhet nga emrat "Harun" (Aron) dhe Jahja (Gjon), për të përkujtuar këta dy profetë që luftuan kundër mosbesimit. Vula e Profetit, e cila gjendet në kapakun e librave të autorit përmban një kuptim simbolik që ka lidhje me përmbajtjet e tyre. Kjo vulë përfaqëson Kuranin, i cili është libri dhe fjala e fundit e Zotit dhe Profetin, i cili është profeti i fundit. Nën udhëheqjen e Kuranit dhe Sunetit, autori ka për qëllim të hedhë poshtë të gjitha bazat e ideologjive anti-fetare, në mënyrë që të shuhet të gjitha kundërshtimet ndaj fesë.

Të gjitha këto punime të autorit përqendrohen rreth një qëllimi: transmetimi i mesazhit të Kuranit për të gjithë njerëzit, duke i nxitur ata të mendojnë rreth temave të rëndësishme që kanë lidhje me besimin, si ekzistenca e Zotit, njësimi i Tij, bota tjetër etj., dhe shkatërrimi i plotë i themeleve të rrënuara të sistemeve ateiste.

Harun Jahja gëzon një reputacion të madh në një gamë mjaft të gjerë lexuesish që nga India në Amerikë, nga Anglia në Indonezi, nga Polonia në Bosnje, nga Spanja në Brazil. Disa prej librave të tij janë të disponueshëm në Anglisht, Frengjisht, Gjermanisht, Italisht, Portugalisht, Urdu, Arabisht, Shqip, Rusisht, Boshnjakisht dhe Malajo; ata janë mirëpritur nga lexuesit në të gjithë botën.

Të vlerësuar në të gjithë botën, këto punime kanë shërbyer për të ndihmuar shumë njerëz të gjejnë rrugën e besimit apo të arrijnë një kuptim më të thellë të besimit të tyre. Stili i qartë, i lehtë dhe i rrjedhshëm i këtyre librave u jep atyre disa veçori karakteristike që mund të vihen re nga kushdo që i lexon apo i shqyrton ato. Këto punime kanë pasur një ndikim të shpejtë dhe rezultate tepër të kënaqshme. Është e pamundur për ata persona, që i lexojnë këto libra me kujdes dhe mendojnë rreth tyre seriozisht që të vazhdojnë të mbrojnë filozofinë materialiste, ateizmin apo çfarëdo ideologjie apo filozofie shkatërrimtare. Edhe nëse ata vazhdojnë mbrojtjen, kjo tregon se ata bazohen në sentimentalizmin e tyre, pasi këto libra i hedhin poshtë këto ideologji që nga themelet. Sot është bërë e mundur që të gjitha lëvizjet bashkëkohore jobesimtare të pësojnë një disfate ideologjike, në saj të koleksionit të librave të shkruar nga Harun Jahja.

S'ka dyshim se këto veçori e kanë origjinën nga urtësia dhe udhëzimi i Kuranit. Autori sigurisht që nuk ndihet krenar për veten e tij; ai synon që të jetë një mjet që ndihmon të tjerët për të gjetur rrugën e drejtë të Zotit. Për më tepër, ai nuk merr asnjë përfitim material nga librat e tij. Edhe ata që përgatisin këto libra nuk marrin asnjë përfitim material. Ata duan vetëm të fitojnë kënaqësinë e Zotit.

Duke pasur parasysh këto fakte, ata që inkurajojnë njerëzit që të lexojnë këto libra, të cilët hapin sytë e zemrës dhe ndihmojnë të tjerët të bëhen adhurues të devotshëm të Zotit, bëjnë një shërbim të paçmueshëm për fenë.

Nga ana tjetër, do të ishte humbje kohe dhe energjie përhapja e atyre librave që krijojnë konfuzion në mendjet e njerëzve dhe nuk kanë ndonjë ndikim të efektshëm në largimin e dyshimeve dhe dilemave nga zemrat e tyre, siç e ka vërtetuar dhe eksperiencia shumëvjeçare. Është më se natyrshme që libra të tillë që janë shkruar më tepër për të theksuar forcën letrare të autorit të tyre, sesa për të fituar kënaqësinë e Zotit, nuk mund të kenë kurrë një efekt pozitiv. Ata që dyshojnë në këtë, mund të shohin se qëllimi i vetëm i librave të Harun Jahjas është triumfi ndaj mosbesimit dhe përhapja e vlerave morale të Kuranit.

Nuk duhet të harrojmë një pikë shumë të rëndësishme: Shkaku kryesor i vazhdimit të problemeve dhe konflikteve që përballojnë muslimanët sot është ndikimi ideologjik i mosbesimit. Të gjitha këto do të marrin fund kur të arrihet disfata ideologjike e mosbesimit dhe të sigurohemi që çdo njeri i njeh mrekullitë e krijimit dhe moralin kuranor, në mënyrë që të gjithë njerëzit të jetojnë me frymën e tyre. Duke marrë në konsideratë gjendjen e botës sot, e cila i çon njerëzit në një humnerë të thellë dhune, korrupsioni dhe konfliktesh, është e qartë që ky shërbim duhet të jetë i diponueshëm sa më shpejt dhe sa më efektivisht që të jetë e mundur. Përndryshe, mund të jetë shumë vonë.

Ne shpresojmë që me Vullnetin e Zotit, librat e Harun Jahjas do të luajnë këtë rol tepër të rëndësishëm në shekullin XXI dhe do të ndihmojnë njerëzit të fitojnë paqen, bekimin, drejtësinë dhe lumturinë e premtuar në Kuran.

Titulli i originalit  
The Disasters Darwinism Brought to Humanity  
www.harunyahya.com

Të drejtat e botimit në gjuhën shqipe janë të rezervuara për

**Alb-Books ©**



**gërkimeu**

Violeta SHABA

**Redaktoi**

Edvin CAMI

**Korrekttoi dhe recensoi**

Kujtim EREQI

**Shqipëri:**

Libraria tek rruga Islam Alla,  
pranë xhamisë së Dine Hoxhës  
tel. 00355 (0) 682236306

**Maqedoni:**

"Furkan ISM"- Shkup  
Tel.: 00389 2 622360  
Faks: 00389 2 622393

E-mail: alb\_books@yahoo.com  
Alb-Books is a logo of Furkan ISM

Shtypur nga:  
Nesil Matbaacilik  
Istanbul / Turkey

h a r u n y a h y a . c o m

# Përmbajtja



*Hyrje: Shkaktarët e  
vuajtjeve në shekullin XX*

5



*Një histori e shkurtër e Darwinizmit*

8



*Racizmi dhe tendencat  
kolonialiste të Darwinit*

19



*Aleanca e tmerrshme midis  
Darvinit dhe fashizmit*

48



*Darvinizmi, burimi i  
barbarisë komuniste*

78



*Kapitalizmi dhe lufta për  
mbijetesë në ekonomi*

109



*Rrënimi moral që solli Darwinizmi*

117



*Përfundimi: Moçali i  
Darvinizmit duhet tharë*

124

## Shkaktarët e vuajtjeve në shekullin XX



**S**hekulli i njëzetë, të cilin sapo e kemi lënë pas, ishte shekull luftrash e konfliktesh, që çuan në katastrofa, dhimbje, masakra, varfëri e shkatërrime të pallogaritshme. Miliona njerëz u vranë, u masakruan, u braktisën e u lanë në kthetrat e urisë e të vdekjes, në mëshirë të fatit, pa shtëpi a një vend ku të fusnin kokën, pa mbrojtje apo mbështetje. Të gjitha këto: në emër të disa ideologjive të gabuara. Pothuajse të gjitha vuajtjet dhe katastrofat mbajnë vulën e tiranëve dhe diktatorëve: Stalin, Lenin, Trock, Mao Ce Dun, Pol Pot, Hitler, Musolin, Franko... Disa prej këtyre diktatorëve i bashkonte një ideologji, ndërsa disa të tjerë ishin armiq për vdekje. Për arsyen e thjeshtë se ideologjitë e tyre binin në kundërshtim me njëra-tjetrën, ata e zhytën shoqërinë njerëzore në konflikte, nxitën vëllavratjen, i futën njerëzit në luftë me njëri-tjetrin, i bënë të hedhin bomba, të djegin shtëpi, të dalin në demonstrata të pakontrolluara, të rrihnin pa mëshirë të rinjtë, të vjetrit, gratë, burrat e fëmijët, të pushkatonin të pafajshmit... Ishin aq mizorë sa ia vinin armën në kokë dikujt dhe, duke e parë në sy, e vrisnin e më pas ia shkelnin trupin me këmbë, vetëm e vetëm se ai përkrahte një ide tjetër.

Kjo është një përmbledhje e shkurtër e tmerreve të shekullit XX që sapo e kemi lënë pas: njerëz që mbështetnin ide të papajtueshme e që e mbytën njerëzimin në dhembje e gjak për të mbështetur këto ideologji. Fashizmi dhe komunizmi zënë vendin e parë në listën e ideologjive që i bënë njerëzit të vuajnë ato ditë të zeza. Këto ideologji konsiderohen armike të përbetuara të njëra-tjetrës, por e vërteta është se ato ushqeheshin nga një burim i vetëm. Falë tij, ato ishin në gjendje të bënin për vete një pjesë të madhe të shoqërive ku u shfaqën. Ky burim s'ë ka tërhequr kurrë vëmendjen e opininit publik, por ka qëndruar gjithmonë në prapaskenë dhe u ka treguar përherë njerëzve fytyrën e tij, në dukje, të pafajshme. Ky burim është filozofia

materialiste dhe "përshtatja në natyrë e saj", e cila njihet me emrin **DARVINIZEM**.

Darvinizmi u shfaq në shekullin XIX si përforsim i një miti, që i kishte rrënjët nga samerianët dhe grekët e lashtë, prej biologut amator Çarls Darvin. Që prej asaj kohe, Darwinizmi ka përbërë idenë themelore të gjitha ideologjive që i kanë shkaktuar kaq shumë fatkeqësi njerëzimit. Nën një maskë të ashtuquajtur shkencore, ai bëri të mundur që këto ideologji dhe masat praktike të marra nga mbështetësit e tyre të fitojnë një ligjshmëri të rreme. Me anë të kësaj ligjshmërie të rreme, teoria e evolucionit shumë shpejt u nda nga shkencat e biologjisë apo paleontologjisë dhe filloi të futej në fusha të tjera, si historia, politika, jeta shoqërore etj. Meqë disa prej pretendimeve të Darwinizmit mbështesnin një sërë rrymash, që filluan të formohen në shekullin XIX, ai fitoi mbështetjen e gjerë të ndjekësve të këtyre rrymave. Në mënyrë të veçantë, njerëzit filluan të formonin idenë se ekziston "një luftë për mbijetesë" mes qenieve të gjalla në natyrë dhe, si rrjedhim, ideja se "i forti mbijeton dhe të tjerët humbin e shkojnë drejt zhdukjes" filloi të përdorej edhe për mendimin dhe sjelljen njerëzore. Kur pretendimi i Darwinizmit, se natyra është një vend përleshjesh e konfliktesh, nisi të vlejë edhe për qeniet njerëzore, trilli i Hitlerit për të krijuar një racë superiore, pretendimi i Marksit se "historia e njerëzimit është historia e luftës së klasave", ideja kapitaliste që "i forti bëhet më i fortë në kurriz të më të dobët", kolonizimi i vendeve të botës së tretë nga vendet imperialiste dhe trajtimi i tyre në mënyrë çnjerëzore, bashkë me faktin që njerëzit me ngjyrë ende përballen me sulme e diskriminime racore, që të gjitha këto gjetën njëfarë justifikimi.

Pavarësisht se edhe vetë është evolucionist, Robert Rait (Robert Wright), autor i librit "The Moral Animal", i përmbledh katastrofat që i ka sjellë historisë së njerëzimit teoria e evolucionit në këtë mënyrë:

Teoria evolucioniste, në fund të fundit, ka një histori të gjatë e mjaft të ndyrë në zbatimin praktik të saj në çështjet njerëzore. **Pasi u përzie me filozofinë politike në mbarim të shekullit XIX, për të formuar ideologjinë**

**e njohur si "Darvinizmi Social", ajo u shndërrua në lodër në duart e racistëve, fashistëve dhe kapitalistëve më të pashpirt.<sup>1</sup>**

Siç do të shikojmë në këtë libër, Darwinizmi nuk është thjesht një teori që tenton të shpjegojë prejardhjen e jetës e që nuk del jashtë fushës së njohurive shkencore. Darwinizmi është një dogmë që mbrohet ende me kryeneçësi nga mbështetës të ideologjive të caktuara, megjithëse është krejt e pavlefshme nga pikëpamja shkencore. Në ditët tona, shumë shkencëtarë, politikanë dhe ideologë, pavarësisht nëse janë apo jo të vetëdijshëm për fytyrën e vërtetë e të ligë të Darwinizmit, i ofrojnë mbështetjen e tyre kësaj dogme. Nëse njerëzimi do të kuptojë mungesën e bazës shkencore të kësaj teorie, që shërben si burim frymëzimi për diktatorë mizorë dhe rryma mendimi të pamëshirshme dhe egocentrike, kjo do shënojë fundin e këtyre ideologjive të dëmshme. Të ligët nuk do të jenë në gjendje të vetëmbrohen duke thënë: "*Ky është ligj i natyrës*". Ata nuk do të kenë më mbështetje të ashtuquajtur shkencore për botëkuptimin e tyre egoist. Kur të përmbysen ideja e Darwinizmit, rrënja e ideologjive të dëmshme, vetëm një e vërtetë do të mbetet: Të gjitha qeniet njerëzore dhe vetë universi janë krijuar prej Zotit. Njerëzit që do të kuptojnë këtë, do të kuptojnë, gjithashtu, se e vetmja e vërtetë gjendet në librin e shenjtë që Ai na ka zbritur neve. Kur shumica e njerëzve ta kuptojnë këtë të vërtetë, vendin e dhimbjes, shqetësimeve, padrejtësive dhe varfërisë në botë do ta zërë, ndershmëria, mirëqenia, shëndeti dhe begatia. Për të arritur këtë, çdo ide e gabuar dhe e dëmshme për njerëzimin duhet të mposhtet e të lihet të kalbet nga ideja e shenjtë që do të sjellë mirësi për njerëzit.

Qëllimi i këtij libri është t'u tregohet atyre që e mbrojnë Darwinizmin pa e njohur anën e tij të errët, se çfarë janë duke mbështetur në të vërtetë dhe, në të njëjtën kohë, t'u sqarohet se çfarë përgjegjësie mbajnë, nëqoftëse pretendojnë se nuk e shohin realitetin e vërtetë të tij. Një tjetër qëllim është që të paralajmërohen edhe ata që nuk e besojnë Darwinizmin, por nuk e konsiderojnë si një rrezik që i kanoset njerëzimit.

## *Një histori e shkurtër e Darwinizmit*

**P**ara se t'u kthehemi vuajtjeve dhe fatkeqësive që i ka sjellë botës Darwinizmi, po i hedhim një vështrim të shpejtë historisë së tij. Shumë njerëz besojnë se teoria e evolucionit, e paraqitur për herë të parë nga Çarls Darvini, është teori e mbështetur në prova të forta shkencore, vëzhgime e eksperimente. Por, meqë themeluesi i vërtetë i teorisë së evolucionit nuk është Darvini, burimi i teorisë nuk përbën provë shkencore. Dikur në Mesopotami, kur sundonin fetë pagane, bestytnitë dhe mitet rreth zanafillës së jetës dhe universit ishin të shumta: njëra prej tyre ishte besimi "evolucion". Sipas eposit *Enuma-Elish*, që i përket periudhës së samerianëve, kishte ndodhur një përmbytje e furishme dhe nga kjo lindën, papritur, perënditë e quajtura *Lahmu* dhe *Lahamu*. Sipas bestytnive, këto perëndi në fillim krijuan vetveten e më vonë, pasi u bënë universale, krijuan substanca dhe krijesa të tjera të gjalla. Me fjalë të tjera, sipas mitit samerian, jeta evoluoi dhe u zhvillua nga kaosi uxor i pajetë.

Siç shihet, ky besim tregon një përputhje të madhe me pretendimin e teorisë së evolucionit se "gjallesat u krijuan dhe evoluan nga jo-gjallesat". Nga kjo kuptojmë se ideja e evolucionit nuk e ka origjinën nga Darvini, por nga paganët samerianë. Më vonë, miti i evolucionit, gjeti më shumë hapësirë për t'u shtrirë në një qytetërim tjetër pagan, Greqinë e Lashtë. Filozofët e lashtë materialistë grekë e konsideronin materien si të vetmen gjë që ekzistonte. Ata iu kthyen mitit të evolucionit, trashëgim i samerianëve, për të shpjeguar se si lindën gjallesat. Në këtë mënyrë, filozofia materialiste dhe miti

i evolucionit u bashkuan në Greqinë e Lashtë. Që andej këto iu përcollën kulturës së Romë

Këto dy koncepte, që e kanë prejardhjen nga kulturat pagane, u shfaqën në botën moderne në shekullin XIX. Disa mendimtarëve evropianë që studionin burimet greke të lashta u hyri në qejf materializmi. Ajo çka i bashkonte këta mendimtarë ishte se ata ishin kundërshtarë të fesë.

Në këto rrethana, i pari që trajtoi teorinë e evolucionit në mënyrë të detajuar ishte biologu francez Lamark. Në teorinë e tij, që më vonë do të dilte e gabuar, Lamarku hodhi idenë që të gjitha gjallesat evoluon nga njëra-tjetra nëpërmjet ndryshimeve të vogla gjatë gjithë jetës së tyre. Një nga ata që përsëritën pretendimet e Lamarkut, me shumë pak ndryshime, ishte Çarls Darvini.

Darvini e paraqiti këtë teori në librin e tij "*Origjina e llojeve*", të cilin e botoi në Angli, më 1859. Në këtë libër, miti i evolucionit, që e kishte origjinën në Samerinë e lashtë, u paraqit i detajuar. Ai pretendonte se të gjitha llojet e gjallesave rrjedhin nga një paraardhës, i lindur në ujë rastësisht dhe se ato kanë evoluuar nga njëra-tjetra me ndryshime të vogla e të rastësishme.

Pretendimi i Darvinit nuk u pranua nga të gjithë shkencëtarët e asaj kohe. Ekspertët e fosileve në veçanti ishin të vetëdijshëm se pretendimi i Darvinit s'ishte gjë tjetër veçse pjellë e fantazisë, por pavarësisht nga kjo, teoria e Darvinit filloi të fitonte më shumë mbështetje nga qarqe të ndryshme me kalimin e kohës, sepse Darvini dhe teoria e tij siguruan bazën shkencore që u mungonte forcave që sunduan në shekullin XX.

## **Arsyeja e pranimi të**

### **Darvinizmit ishte ideologjike**

Në kohën kur Darvini botoi librin "*Origjina e llojeve*" dhe parashtroi teorinë e tij të evolucionit, shkenca ishte ende shumë prapa. Për shembull, qeliza, që sot dihet se ka një ndërtim mjaft të ndërlikuar, shihej vetëm si një njollë me anë të mikroskopëve primitivë që përdoreshin në atë kohë. Për këtë arsye, Darvini nuk e pati problem



**Një figurë që  
përshkruan Zotin  
samerian të ujit.  
Ashtu si samerianët,  
darwinistët besojnë  
se jeta lindi rastësisht  
nga uji. Me fjalë të  
tjera, ata e shohin  
ujin si zot që krijoi  
jetën.**

që të pretendonte se jeta u krijua rastësisht nga lënda e pajetë.

Në të njëjtën mënyrë, sasia e pamjaftueshme e fosileve të zbulura në atë kohë, bëri të mundur që të pretendohet se gjallesat ishin krijuar prej njëra-tjetrës me ndryshime shumë të vogla. Kurse sot, është e sigurtë që fosilet e gjetura, siç e shpjeguem më sipër, nuk ofrojnë asnjë lloj prove për të mbështetur pretendimin e Darvinit se gjallesat u krijuan duke u zhvilluar nga njëra-tjetra. Deri pak kohë më parë, evolucionistët e kapërcenin dilemën që u dilte përpara duke thënë: "Do të gjendet prova një ditë, në të ardhmen." Por tani ata nuk janë më në gjendje të fshihen pas këtij shpjegimi. (Shih kapitullin "Shkatërrimi i Evolucionit", në fund të librit. Ndërsa për informacione të mëtejshme shih librin "Gjunjézimi i Evolucionit" i të njëjtit autor, libër ky i botuar edhe në gjuhën shqipe)

Gjithësesi, lidhja e ngushtë mes darvinistëve dhe teorisë së evolucionit nuk ndryshoi. Përkrahësit e Darvinit kanë mbërritur deri në ditët tona duke ia lënë si trashëgim njëri-tjetrit besnikërinë e tyre ndaj Darvinit për 150 vitet e fundit.

Por cila është arsyeja që Darwinizmi ka bërë për vete disa qarqe të caktuara dhe pse i bëhet kaq shumë propagandë, pavarësisht nga fakti se mungesa e bazës shkencore tani është më se e dukshme?

Tipari më përcaktues i teorisë së Darvinit është mohimi i ekzistencës së një Krijuesi. Sipas teorisë së evolucionit, jeta krijoi vetveten, rastësisht, nga lëndë inorganike. Ky pretendim i Darvinit siguroi një mbështetje të rreme shkencore për të gjitha filozofitë ateiste, duke filluar nga filozofia materialiste. Kjo për arsien e thjeshtë se deri në shekullin XIX pjesa më e madhe e njerëzve të shkencës e

shihnin shkencën si metodë mësimi dhe zbulimi të asaj që Zoti kishte krijuar. Për shkak të përhapjes së gjerë të këtij besimi, filozofitë ateiste dhe materialiste nuk ishin në gjendje të gjenin terren për t'u zhvilluar, por, duke mohuar ekzistencën e një

krijuesi e duke krijuar një mbështetje imagjinare për besimet ateiste dhe materialiste, teoria e evolucionit ishte një mundësi e mrekullueshme për to. Ishte kjo arsyeja që ato gjetën veten tek Darwinizmi dhe e përshtatën teorinë me ideologjitë e tyre.

Përveç mohimit të ekzistencës së Zotit,

prej Darwinizmit doli edhe një pretendim tjetër për të mbështetur ideologjitë materialiste të shekullit XIX:



**Çarls Darvini**

"Zhvillimi i gjallesave lidhet me luftën e tyre për mbijetesë në natyrë. Këtë luftë e fiton më i forti. I dobtë është i destinuar të humbasë e të shkojë drejt zhdukjes." Bashkëpunimi i Darwinizmit me ideologjitë që kanë sjellë vuajtje dhe fatkeqësi në botë duket qartë në këtë pikë.



**Në krahasim me mikroskopët modernë, mikroskopët në shekullin XIX ishin shumë primitivë dhe, siç shihet në figurë, nëpërmjet tyre qelizat mund të shiheshin vetëm në trajtë njollash.**

## **Darvinizmi Social: përshtatja e ligjit të xhunglës në sjelljen njerëzore**

Një nga pretendimet kryesore të teorisë së evolucionit është bazimi i zhvillimit të gjallesave në "luftën për mbijetesë" në natyrë. Sipas Darvinit, në natyrë bëhet një luftë e pamëshirshme për mbijetesë, një konflikt i pashuar në jetë të jetëve. I forti gjithmonë e mposht të dobtin dhe kjo bën të mundur zhvillimin. Nëntitulli i librit "Origjina e llojeve" e përmbledhonte këtë pikëpamje: *"Origjina e qenieve të gjalla nëpërmjet seleksionimit natyror ose ruajtjes së racave të favorizuara në luftën për mbijetesë"*. Burimi i frymëzimit të Darvinit në lidhje me këtë çështje ishte libri i ekonomistit anglez Tomas Malthus, *"Esë mbi parimin e popullsisë"*. Ky libër tregonte se një e ardhme e zymtë e priste njerëzimin. Malthusi kishte llogaritur se po të mos ndërhyhej, popullsia njerëzore do të shtohet me një shpejtësi të llahtarshme. Shifrat do të dyfishoheshin çdo 25 vjet, por burimet ushqimore nuk do shtoheshin kurrësesi në të njëjtën masë. Po të ndodhte kjo, njerëzimi do të gjendej përpara rrezikut të përhershëm të urisë. Forcat që do ta mbanin popullsinë nën kontroll ishin fatkeqësitë si luftrat, zia e bukës, sëmundjet etj. Shkurt, që të jetonin disa njerëz duhej të vdisnin disa të tjerë. Ekzistencë do të thoshte "luftë e përhershme". Darvini pohon se ishte pikërisht libri i Malthusit që e bëri të mendonte për luftën për ekzistencë:

Në tetor, 1838, d.m.th. 15 muaj pasi kisha filluar kërkimet e mia sistematike, rastisi të lexoja për zbavitje librin e Malthusit mbi popullsinë dhe meqë isha përgatitur mirë për të vlerësuar luftën për ekzistencë që vazhdon kudo në sate të vëzhgimeve të gjata e të vazhdueshme të zakoneve të kafshëve dhe bimëve, menjëherë më shkoi në mendje që në këto rrethana, prireja është që llojet e favorizuara do të ruheshin, kurse ato të pafavorizuara do të zhdukeshin. Rezultati i kësaj do të ishte formimi i qenieve të reja. Më në fund kisha

një teori me të cilën të punoja.<sup>2</sup>

Në shekullin XIX, idetë e Malthusit ishin përqaftuar nga një publik i gjerë. Intelektualët evropianë të shtresave të larta i përkrahnin idetë e Malthusit. Rëndësia që Evropa e shekullit XIX i dha ideve të Malthusit mbi popullsinë duket qartë në artikullin "*Baza shkencore e programit nazist: Pastrimi i Racës*":

Në fillim të gjysmës së parë të shekullit XIX, kudo në Evropë, pjesëtarë të klasave sunduese mblidheshin për të diskutuar tok "problemin e popullsisë" të sapozbuluar e për të gjetur mënyra për zbatimin e urdhrit malthusian, për të rritur vdekshmërinë e të varfërve: "Në vend që t'u rekomandojmë pastërtinë të varfërve, ne duhet të nxisim zakonet e kundërta. Në qytetet tona ne duhet t'i bëjmë rrugët më të ngushta, t'i mbushim shtëpitë me më shumë njerëz e të ndjellim kthimin e murtajës. Duhet t'i ndërtojmë fshatrat tona pranë pellgjeve me ujë të ndenjur e veçanërisht të nxisim popullimin e vendeve moçalore e të dëmshme për shëndetin"... E kështu me radhë...<sup>3</sup>

Si rezultat i kësaj politike mizore, i forti do të mundte të dobtin në luftën për mbijetesë dhe, në këtë mënyrë, popullsia që shtoej me ritme të shpejta do të arrinte një ekuilibër të pranueshëm. Në Anglinë e shekullit XIX, programi "*Shtypni të varfrit*" u vu në zbatim me të vërtetë. U krijua një sistem industrial, ku fëmijët tetë-nëntë vjeçarë detyroheshin të punonin 16 orë në ditë në minierat e qymyrit e ku mijëra vdisnin nga kushtet e këqija. "Lufta teorike për mbijetesë" që për teorinë e Malthusit ishte e domosdoshme, detyroi miliona të varfër në Angli t'i nënshtroheshin një jete të mbushur me vuajtje.

Darvini, nën ndikimin e Malthusit, e vuri në zbatim këtë pikëpamje në të gjithë natyrën dhe propozoi që kjo luftë, e cila në fakt ekzistonte, do të fitohej nga më i forti e më i zoti (d.m.th. ai që përshtatej më mirë). Ky pretendim i Darvinit përfshinte të gjithë botën bimore, shtazore e njerëzore. Ai gjithashtu theksoi se kjo luftë për

mbijetesë ishte një ligj i përhershëm e i pandryshueshëm i natyrës. Duke mohuar krijimin, ai po ftonte njerëzit t'i braktisnin besimet e tyre fetare e në këtë mënyrë vinte në shënjestër të gjitha parimet etike që mund të përbënin pengesë për mizorinë e kësaj "lufte për mbijetesë". Për këtë arsye, teoria e Darvinit, gjeti mbështetjen e parisë së vendit, qysh nga momenti i parë, në fillim në Angli e më vonë në tërë perëndimin. Imperialistët, kapitalistët dhe materialistët e tjerë, të cilët e mirëpritën këtë teori që ofronte një justifikim shkencor për sistemin politik e shoqëror që kishin krijuar, nuk vonuan ta përqafojnë. Brenda një kohe të shkurtër, teoria e evolucionit u kthye në kriterin kryesor të vlerësimit në çdo sferë që ishte me interes për shoqëritë njerëzore, nga sociologjia te historia, nga psikologjia te politika.

Në çdo sferë, ideja bazë ishte motoja e "luftës për mbijetesë" dhe e "mbijetesës së më të fortit" dhe partitë politike, kombet, administratat, firmat tregtare dhe individët filluan të jetonin me frymën e këtyre motive. Për shkak se ideologjitë sunduese në shoqëri kishin gjetur veten te Darwinizmi, propaganda darviniste nisi të bëhej në çdo fushë, nga arsimi tek arti, nga politika te historia. U bënë përpjekje për të vendosur lidhje mes të gjitha fushave dhe Darwinizmit e të hidhej dritë mbi to nga një pikëpamje darviniste. Si rezultat i kësaj, edhe pse njerëzit mund të mos e njihnin Darwinizmin, filluan të formoheshin prototipa të shoqërisë që jetonin jetën e parashikuar nga Darwinizmi. Vetë Darvini sugjeroi që pikëpamjet e tij të bazuara në evolucion, të zbatoheshin te të kuptuarit etik dhe shkencat shoqërore. Në një letër drejtuar H. Thiel ai shkruan në vitin 1869:

**Do ta besosh lehtë se sa interes kam tek shoh që për çështjet morale dhe shoqërore ju përdorni pikëpamje të njëjta me ato që kam përdorur unë në lidhje me modifikimin e qenieve të gjalla. S'më kishte shkuar mendja kurrë më parë se pikëpamjet e mia mund të shtriheshin në fusha kaq të ndryshme e kaq të rëndësishme.<sup>4</sup>**

Me luftën në natyrë që pranohej se ekzistonte edhe në natyrën njerëzore, konfliktet në emër të racizmit, fashizmit, komunizmit e imperializmit dhe përpjekjet e popujve të fuqishëm për të shtypur popuj më të dobët kishin veshur tani petkun e shkencës.

Tashmë ishte bërë e pamundur të kritikoheshin apo të pengoheshin ata që kryenin masakra barbare dhe i nxisnin popujt kundër njëri-tjetrit, ata që i përbuznin të tjerët për shkak të racës së tyre, ata që i mbyllnin bizneset e vogla në emër të konkurrencës, apo ata që refuzonin t'u zgjasnin dorën për ndihmë të varfërve. Arsyeja ishte se ata po vepronin në përputhje me një ligj "shkencor" të natyrës. Ky shpjegim i ri shkencor u bë i njohur si **"Darvinizmi Social"**.

Një nga shkencëtarët më të rëndësishëm evolucionistë të kohëve tona, paleontologu amerikan Stefën Xhej Gould (Stephen Jay Gould) e pranon të vërtetën duke shkruar se pas botimit të librit *"Origjina e llojeve"* në vitin 1859, "argumentet e mëvonshme pro skllavërisë, kolonializmit, dallimeve raciale, luftës së klasave dhe rolit të seksit do të çanin përpara kryesisht nën flamurin e shkencës".<sup>5</sup>

Një pikë kërkon vëmendje të veçantë: Të gjitha periudhat e historisë së njerëzimit kanë njohur luftra, armiqësi, mizori, racizëm e konflikte, por asnjëherë nuk ka mungur një besim hyjnor që i mësonte njerëzit se ajo që po bënin ishte e gabuar dhe që i thërriste në paqe, drejtësi e qetësi. Për shkak se njerëzit e njihnin këtë fe hyjnore, të paktën e dinin mirë se ajo që po bënin kur përdornin dhunën, ishte e gabuar, por qysh prej shekullit XIX, Darwinizmi tregoi që lufta për përfitim dhe padrejtësi e kishte një farë justifikimi shkencor dhe sipas tij që të gjitha këto ishin pjesë e natyrës njerëzore. Ai tregoi që njeriu trashëgonte prirje për vepra mizore e agresivitet nga paraardhësit e tij dhe se, ashtu siç mbijetonte kafsha më e fortë e më agresive, të njëjtat ligje vlenin edhe për njeriun. Nën ndikimin e këtij arsyetimi, luftrat, vuajtjet dhe masakrat filluan të

shtrihen në një pjesë të madhe të botës.

Darvinizmi përkrahte dhe nxiste të gjitha ato lëvizje që sillnin dhimbje, gjak dhe shtypje në botë. Ai tregoi se ato janë të arsyeshme dhe të justifikueshme dhe i mbështeti të gjitha zbatimet në praktikë. Si rezultat i kësaj mbështetjeje pseudoshkencore, të gjitha këto ideologji të rrezikshme u përforcuan më shumë dhe u bënë shkas që shekulli XX të quhej "epoka e vuajtjeve".

Në librin e tij "Darvini, Marksi, Vagneri", profesori i historisë, Zhak Barzy (Jacques Barzun), analizon shkaqet shkencore, sociologjike dhe kulturore të rënies së tmerrshme morale në botën moderne. Këto komente nga libri i Barzysë janë mbresëlënëse po të nisemi nga ndikimi i Darwinizmit në botë:

... Në çdo vend evropian nga viti 1870 deri 1914

ekzistonte një parti lufte që kërkonte armatime, një parti individualiste që kërkonte konkurrencë të pamëshirshme, një parti imperialiste që kërkonte të kishte dorë të lirë



**Shtypje në të gjithë botën  
Bashkë me Darwinizmin u pranua edhe  
gënjeshtra se konflikti dhe lufta janë në  
natyrën e njeriut. Si rezultat i trishtë i  
kësaj, në shumë vende të botës luftrat,  
vrasjet e barbarizmi, u mbështollën me  
një petk pseudoshkencor dhe shekulli  
XX u kthye në një shekull vuajtjesh e  
mizorish ku s'ekziston mëshira.**



me popujt e prapambetur, një parti socialiste që kërkonte marrjen e pushtetit, si dhe një parti raciste që kërkonte të bëheshin spastrime të brendshme kundër të huajve - që të gjitha, kur thirrjet për ndihmë drejtuar lakmisë dhe lavdisë dështuan, ose edhe më parë, thirrën për ndihmë Spenserin dhe Darwinin, d.m.th mishërimin e shkencës... Raca ishte biologjike, ishte sociologjike, ishte darviniste.<sup>6</sup>

**Bilanci i dhim bshëm  
Sipas Darwinizmit Social,  
të dobtit, të varfrit, të  
sëmurët e të  
prapambeturit duhet të  
eliminohen e të shfarosen  
pa pikën e mëshirës. Këta  
njerëz besojnë se kjo  
është e domosdoshme për  
evoluimin e njerëzimit.  
Një nga arsyet pse në  
shekullin XX nuk u erdhi  
asnjë përgjigje thirrjeve të  
milionave njerëzve për  
ndihmë, nga Bosnja në  
Etiopi, ishte kjo ideologji  
që iu imponua shoqërive  
pa mëshirë.**



Në shekullin XIX, kur Darvini doli me pretendimin se gjallesat nuk ishin krijuar, se ato ishin shfaqur rastësisht dhe se njeriu kishte një paraardhës të përbashkët me kafshët dhe ishte organizmi më i zhvilluar si rezultat i rastësisë, shumica e njerëzve as që mund ta imagjinonin se cilat do ishin pasojat e këtij pretendimi, por në shekullin XX rezultati përfundimtar i pretendimit ishte përjetuar në mënyrë të tmerrshme. Ata që e shihnin njeriun si kafshë të zhvilluar, nuk ngurronin të shtypnin të vegjlit, të gjenin një mënyrë për të zhdukur të sëmurët e të dobët dhe të kryenin masakra për të hequr qafe racat që ata i shihnin si të ndryshme dhe inferiore. E gjitha kjo ndodhte për arsye se teoria e tyre, nën maskën e shkencës, predikonte se ky ishte "ligji i natyrës". Fatkeqësitë e Darwinizmi nisën në këtë mënyrë e u përhapën me shpejtësi në të gjithë botën. Në shekullin XIX, deri para se materializmi dhe ateizmi të fuqizoheshin nëpërmjet përkrahjes së Darwinizmit, pjesa më e madhe e njerëzve besonte se Zoti i krijoi të gjitha gjallesat dhe se njeriu, ndryshe nga qeniet e tjera të gjalla, zotëronte mendjen që e dallonte prej tyre. Pavarësisht nga raca apo populli, njerëzit konsideroheshin si shërbëtorë të krijuar prej Zotit. Mungesa e fesë, gjithësesi, e shkaktuar dhe e përforcuar nga Darwinizmi, bëri të lindin grupe shoqërore me një këndvështrim konkurrues dhe të pamëshirshëm për botën, që nuk i jepnin kurrfarë rëndësie moralit dhe që i shihnin njerëzit si kafshë të zhvilluara. Njerëzit që mohonin se kishin ndonjë përgjegjësi para Zotit bënë të lindte një kulturë ku çdo lloj egoizmi justifikohej. Prej kësaj kulture lindën shumë "izma" (fjalët që mbarojnë me izëm, p.sh. Darwinizëm, kapitalizëm etj.) dhe secili prej tyre u kthye në fatkeqësi, me plot kuptimin e fjalës, për njerëzimin. Në faqet që vijojnë, do të shqyrtojmë ideologjitë në fjalë, lidhjen e ngushtë midis këtyre ideologjive dhe Darwinizmit, si dhe fatkeqësitë që kjo lidhje i shkaktoi njerëzimit.

## Racizmi dhe kolonializmi i Darvinit



**M**iku i ngushtë i Darvinit, profesor Adam Sedgwick, ishte një nga ata që parashikoi se çfarë rreziqesh do të sillte në të ardhmen teoria e evolucionit. Pasi e lexoi dhe e rilexoi librin "*Origjina e llojeve*", ai deklaroi se **"nëse ky libër do të pranohej në masë të gjerë, do të sillte me vete një brutalitet që nuk ishte parë kurrë më parë."**<sup>7</sup> Dhe vërtet, koha tregoi që Sedgwick kishte pasur të drejtë. Shekulli XX ka hyrë në histori si një epokë e zezë, në të cilën njerëzit përjetuan masakra e spastrime vetëm për shkak të racës apo prejardhjes.

Sigurisht që ka pasur diskriminim dhe spastrime për të njëjtat shkaqe gjatë gjithë historisë së njerëzimit edhe shumë kohë para se të dilte në skenë Darvini, por **Darvinizmi i dha këtij diskriminimi një respektueshmëri të rreme shkencore dhe një ligjshmëri të pamerituar.**

### "Ruajtja e racave të favorizuara..."

Shumica e darvinistëve të kohës sonë pretendojnë që Darvini s'ka qenë kurrë racist, por ata i komentojnë idetë e Darvinit siç u intereson për të mbrojtur pikëpamjet e tyre. Ata pretendojnë se shprehja "*Nga ruajtja e racave të favorizuara*", e cila gjendet si nëntitull i titullit "*Origjina e llojeve*" të librit të Darvinit, vlen vetëm për kafshët. Megjithatë, ajo ç'ka harrojnë ata që shprehin këtë pretendim janë thëniet e vetë Darvinit për racat njerëzore në librin e tij.

Sipas pikëpamjeve të paraqitura nga Darvini në këtë libër, racat njerëzore përfaqësojnë nivele të ndryshme

evoluimi dhe disa raca kanë evoluar e përparuar më shumë se të tjerat. Disa prej tyre, në fakt, janë pak a shumë në të njëjtin nivel me majmunët.

Darvini pretendonte se "lufta për mbijetesë" është e vlefshme edhe për racat njerëzore. "Racat e favorizuara" dolën fitimtare nga kjo betejë. Sipas Darvinit, raca e favorizuar ishin të bardhët e Evropës. Sa për racat aziatike dhe afrikane, ata kishin mbetur mbrapa në luftën për mbijetesë. Darvini shkonte edhe më tej: këto raca shumë shpejt do ta humbisnin përfundimisht luftën mbarëbotërore për mbijetesë e do të zhdukeshin.

Në një të ardhme jo shumë të largët, po ta masim me shekuj, racat e qytetëruara të njeriut do t'i shfarosin dhe do t'i zëvendësojnë racat e egra (primitive) kudo në botë. Në të njëjtën kohë, majmunët antropomorfë ... do të jenë shfarosur pa dyshim. Hendeku midis njeriut dhe aleatëve të tij më të afërt do të zgjerohet, sepse do të ndajë njeriun e një stadi edhe më të qytetëruar se kaukaziani nga një majmun i një niveli të **ulët sa babuni, në vend që të jetë si tani mes zezakut apo australianit dhe gorillës.**<sup>8</sup>

Përsëri, në një pjesë tjetër të librit "Origjina e llojeve", Darvini del me pretendimin se është e domosdoshme që racat inferiore të zhduken dhe se s'është nevoja që popujt e zhvilluar të përpiqen t'i mbrojnë e t'i mbajnë gjallë ato. Ai e ka krahasuar këtë situatë me njerëzit që rrisin kafshë për mbarështim:

**Te njerëzit e egër, të dobtit në trup dhe mendje eliminohen shpejt;** kurse ata që mbijetojnë, në përgjithësi, gëzojnë shëndet të plotë. Ne, njerëzit e qytetëruar, nga ana tjetër, bëjmë të pamundurën të kontrollojmë procesin e eliminimit; ne ndërtojmë spitale për të çmendurit, memecët dhe të sëmurët, ne vendosim ligje të kota, ndërsa mjekët tanë përdorin gjithë zotësinë që kanë për të shpëtuar jetën e çdonjerit deri në momentin e fundit. Kemi arsye të besojmë se vaksinimi ka shpëtuar mijëra, të cilët për shkak të

organizmit të dobët do t'i dorëzoheshin lisë së dhenve. Si rrjedhim, pjesëtarët e dobët të shoqërive të qytetëruara shtojnë llojin e tyre. Çdokush që është marrë me rritjen e kafshëve shtëpiake s' do ta vinte në dyshim që kjo do të jetë mjaft e dëmshme për racën njerëzore.<sup>9</sup>

Siç e pamë, në librin e tij "Origjina e llojeve" Darvini i vendoste aborigjenët (banorët autentikë të Australisë) dhe zezakët në të njëjtin nivel me gorillat dhe deklaronte se këto raca do të zhduken. Sa për racat e tjera që ai i shihte si "inferiore", ai ishte i mendimit se ishte e domosdoshme t'i pengonte të shumoheshin në mënyrë që të shkonin drejt shfarosjes. Kështu, gjurmët e racizmit dhe diskriminimit që i hasim edhe sot e kësaj dite u miratuan e u justifikuan shkencërisht në këtë mënyrë nga Darvini.

Ndërsa detyra që i kishte rënë për pjesë "njeriut të qytetëruar", sipas idesë raciste të Darvinit, ishte që të përshpejtonte këtë periudhë evolucioni, siç do ta shohim më hollësisht në faqet që vijojnë. Në këtë situatë nuk kishte kundërshtime, nga pikëpamja "shkencore", që me këto raca, të cilat gjithësesi do të zhdukeshin, të mbarohej punë sa më shpejt.

Aspekti racist i Darvinit e tregoi ndikimin e tij në shumë shkrime e vëzhgime të tij. Për shembull, ai i shprehu hapur paragjykimet e tij raciste, kur përshkruante vendasit e Tokës së Zjarrtë (Tierra del Fuego), të cilët i pa gjatë një udhëtimi të gjatë që nisi në vitin 1871. Ai i përshkroi vendasit si krijesa "krejt lakuriqe, të llangosura me bojra, që hanë çfarë të gjejnë tamam si kafshët e egra, të pakontrolluara, mizore ndaj të gjithë atyre që s'bënin pjesë në fisin e tyre, që gjenin kënaqësi kur torturonin armiqtë, që ofronin kurbane të përgjakshme, që vrisnin fëmijët e tyre, që keqtrajtonin gratë, që ishin të mbushur me bestytini të kota..." Kurse studiuesi W. P. Snou, që i kishte përshkuar të njëjtat vise 10 vjet më parë, paraqet një panoramë krejt të ndryshme

nga ajo e Darvinit. Sipas Snout, banorët e Tokës së Zjarrit ishin "njerëz të pashëm e të fortë, ishin shumë të dhënë pas fëmijëve të tyre, disa prej veglave të tyre tregonin mjeshtëri e origjinalitet, njihnin një farë të drejte për pronën, si dhe pranonin autoritetin e disa prej grave më të moshuara".<sup>10</sup>

Siç shihet nga këta shembuj, Darvini ishte një racist i vërtetë. Në fakt, sipas fjalëve të autorit të librit "*Çfarë ka thënë në të vërtetë Darvini*", Benjamin Farrington, Darvini ka bërë shumë komente në lidhje me **"dallimet më të mëdha mes njerëzve të racave të ndryshme"** në librin e tij "Prejardhja e Njeriut".<sup>11</sup>

Për më tepër, mohimi i ekzistencës së Zotit nga teoria e Darvinit ishte shkaku që i shtyu njerëzit të mos besonin se njeriu është i krijuar prej Zotit dhe se të gjithë njerëzit janë krijuar të barabartë. Ky ishte një nga faktorët që fshihej pas shtimit të racizmit dhe shpejtimit të pranimit të tij në botë. Shkencëtari amerikan Xhejms Ferguson (James Ferguson) shpjegon lidhjen e ngushtë midis mohimit të krijimit dhe shtimit të racizmit në këtë mënyrë: Antropologjia e re u shndërrua shumë shpejt në sfond teorik midis dy shkollave të kundërta filozofike për origjinën e njeriut. Më e vjetra dhe më e formuara prej tyre ishte "monogjenizmi", besimi se gjithë njerëzimi, pa marrë parasysh ngjyrën apo tiparet e tjera, rridhte direkt nga Adami dhe nga akti i vetëm origjinal i krijimit nga Zoti.

Monogjenizmi u shpall nga kisha e u pranua gjerësisht deri në shekullin XVIII, kur **kundërshtimi i autoritetit teologjik filloi të nxiste teorinë rivale të "poligjenizmit"**, (teoria e evolucionit) sipas së cilës bashkësi të ndryshme racore kishin origjinë të ndryshme.<sup>12</sup>


Antropologu indian Lalita Vidjarthi shpjegon se si teoria e evolucionit të Darvinit bëri që racizmi të pranohej nga shkencat shoqërore:

**Teoria e tij (Darvinit) për mbijetesën e atij që**

**përshtatet më mirë u prit krahëhapur prej shkencëtarëve shoqërorë të asaj kohe dhe ata besonin se njerëzimi kishte arritur nivele të ndryshme evolucioni, duke arritur kulmin me qytetërimin e njeriut të bardhë. Nga gjysma e dytë e shek. XIX, racizmi ishte pranuar si fakt nga pjesa më e madhe e shkencëtarëve perëndimorë.<sup>13</sup>**

Për sa u përket darvinistëve që erdhën pas Darvinit, ata nisën një luftë të madhe për të vërtetuar pikëpamjet e tij raciste. Në emër të asaj që po bënin, ata nuk kishin skrupuj kur vinte puna te mospërputhjet dhe të pavërtetat e shumta shkencore. Ata mendonin se po t'i vërtetonin ato, do të provonin shkencërisht superioritetin e tyre dhe "të drejtën" për të shtypur, kolonizuar e, po të ishte nevoja, edhe shfarosur racat e tjera.

Në kapitullin e tretë të librit të tij *"The Mismeasure of Man"*, Stefën Jej Gould (Stephen Jay Gould) vuri në dukje se disa antropologë nuk i kanë kursyer edhe falsifikimet për të vërtetuar "superioritetin" e racës së bardhë. Sipas Gould, metodat që ata përdorën më shumë ishte falsifikimi i përmasave të trurit të kafkave të fosilizuara që gjenin. Ai përmend në librin e tij se, duke menduar që madhësia e trurit kishte të bënte me inteligjencën, shumë antropologë e zmadhuan qëllimisht



**Udhëtimet që ndërmori Darvini nxorën në pah anën e tij raciste. Për shembull, Darvini e konsideronte termin "kafshë të egra" si të përshtatshëm për ato fise, kulturën dhe aftësitë e të cilave i kishin vlerësuar studiues të tjerë.**

madhësinë e kafkave kaukaziane (të bardhët) dhe e zvogëluan madhësinë e kafkave të zezakëve dhe indianëve.<sup>14</sup>

Në librin e tij *"Ever Since Darwin"*, Gould shpjegon pretendimet e pabesueshme që morën përsipër darvinistët për të demonstruar se disa raca ishin inferiore.

Haeckel dhe kolegët e tij përdorën teorinë e përsëritjes për të vërtetuar superioritetin racor të të bardhëve të Evropës Veriore. Ata rrëmuan fakte nga anatomia dhe sjellja njerëzore, duke shfrytëzuar çfarë të gjenin nga trutë deri te kërthiza. Herbert Spenser ka shkruar se "tiparet intelektuale të të paqytetëruarve janë tipare që hasen te fëmijët e të qytetëruarve". Karl Vogt e theksoi këtë edhe më shumë në vitin 1864: "Zezaku i rritur, për sa u përket aftësive të tij intelektuale, ka natyrën e fëmijës... Disa fise kanë themeluar shtete, që kanë një organizim të veçantë, por, për sa i përket pjesës tjetër që mbetet, mund të themi pa frikë se e gjithë raca, nuk ka kryer ndonjë gjë që t'i shërbejë përparimit të njerëzimit apo që t'ia vlejë të ruhet, as në të shkuarën e as në të tashmen."<sup>15</sup>

Edhe anatomisti francez, mjeku Etienne Serres mbronte idenë se meshkujt zezakë janë primitivë, sepse kërthiza e tyre ndodhej më poshtë se te të tjerët.

Bashkëkohësi i Darvinit, evolucionisti Havelock Ellis, mbështeste dallimin midis racave superiore dhe inferiore me një shpjegim të ashtuquajtur "shkencor", duke thënë:

Fëmijët e shumë racave afrikane është e vështirë, për të mos thënë e pamundur, të jenë më pak inteligjentë se fëmijët evropianë, por ndërkohë që afrikani bëhet budalla e i trashë kur rritet dhe e gjithë jeta e tij shoqërore bie në një gjendje rutine të pandryshueshme, evropiani nuk e humbet gjallërinë e fëmijërisë.<sup>16</sup>

Antropologu darvinist francez Vacher de Lapouge

sugjeroi në veprën e tij të titulluar "Race et Milin Social Essais d'Anthroposociologie" (Paris 1909) se klasat jo të bardha ishin pasardhëset e njerëzve të egër që nuk kishin mësuar të bëheshin të qytetëruar, ose thëne ndryshe, ishin përfaqësuesit e degeneruar të klasave me gjak të përzier. Ai nxori disa rezultate duke matur kafkat nga shtresat e larta e të ulta të Parisit në varreza. Sipas rezultateve të tij, në varësi të kafkave, disa njerëz ishin të prirur për të qenë të pasur, me besim te vetja dhe të lirë, kurse të tjerët konservatorë, të kënaqur me pak e të pajisur me të gjitha cilësitë e një shërbëtori të mirë. Shtresat ishin produkt i përzgjedhjes shoqërore, shtresat e larta të shoqërisë shkonin me racat superiore, pasuria ishte në raport me përmasën e kafkës. Lapouge më vonë bëri një parashikim: "Kam mendimin se në vitet që do të vijjnë njerëzit do të vrasin njëri-tjetrin, sepse kokat e tyre janë të rrumbullakëta ose me majë."<sup>17</sup> Ky parashikim doli i vërtetë, siç do ta shohim hollësisht në faqet e tjera të këtij libri, dhe shekulli XX ka parë shumë masakra të kryera për arsye racizmi...!

Por nuk ishin vetëm antropologët. Edhe entomologët (studiuesit e insekteve) hipën në makinën raciste që Darwinizmi kishte vënë në lëvizje me pretendime të pabesueshme. Për shembull, në vitin 1861, një entomolog anglez, pasi mblodhi morra që jetonin në trupat e njerëzve në vende të ndryshme të botës, arriti në përfundimin, se morrat e një race nuk mund të jetonin në trupat e një race tjetër, gjë që po të shihet nga niveli i sotëm shkencor, është diçka tepër qesharake.<sup>18</sup> Kur edhe njerëzit me status shkencëtarë bënë deklaratatë të tilla, nuk ishte për t'u habitur që disa racistë dogmatikë përdornin slogane absurde si: "Edhe morrat e zezakëve janë zezakë."

Shkurtimisht, aspekti racist i teorisë së Darvinit gjeti terren pjellor në gjysmën e dytë të shekullit XIX. Kjo ndodhi për arsye se në atë kohë "njeriu i bardhë" evropian ishte në pritje të një teorie të tillë për të

justifikuar krimet e veta.

### **Kolonializmi britanik dhe Darwinizmi**

Vendi që ka përfituar më shumë nga pikëpamjet raciste të Darvinit ishte toka e vetë Darvinit, Britania. Në vitet kur Darvini nxori teorinë e tij, Britania e Madhe ishte në pozitën e themelueses së perandorisë koloniale numër një në botë. Të gjitha burimet natyrore të një zone që shtrihej nga India deri në Amerikën Latine shfrytëzoheshin prej Perandorisë Britanike. "Njeriu i bardhë" po e plaçkiste botën për interesat e veta.

Por sigurisht, duke filluar që nga Britania e Madhe, asnjë vend kolonizues nuk donte të shihej si "plaçkitës" e të hynte në histori si i tillë. Për këtë arsye, ata kërkonin një shpjegim për të justifikuar atë që po bënin. Një shpjegim i tillë mund të ishte përshkrimi i popujve të kolonizuar si "popuj primitivë" ose "qenie të gjalla shtazore". Në këtë mënyrë, ata që ishin masakruar dhe i ishin nënshtruar një trajtimi çnjerëzor, do të mund të shiheshin jo si qenie njerëzore, por si krijesa gjysmënjeri-gjysmëkafshë dhe atëherë keqtrajtimi i tyre nuk do të konsiderohej krim.

Në fakt, ky hulumtim nuk ishte i ri: përhapja e parë e kolonializmit në botë shkon deri në shekullin XV dhe XVI. Pretendimet se disa raca kishin tipare kafshësh u paraqitën për herë të parë nga Kristofor Kolombi në udhëtimin e tij në Amerikë. Sipas këtyre pretendimeve, amerikanët vendas (indianët e Amerikës) nuk ishin qenie njerëzore, por një specie kafshe e zhvilluar. Për këtë arsye, ata mund të viheshin në shërbim të kolonizatorëve spanjollë.

Pavarësisht se në filmat rreth zbulimit të Amerikës, Kolombi përshkruhet sikur ka mbajtur qëndrim human e të ngrohtë me vendasit, e vërteta është se Kolombi nuk i konsideronte vendasit qenie njerëzore.<sup>19</sup>

Kristofor Kolombi ishte i pari që ndezi një masakër të madhe. Ai krijoi kolonitë spanjolle në vendet që

zbuloi, skllavëroi vendasit dhe ishte përgjegjës për fillimin e tregtisë së skllavërvë. "Pushtuesit" spanjollë e panë politikën e shtypjes dhe shfrytëzimit që ndoqi Kolombi dhe e vazhduan atë më tej. Masakrat e kryera arritën përmasa të pabesueshme. Për shembull, popullsia e një ishulli numëronte 200.000 banorë kur mbërriti për herë të parë Kolombi; 20 vjet më vonë kishin mbetur vetëm 50.000, ndërsa në vitin 1540 vetëm një mijë njerëz. Kur më i famshmi i pushtuesve spanjollë, Kortes, shkeli për herë të parë në Meksikë në shkurt 1519, e gjithë popullsia vendase numëronte rreth 25 milionë, por në vitin 1605 kjo shifër kishte rënë në 1 milion. Në ishullin e Hispaniolës, popullsia, që kishte qenë 7-8 milionë në 1492, ra në 4 milionë në vitin 1496 dhe në vetëm 125 vetë në vitin 1570. Sipas shifrave të historianëve, në më pak se një shekull pasi Kolombi shkeli për herë të parë në kontinent, **95 milionë vendas u masakruan prej kolonizatorëve**. Kur Kolombi zbuloi Amerikën, 30 milionë vendas popullonin kontinentin. Si rezultat i masakrave që nga ajo kohë e deri tani, kanë mbetur më pak se 2 milionë vendas.

Arsyeja që këto masakra arritën përmasa të tilla të pamëshirshme ishte fakti që popullsia indigjene nuk konsiderohej qenie njerëzore por kafshë.

Por këto pretendime të kolonizatorëve nuk fituan shumë përkrahës. Në atë kohë në Evropë, fakti që të gjithë njerëzit janë krijuar të barabartë nga Zoti dhe se të gjithë rrjedhin nga një paraardhës, Adami, ishte pranuar kaq gjerësisht, sa që Kisha Katolike në veçanti mbajti qëndrim kundër këtyre pushtimeve plaçkitëse. Një nga shembujt më të njohur për këtë është përgjigja e dhënë nga ipeshkvi i Kiapas, Bartolome de las Kasas, i cili mbërriti në Botën e Re së bashku me Kolombin dhe deklaroi se vendasit ishin "qenie njerëzore", si përgjigje ndaj pretendimit të kolonizatorëve që vendasit ishin "një lloj kafshe". Papa Pali III mallkoi trajtimin shtazarak të vendasve në një qarkore papale të vitit 1537 dhe deklaroi se vendasit ishin qenie njerëzore, me aftësi të

plota për besim.<sup>20</sup>

Por në shek XIX, situata ndryshoi. Bashkë me përhapjen e filozofisë materialiste dhe me largimin e shoqërive nga feja, e vërteta që qeniet njerëzore ishin krijuar nga Zoti filloi të mohohet. Kjo, ashtu siç u trajtua edhe më lart, shënoi në të njëjtën kohë lindjen e racizmit.

Me lindjen e filozofisë materialiste-darviniste në shekullin XIX, racizmi u fuqizua edhe më shumë dhe kjo krijoi një mbështetje të fuqishme për sistemin imperialist të Evropës.

James Joll, i cili ka punuar për vite të tëra si profesor historie në universitete të tilla si Oksfordi, Stenfordi dhe Harvardi, në librin e tij të historisë "Evropa që nga viti 1870", i cili edhe sot e kësaj dite përdoret si tekst shkollor nëpër universitete, përshkruan lidhjen ideologjike midis Darwinizmit, imperializmit dhe racizmit.

Grupet më të thella të ideve që frymëzonin konceptin e imperializmit ishin ato që mund të klasifikohen në vija të trasha si "*Darvinizmi Social*" dhe që i shihnin marrëdhëniet mes shteteve si luftë të përhershme për mbijetesë, në të cilën disa raca konsideroheshin

**Masakra kundër amerikanëve vendas  
Me zbulimin e Amerikës nga Kristofor  
Kolombi filloi një masakër e tmerrshme  
kundër amerikanëve vendas.**



"superiore" ndaj të tjerave në një proces evolutiv, ku më të fortit i duhej të tregonte veten vashdimisht.

Dy librat e Darvinit, "Origjina e llojeve", botuar në vitin 1859 dhe "Prejardhja e njeriut", që pasoi në vitin 1871, ndezën polemika që prekën shumë degë të mendimit evropian... Idetë e Darvinit dhe të disa bashkëkohësve të tij, si p.sh. filozofi anglez Herbert Spenser, u zbatuan me shpejtësi për çështje që s'kishin të bënin me ato shkencore. Thelbi i Darwinizmit që dukej më i zbatueshëm në zhvillimin e shoqërisë ishte besimi se mbipopullimi jashtë mundësive bënte të domosdoshme një luftë të vazhdueshme për mbijetesë, të cilën e fitonte më i forti ose ai që përshtatej më mirë. Kjo bëri që disa mendimtarë socialë ta kishin të lehtë t'i jepnin një përmbajtje morale nocionit të më të fortit (ligjit të xhunglës), kështu që speciet apo racat që mbijetonin ishin ato që kishin të drejtën morale për këtë.

Doktrina e seleksionimit natyror mund të lidhej fare lehtë me një tjetër zinxhir mendimi, të krijuar nga shkrimtari francez, konti Joseph-Arthur Gobineau, i cili botoi një "Esë mbi pabarazinë e racave njerëzore" në vitin 1853. Gobineau këmbëngulte se faktori më i rëndësishëm për zhvillimin ishte raca. Ato raca që mbeteshin superiore ishin pikërisht ato që e mbanin pastërtinë e tyre raciale të paprekur. Prej këtyre, sipas Gobineau, ishte raca ariane ajo që kishte mbijetuar më mirë. Ishte Houston Stewart Chamberlain që kontribui në çuarjen e këtyre ideve një stad më tutje... Vetë Hitleri e admironte autorin Chamberlain, aq sa i bëri një vizitë në shtratin e tij të vdekjes në vitin 1927.<sup>21</sup>

Siç u tregua, ekziston një zinxhir ideologjik që bën lidhjen midis Darvinit dhe mendimtarëve racistë, zinxhir ky që arrin deri te Hitleri. Darwinizmi është baza ideologjike e imperializmit që e mbyti botën në gjak në shek. XIX dhe e nazizmit që bëri të njëjtën gjë në shek. XX.

Edhe Britania e Madhe e kohës së Viktorias gjeti të ashtuquajturën "bazë shkencore" të Darwinizmi. Britania

e Madhe nxori përfitime të mëdha nga kolonializmi dhe nuk kishte arsye pse të mos i shtypte ata që jetonin nën kolonializmin e saj. Një shembull i politikës së ndyrë të imperializmit britanik ishin "Lufrat e Opiumit" kundër Kinës. Britania e Madhe filloi të sillte kontrabandë në Kinë opiumin që e kultivonte në Indi qysh nga çereku i parë i shekullit XIX. Kjo tregëti kontrabandë e opiumit u rrit me kalimin e kohës për të zvogëluar defiçitin në tregëtinë e jashtme britanike. Futja e drogës në vend ndikoi, gjithashtu, në dobësimin e autoritetit të shtetit kinez mbi territorin e vet. Rrënimi i shoqërisë shumë shpejt arriti përmasa serioze. Ndalimi i opiumit, që qeveria kineze u detyrua të zbatojë pas një periudhe të gjatë mëdyshjeje, çoi në Luftën e parë të Opiumit (1838-1842). S'ka dyshim se kjo luftë e çoi vendin dalëngadalë drejt falimentimit. Kina u detyrua ta ulë kokën për shkak të paafësisë së ushtrisë së saj në çdo konfrontim me forcat e huaja dhe të pranojë kërkesat e tyre gjithmonë në rritje. Perëndimorët dalëngadalë formuan qendra banimi brenda territorit kinez qysh në vitin 1842. Ata u morën koncesione të mëdha kinezëve, morën me qira fushat e tyre dhe e detyruan vendin të hapej me botën e jashtme në një mënyrë që do t'u sillte më shumë përfitim atyre vetë. Si rezultat i gjithë kësaj, varfëria në vend, qeveria e pafuqishme, si dhe humbja e ngadaltë e territorit kinez çuan në shumë kryengritje.

Ngjarjet në Kinë ishin vetëm një nga pasojat e politikës britanike. Gjatë gjithë shekullit XIX, shtypja dhe përmasat e dhimbshme të imperializmit britanik u përjetuan në vende të tilla si Afrika e Jugut, India dhe Australia.

Detyra për justifikimin e këtij sistemi shtypës të Britanisë dhe për të treguar se britanikët kishin të drejtë, u takoi sociologëve dhe shkencëtarëve të ndryshëm britanikë. Çarls Darvini ishte më i rëndësishmi dhe më efikasi nga të gjithë. Ishte Darvini ai që deklaroi se gjatë gjithë evolucionit ka pasur "raca superiore", si "raca e

bardhë" dhe se shtypja e të tjerëve nga të bardhët ishte "ligj i natyrës".

Për shkak të justifikimit që ofroi Darvini për racizmin kolonialist, shkencëtari i famshëm, Kenneth J. Hsü,

## Falsifikimi i njeriut të Piltdaunit

Një nga treguesit më interesantë të frymëzimit që i ofroi teoria e evolucionit imperializmit britanik, ishte skandali i njeriut të Piltdaunit. Në vitin 1912, një kafkë e çuditshme u gjend në Piltdaun, Angli. Charles Dawson, shkencëtari që zbuloi kafkën bashkë me ekipin e tij, deklaruan se ajo i përkiste një krijese që gjysmënjeri-gjysmëmajmun. Artur Keith, një anatomist i famshëm evolucionist, e verifikoi fosilin dhe i konfirmoi rezultatet. Megjithatë, Dawson dhe Keith theksuan një pikë të rëndësishme: truri i fosilit kishte madhësinë e atij të njeriut të ditëve të sotme, por kocka e nofullës kishte tipare të majmunit.

Truri i njeriut të Piltdaunit u bë krenaria e britanikëve. Meqë kjo kafkë ishte gjetur në Angli, pa tjetër duhej t'i përkiste paraardhësve të britanikëve. Sipas britanikëve, volumi më i madh i trurit tregonte që britanikët kishin evoluar para racave të tjera e, si rrjedhim, ishin superiorë ndaj tyre. Prandaj edhe zbulimi i njeriut të Piltdaunit shkaktoi një ngazëllim të madh në Angli. Për gazetatat ai ishte kryeartikulli, kurse turmat e njerëzve e festonin me gëzim këtë zbulim. Qeveria britanike, nga ana tjetër, i dha një titull kalorësie Artur Keithit për zbulimin e tij të madh. Paleontologu i famshëm evolucionist, Don Johanson, përshkruan lidhjen midis fosilit të Piltdaunit dhe imperializmit anglez:

*Zbulimi Piltdaunit ishte shumë eurocentrik. Nuk kishte siguruar epërsi vetëm truri, por edhe vetë anglezët kishin siguruar epërsinë.\**

Mirëpo frymëzimi që u erdhi anglezëve nga njeriu i Piltdaunit zgjati deri në vitin 1953, kur shkencëtari Kenneth Oakley, që e kontrolloi përsëri fosilin me imtësi, zbuloi falsifikimin më të madh të shekullit XX. Fosili ishte formuar duke i ngjitur një nofull orangutangu kafkës së një njeriu.

*\*Don Johanson, In Search of Human Origins, 1994 WGBH Educational Foundation*

shef i departamentit të gjeografisë në Institutin Federal Zviceran të Teknologjisë, vetë me origjinë kineze, e përshkruan Darwinin si "një shkencëtar xhentëlmen të epokës viktoriane dhe anëtar i parisë së një shoqërie që dërgoi luftanijet e saj për të importuar opium me forcë në Kinë, **gjithçka në emër të konkurrencës, (në tregtinë e lirë) dhe mbijetesës së më fortit.**"<sup>22</sup>

### **Racizmi dhe Darwinizmi Social në Amerikë**

Darvinizmi Social siguroi mbështetje për racistët dhe imperialistët edhe në vendet e tjera krahas Britanisë. Kjo ishte arsyeja që ai u përhap shumë shpejt në mbarë botën. Në krye të atyre që pajtoheshin me këtë teori u vu presidenti amerikan Teodor Ruzvelt, i cili ishte përkrahësi dhe zbatuesi kryesor i programit të spastrim etnik të amerikanëve vendas nën emrin "zhvendosje e detyruar". Në librin "The Winning of the West" (Fitorja e Perëndimit), ai parashitroi ideologjinë e masakrës, me mendimin se një luftë raciale deri në fund me indianët ishte e pashmangshme.<sup>25</sup> Mbështetjen më të madhe ai e gjeante te Darwinizmi, i cili i dha mundësinë për t'i përkufizuar vendasit si racë e prapambetur.

Siç e kishte parashikuar Ruzvelti, asnjë nga marrëveshjet me amerikanët vendas nuk u respektua. Edhe kjo u justifikua me teorinë e "racës së prapambetur". Në vitin 1871, kongresi nuk i mori parasysh marrëveshjet e bëra me amerikanët vendas dhe vendosi t'i degdiste ata në toka djerrë ku mund të prisnin veç vdekjen. Nëse anëtarët e palës tjetër nuk konsideroheshin qenie njerëzore, atëherë si mund të kishin vlerë marrëveshjet e bëra me ta...?!

Ruzvelti, gjithashtu, deklaroi se lufta raciale e lartpërmendur përfaqësonte arritjen kulminante të përhapjes së popujve anglistfolës (anglo-saksonë) në të gjithë botën.<sup>26</sup>

Një nga përkrahësit më të mëdhenj të racizmit anglo-sakson, evolucionisti amerikan dhe kleriku protestant

Josiah Strong, përdori të njëjtën logjikë. Dikur ai shkroi këto fjalë:

Atëherë bota do të hyjë në një stad tjetër të historisë së saj, në konkurrencën përfundimtare mes racave, për të cilën po stërvitet anglo-saksoni. Nëse nuk gabohet, kjo racë e fuqishme do t'i drejtohet Meksikës, Amerikës Qendrore dhe Jugore, do të hapet nëpër ishuj e detra, do të kalojë në Afrikë e më tutje. A mundet të vërë ndonjëri në dyshim se **rezultati i kësaj konkurrence do të jetë "mbijetesa e më të fortit"**?<sup>27</sup>

Racistët më kryesorë që e përdorën Darwinizmin Social për të justifikuar veprimet e tyre ishin armiqtë e zezakëve. Teoritë e tyre raciste, që i ndanë njerëzit në nivele dhe përcaktuan racën e bardhë si më superiore dhe racën e zezë si më primitive, e përqaftuan me entuziazëm konceptin e evolucionit.<sup>28</sup>

Teoricieni racist evolucionist më i shquar, Henry Fairfield Osborn, shkroi në një artikull me titull "*Evolucioni i racave njerëzore*":

"Niveli i inteligjencës së një zezaku mesatar në moshë madhore është i ngjashëm me atë të një fëmije 11 vjeçar të species Homo Sapiens".<sup>29</sup>

Duke u nisur nga kjo logjikë, zezakët nuk ishin aspak genie njerëzore. Një tjetër përkrahës i njohur i mendimit racist evolucionist, Carleton Coon, në librin e tij "*The Origin of Race*" (Prejardhja e racës), botuar më 1962, paraqiti idenë se raca e zezë dhe e bardhë ishin dy specie të ndryshme që ishin shkëputur nga njëra-tjetra qysh në periudhën e *Homo Erectus*. Sipas Coon, të bardhët kishin evoluar më tej pas kësaj ndarjeje. Përkrahësit e diskriminimit të zezakëve e përdorën për një kohë të gjatë këtë shpjegim pseudoshkencor.

Ekzistenca e një teorie shkencore mbështetëse shumë shpejt e shtoi racizmin në Amerikë. W. E. Dubois, i njohur si kundërshtar i diskriminimit racial, pohoi se "problemi i shekullit të njëzetë është problemi i ngjyrës". Sipas tij, shfaqja e problemit të racizmit në masë kaq të

gjerë në një vend që kërkon të bëhet shteti më demokratik në botë dhe që nga disa këndvështrime e ka arritur një gjë të tillë, nuk është më i parëndësishmi nga paradokset. Heqja e skllavërisë nuk ka mjaftuar të vendosë një vëllazërim mes zezakëve dhe të bardhëve.

Ai mendonte se diskriminimi zyrtar, i krijuar në një kohë të shkurtër, në kohën tonë është kthyer nga vetë fakti në një situatë ligjore, për të cilën po kërkohet ende një zgjidhje.<sup>30</sup>

Dalja e ligjeve të para për diskriminim racial, të njohura si "*Ligjet për Xhim Krou*" (Xhim Krou ishte një nga emrat përbuzës që përdornin të bardhët për zezakët), ndodhi, gjithashtu, në atë kohë.

Pa dyshim që zezakët nuk trajtoheshin si qenie njerëzore, por përçmoheshin e trajtoheshin me përbuzje kudo: për më tepër, ky nuk ishte qëndrimi i një numri të vogël individësh racistë, por ishte përcaktuar prej shtetit amerikan me ligjet e veta. Menjëherë pas nxjerrjes së ligjit të parë që miratonte veçimin racial në stacione treni dhe tramvaje në Tenesi në vitin 1875, të gjitha shtetet e Jugut e zbatuan veçimin në stacionet e tyre të trenit. Tabelat ku shkruhej "Vetëm për të bardhët" dhe "Për

zezakë" varehin gjithandej. Në fakt, të gjitha këto, thjesht synonin t'i jepnin statusin zyrtar një situatë që tashmë ekzistonte. Martesa ndërmjet racave të ndryshme ishte e ndaluar. Sipas ligjit, veçimi ishte i detyrueshëm në spitale, burgje dhe varreza. Në praktikë, kjo përfshinte hotelet, teatrot, bibliotekat,



Në librin e tij "*Fitorja e Perëndimit*", presidenti amerikan Teodor T. Ruzvelt krijoi ideologjinë e masakrës dhe më vonë e vuri atë në jetë.



madje edhe ashensorët e kishat. Fusha ku ndjehej më shumë veçimi ishte shkolla. Kjo ishte metoda që pati efektet më të rënda te zezakët dhe përbënte pengesën më të madhe që i dilte përpara zhvillimit të tyre kulturor.

Praktikimi i veçimit racial u shoqërua nga një valë dhune. Pati një ngritje të shpejtë në numrin e dënimeve të zezakëve pa gjyq të ligjshëm. Gjatë periudhës 1890-1901, rreth 1300 zezakë u dënuan në këtë formë. Si rrjedhim i këtyre praktikave, zezakët u larguan nga disa shtete. Shumë mendime e teori raciste e shoqëruan këtë

**Në Amerikën e fundit të shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX, të bardhët i trajtonin zezakët shumë keq. Ligjet dhe zbatimi i tyre tregonin qartë se zezakët nuk konsideroheshin qenie njerëzore. Ndërkohë që të bardhët jetonin në luks, zezakët trajtoheshin në mënyrë çnjerëzore.**



periudhë. Pa kaluar shumë kohë, racizmi biologjik amerikan do ta shprehte veten në rezultatet e arritura nga metoda e R. B. Binit për matjen e kafkës dhe nën pretekstin e mbrojtjes së popullit të kontinentit të ri nga një valë emigrimi e pakontrolluar, lindi një lloj i veçantë racizmi amerikan. Madison Grant, autor i librit *"The passing of the great race"* (1916) ka shkruar se përzierja e dy racave do t'i hapte rrugën ardhjes së një race akoma më primitive se speciet inferiore dhe ai donte që martesat ndër-raciale të ndaloheshin me ligj.<sup>31</sup>



Racizmi ekzistonte në Amerikë edhe përpara Darvinit, siç ekzistonte në të gjithë botën, por Darwinizmi u dha mbështetje të dukshme pikëpamjeve dhe politikave raciste në gjysmën e dytë të shekullit XIX. Siç e pamë në këtë kapitull, kur racistët paraqisnin



**Shtypja e zezakëve**  
Ku Kluks Klani ishte grupi që zhvilloi sulmet më të egra kundër zezakëve. Zinxhiri në figurën përbri përdorej për të lidhur skllëvërit zezakë me njëri-tjetrin.



pikëpamjet e tyre, përdornin si sllogane pretendimet e Darwinizmit. Idetë që para Darvinit ishin konsideruar si mizore, tani filluan të pranohen si ligje të natyrës.

### **Politikat çnjerëzore të racistëve darvinistë: Shfarnosja e aborigjenëve**

Vendasit e Australisë njihen me emrin aborigjenë. Këta njerëz, që kishin jetuar në kontinent për mijëra vjet, përjetuan një prej shfarnosjeve më mizore të historisë me shtrirjen e kolonizatorëve evropianë në të gjithë vendin. Baza ideologjike e kësaj shfarnosjeje ishte Darwinizmi. Pikëpamjet e ideologëve darvinistë për aborigjenët krijuan teorinë e barbarizmit që vuajtën këta njerëz.

Më 1870, Max Muller, antropolog evolucionist i *"London Anthropological Review"*, kishte ndarë racat njerëzore në shtatë kategori. Aborigjenët klasifikoheshin në fund, ndërsa raca ariane, ajo e evropianëve të bardhë, ishte vendosur në krye. H. K. Rusden, një darvinist social i njohur, u shpreh kështu për aborigjenët më 1876:

Mbijetesa e më të fortit do të thotë se e drejta është me më të fortin. Ne, si rrjedhim, përmbushim, pa na vrarë ndërgjegja, ligjin e pamëshirshëm të seleksionimit natyror kur shfarnosim racat inferiore australiane dhe maorite... dhe përvetësojmë pasurinë e tyre me gjakftohtësi.<sup>32</sup>

Në vitin 1890 zëvendëspresidenti i Shoqërisë Mbretërore të Tasmanisë, Xhejms Bernard, shkroi: *"Procesi i shfarnosjes është një aksiomë e ligjit të evolucionit dhe seleksionimit natyror."* Kështu, përfundoi ai, s'kishte arsye të mendohej se *"ka pasur ndonjë pakujdesi të dënueshme"* në vrasjen dhe shpronësimin e australianëve aborigjenë.<sup>33</sup>

Si rezultat i këtyre pikëpamjeve raciste, mizore dhe të egra, të ushqyera nga Darvini, filloi një masakër e tmerrshme që synonte shfarnosjen e aborigjenëve. Kokat aborigjene gozhdoheshin në dyert e stacioneve. Familjeve aborigjene u jepej bukë e helmuar. Në shumë

pjesë të Australisë, territore banimi aborigjene u zhdukën barbarisht brenda 50 vjetëve.<sup>34</sup>

Politikat që kishin në shënjestër aborigjenët nuk përfunduan me masakra. Shumë anëtarë të racës trajtoheshin si kafshë eksperimentale. Instituti Smithsonian në Uashington DC mbante eshtrat e 15.000 njerëzve të racave të ndryshme. 10.000 aborigjenë australianë u dërguan me anije në Muzeun Britanik me qëllim që të shihej nëse ishin apo jo "hallka që mungonte" në tranzicionin nga kafshët në qeniet njerëzore.

Muzeumet nuk ishin të interesuar vetëm për kockat. Në të njëjtën kohë, ata mbanin tru aborigjeni dhe e shisnin me çmim të lartë. Ka prova, gjithashtu, se aborigjenët australianë vriteshin për t'u përdorur si kavie. Faktet e mëposhtme janë dëshmitarë të kësaj mizorie:

Një nekrologji në shtratin e vdekjes nga Korah Uills, i cili u bë kryetar bashkie i Bouenit, Kuinslend në 1866, përshkruan se si ai vrau dhe preu në copa një anëtar të një fisi vendas në vitin 1865 për të siguruar një mostër shkencore.

Eduard Ramsei, mbikqyrës i Muzeut Australian në Sidnej që prej 20 vjetësh duke nisur nga viti 1874, ishte i përzier keqas në këtë punë. Ai botoi një broshurë që i përfshinte aborigjenët nën emërtimin "kafshë australiane". Ajo, gjithashtu, jepte udhëzime jo vetëm se si vidhen varret, por edhe se si shtuposen plagët e plumbit të "mostrat" e sapovrara.

Një evolucioniste gjermane, Amali Ditrih (me



**Masakrimi i aborigjenëve Vendasit e Australisë, aborigjenët, u cilësuan nga evolucionistët si specie njerëzore të pazhvilluara dhe u masakruan.**

pseudonimin "Engjëlli i Vdekjes së Zezë") erdhi në Australi për t'u kërkuar pronarëve të stacioneve që të qëllloheshin aborigjenët se duheshin për mostra, për balsamosje dhe ekspozim për punëdhënësit e saj të muzeut. Megjithëse e dëbuar nga disa pronarë, shumë shpejt ajo u kthye në shtëpi me mostrat e saj.

Një misionar nga Uells i Ri Jugor u bë dëshmitar i një vrasjeje nga policia me kuaj e një grupi prej dhjetëra burrash, grash e fëmijësh aborigjenë. Dyzet e pesë koka u përzgjedhën dhe 10 kafkat më të mira u dërguan me pako përtej detit.<sup>35</sup>

Shfarosja e aborigjenëve vazhdoi edhe në shekullin XX. Ndër metodat e përdorura për këtë shfarosje ishte edhe shpëputja me forcë e fëmijëve aborigjenë nga familjet e tyre.

Një artikull i gazetarit Alan Thornhill, i botuar më 28 prill 1997 në gazetën "Philadelphia Daily News", bën fjalë për këtë metodë që u përdor kundër aborigjenëve:

Familjet aborigjene rrëfejnë sekuestrimin e personave Associated Press - Aborigjenët që jetonin në shkretëtirat veriperëndimore të Australisë i lyenin fëmijët e tyre lëkurëzbehtë me thëngjill, me shpresën që punonjësit e asistencës sociale shtetërore të mos i merrnin. "Punonjësit socialë të kapnin kur të gjenin", tregon një nga fëmijët e grabitur, shumë vjet më vonë. "Familja na fshihte, na lyente me thëngjill".

"Mua më çuan në Mula Bulla", thotë një lopçar, të cilin e kishin grabitur kur kishte qenë i vogël. "Ishim 5-6 vjeç". Historia e tij ishte një prej mijëra historive që u dëgjuan prej Komisionit të të Drejtave të Njeriut dhe Mundësive të Barabarta të Australisë gjatë hetimeve të dhimbshme për "gjeneratën e grabitur". Nga viti 1910 deri në vitet '70, rreth 100.000 fëmijë aborigjenë iu rrëmbyen prindërve të tyre... Fëmijët lëkurëzbehtë iu dhanë familjeve të bardha për adoptim, ndërsa fëmijët me lëkurë të zezë u çuan në shtëpitë e fëmijës.<sup>36</sup>

Edhe tani, dhimbja është aq e madhe saqë pjesa më

e madhe e historive u botuan në mënyrë anonime në raportin përfundimtar të komisionit "*Kthimi në shtëpi*". Komisioni deklaroi që veprimet e autoriteteve në atë kohë arrinin në genocid, sipas përkufimit të Kombeve të Bashkuara. Qeveria nuk pranoi të ndjekë rekomandimet e hetimit për ngritjen e një komisioni për të llogaritur pagesat e kompensimit për fëmijët e grabitur.

Siç e pamë, trajtimi çnjerëzor, masakrat, mizoria, barbarizmi dhe shfarosjet e kryera justifikoheshin nga tezat e Darwinizmit të "përzgjedhjes natyrore", "luftës për mbijetesë", dhe "mbijetesës së më të fortit".

Të gjithë këto tmerre që përjetuan vendasit australianë ishin veçse një pjesë e vogël e katastrofave që Darwinizmi i ka shkaktuar kësaj bote.

## Ota Benga

Pasi Darvini deklaroi në librin "*Origjina e llojeve*" se geniet njerëzore ishin zhvilluar prej një paraardhësi të përbashkët me majmunët, nisi kërkimi i fosileve për të mbështetur këtë skenar, por disa evolucionistë besonin se krijesat "gjysmëmajmun-gjysmënjeri" mund të gjendeshin jo vetëm në të dhënat fosile, por edhe të gjalla në vise të ndryshme të botës. Në fillim të shekullit XX, kërkimet për "hallkën që mungon" ishin shkaku i shumë akteve barbare. Një prej tyre ishte historia e pigmentit Ota Benga.

Ota Benga u kap në Kongo prej një studiuesi evolucionist, të quajtur Samuel Verner, në vitin 1904. Ky vendas, emri i të cilit në gjuhën e tij do të thoshte "mik", ishte i martuar dhe baba i dy fëmijëve, por ai u lidh me zinxhirë si një kafshë, u fut në një kafaz dhe u dërgua në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Atje, shkencëtarët evolucionistë e futën në një kafaz me lloje të ndryshme majmunësh në Panairin Botëror të Shën Luisit dhe e ekspozuan si "hallka lidhëse më e afërt me njeriun".

Dy vjet më vonë, atë e çuan në kopshtin zoologjik të Bronksit në Nju Jork dhe e ekspozuan bashkë me disa

shimpanze, një gorillë të quajtur Dinah dhe një orangutang të quajtur Dohung si "paraardhësit më të vjetër të njeriut". Drejtori evolucionist i kopshtit zoologjik, Dr. William T. Horniday, mbante ligjërata të gjata për krenarinë që i falte "hallka që mungon" dhe vizitorët e trajtonin Ota Bengën në kafazin e tij si një kafshë të zakonshme. Në një numër të gazetës "New York Times", botuar në atë kohë, qëndrimet e vizitorëve përshkruheshin kështu:

Kishte rreth 40000 vizitorë në park të dielën. Pothuajse të gjithë, burra, gra e fëmijë, u drejtuan për nga kafazi i majmunit për të parë atë që ishte në qendër të vëmendjes në park: njeriun e egër nga Afrika. Ata e ndiqnin pas nëpër park gjithë ditën, duke angullirë, përqeshur, ulëritur. Disa prej tyre e shponin në brinjë, të tjerë e pengonin që të rrëzohej e të gjithë talleshin me të.<sup>37</sup>

Numri i 17 shtatorit 1906 i "New York Journal" shkruante se kjo bëhej për të vërtetuar evolucionin, por, njëkohësisht,

**Ota Benga  
Ota Benga ishte  
afrikan vendas. Ai u zu  
në çark si një kafshë  
nga studiuesit  
evolucionistë, u fut në  
një kafaz dhe u  
ekspozua përkrah  
majmunëve në një  
kopësht zoologjik.**



gazeta në fjalë e kritikonte ashpër si një padrejtësi dhe mizori të madhe me këto fjalë:

Këta njerëz pa tru e pa e vrarë shumë mendjen, kanë ekspozuar në një kafaz majmunësh, një xhuxh të vogël nga Afrika. **Qëllimi i tyre, ndoshta, ishte të ngulitnin ndonjë mësim të thellë për evolucionin.**

Në fakt, i vetmi rezultat i arritur ka qenë ruajtja e përçmimit për racën afrikane, e cila meriton të paktën simpati dhe mirësi nga të bardhët e këtij vendi, pas gjithë atij brutaliteti që ka hequr në kurriz këtu...

Eshtë turp dhe e neveritshme që të metat fizike të një genieje njerëzore, të krijuar prej së njëjtës Fuqi që na ka sjellë të gjithëve këtu dhe na ka dhuruar të njëjtat ndjenja dhe të njëjtin shpirt, të mbyllet në një kafaz me majmunë dhe të bëhet gazi i botës.<sup>38</sup>

Gazeta "New York Daily Tribune", gjithashtu, i kushtoi hapësirë çështjes së ekspozimit të Ota Bengës në një kopsht zoologjik duke pasur për qëllim demonstrimin e evolucionit. Drejtori darvinist i kopshtit zoologjik u mbrojt në mënyrë krejt të paskrupullt:

Ekspozimi i një pigmeni afrikan në të njëjtin kafaz me një orangutang në Parkun Zoologjik të Nju Jorkut javën e shkuar është bërë shkas për kritika të konsiderueshme. Disa persona **deklaruan se ka qenë një përpjekje nga ana e drejtor Hornideit për të demonstruar një lidhje të ngushtë mes zezakëve dhe majmunëve.** Dr. Hornidei e mohoi një gjë të tillë. "Në qoftë se ai djalosh i vockël gjendet në kafaz", u shpreh dr. Hornidei, "kjo ndodh sepse ai ndjehet më rehat atje dhe sepse ne s'kemi as idenë më të vogël se çfarë të bëjmë tjetër me të. Ai s'është i burgosur në asnjë kuptim të fjalës, vetëm se askush nuk do të mund të thoshte se do të ishte gjë me mend ta linim të sorollatej nëpër qytet pa dikë që ta kishte nën kujdes."<sup>39</sup>

Ekspozimi i Ota Bengës në kopshtin zoologjik bashkë me gorillat, si të ishte kafshë, krijoi shqetësim në shumë

qarqe. Një numër fondacionesh iu drejtuan autoriteteve për ta ndaluar këtë gjë, duke thënë se Ota Benga ishte një genie njerëzore dhe se të trajtohej në atë mënyrë ishte vërtet mizore. Njëra prej këtyre kërkesave doli në gazetën "New York Globe" të 12 shtatorit 1906 në këtë mënyrë:

Redaktorit të "Globe":

Zotëri! Kam jetuar në Jug për disa vjet e si rrjedhim nuk i kam shumë për zemër zezakët, por them se ai është njeri. Mendoj se është turp i madh që autoritetet e këtij qyteti të madh ta lejojnë një pamje të tillë si ajo në Parkun e Bronksit: një djalë zezak, i ekspozuar në një kafaz majmuni...

E gjitha kjo puna e pigmenit duhet hetuar...

A.E.R.

Nju Jork, shtator, ora 12.<sup>40</sup>

Një tjetër kërkesë që Ota Benga të trajtohej si njeri ishte kjo që vijon:

### **Spektakli me njeriun dhe majmunin nuk miratohet nga Kleri**

Hirësia e tij, Dr. Mekartur, mendon se ekspozimi është degradues: "Ai që është përgjegjës për këtë ekspozim e ul veten aq sa ul afrikanin." – deklaroi Dr. Mekarturi. "Në vend që këtë djalosh të vogël ta bëjmë bishë, atë duhet ta çojmë në një shkollë për zhvillimin e atyre aftësive që i ka dhënë Zoti".

Dr. Gilberti deklaroi se tashmë kishte ndarë mendjen që ekspozimi ishte një skandal dhe se ai me priftërinj të tjerë do të bashkoheshin me dr. Mekarturin për t'u kujdesur që Bushmeni të lirohej nga kafazi i majmunit e të vendosej diku tjetër.<sup>41</sup>

Rezultati përfundimtar i gjithë këtij trajtimi çnjerëzor ishte vetëvraska e Ota Bengës, por problemi këtu ishte shumë më i madh se ai i humbjes së jetës së një njeriu. Kjo ngjarje ishte një shembull i qartë i mizorisë dhe barbarisë që nënkuptonte racizmi darvinist në praktikë.

## Eskimezët dhe zbatimi i racizmit

**S**tudiuuesi i famshëm arktik Robert Peary solli në vitin 1897 një grup eskimezësh nga Poli i Veriut në Nju Jork. Më i vogli në moshë i këtij grupi ishte një fëmijë me emrin Minik. Grupi, i cili përfshinte Minikun bashkë me të atin e tij, u ekspozua për një kohë të gjatë në "American Museum of Natural History". Gjatë asaj kohe, babai i Minikut vdiq nga sëmundjet. Miniku mbeti vetëm e i pambrojtur në Nju Jork. Një ditë prej ditësh, Mininiku pa se skeleti i babait të tij po ekspozohej në Muzeun Amerikan të Historisë së Natyrës si "një prototip i llojit". Megjithëse ai e kërkoi trupin e babait të tij, auteritetet e muzeut e refuzuan kërkesën e tij.

Edhe diçka tjetër që ia vlen të përmendet në lidhje me jetën e Minikut ishte se Robert Peary, studiuuesi që solli eskimezët në Amerikë, kishte pikëpamje raciste. Megjithëse jetonte mes eskimezëve, Peary mendonte se këta njerëz nuk ishin të barabartë me të. Sipas tij, eskimezët dhe zezakët ishin pjesëtarë të racave inferiore. Megjithëse ata ishin njerëz të fortë, inteligjentë e të besueshëm që u siguronin jetesën familjeve të tyre, ata s'ishin aq të aftë sa të bardhët... Në një rast, ai shkroi fyerjen e mëposhtme: "Shpesh më pyesin: Ç'është botës eskimezët? Janë vendosur shumë larg për të pasur ndonjë vlerë për sipërmarrje tregtare dhe, për më tepër, atyre u mungon ambicja. Ata e vlerësojnë jetën ashtu siç bën një dhelpër apo ari, thjesht nga instikti."<sup>1</sup> Qëllimi i sjelljes së eskimezëve në Amerikë u shpjegua nga një studiuues që merrej me këtë çështje: "Ç'arsye kishte Peary që i solli këta gjashtë eskimezë në Nju Jork? ...Ndoshta këta gjashtë eskimezë do të shërbenin thjesht si mostra, shumë të ngjashme me kafkat dhe skeletet që ai kishte grumbulluar më herët, madje edhe më interesante, sepse gjaku u rridhte ende ndër vena... Atë e kishin "joshur" edhe trupat e eskimezëve të tjerë që i njihte si emër, të cilët ai i kishte nxjerrë nga varret e sapohapura një vit më parë dhe i kishte mbartur me qerre drejt jugut për të hijeshuar sallonet e muzeut."<sup>2</sup>

Miniku, Ota Benga e shumë të tjerë, emrat e të cilëve nuk dihen, u trajtuan në mënyrë çnjerëzore, prej të ashtuquajturve "shkencëtarë" që i shihnin disa raca si "inferiore".

1 Ken Harper, "Give Me My Father's Body"

(Më jepni trupin e tim eti), Steerforth Press, South Royalton, Vermont f. 8

2 Ken Harper, "Give Me My Father's Body" (Më jepni trupin e tim eti),

Steerforth Press, South Royalton, Vermont, f. 22

# Mentaliteti racist ekziston ende dhe e gjen forcën te Darvini...



Muslim News / nëntor 2000

## Racist prison murder

By Nassos Choufary

A racist attack left 39-year-old Zahad Mahmud in a fatal coma just hours before he was due to be released. The deed of severe head injuries and brain damage. Psychiatrist, Robert Stewart, was sentenced to life imprisonment at Kingston Crown Court earlier this month. Judge Mr Justice Grieve said, "as you are a danger to yourself and a danger to the public, custody for life is wholly appropriate". Stewart pleaded not guilty and when he was found guilty this was turned against him, he violently abused the justice and showed a tremendous "disregard to Mahmud's family".

Zahad was just hours away from being released from Feltham Young Offenders Institute after he spent 90 days in custody for stealing £16 worth of clothes

stealing by his victim, holding a table leg in his right hand. Zahad was lying on his blood-soaked bed. Nicholson said, "The looked shell-shocked or something. He said: 'It was an accident. Guy'." When asked why he carried out the attack, Stewart simply replied, "Because I felt like it." It was found that Stewart harbored extreme racist views. In one letter to a friend, Stewart wrote, "I'm going to teach the Asian community of Great Britain... it's all about immigrants getting trampled into them. Rastasians, Pakis, Peggars, Chindies, taking over the country and using us to breed half-racism." In a racist rant, it emerged he had written of murdering his cell-mates, "If I don't get beat on the 17 I'll take extreme measures to get stopped out. I'll kill me f\*\*\*\*r and make it 17 times in 17 days and then

in the very question posed by Solicitor for the Mahmud Family, Imran Khaliq believes that the institutions involved in this case, Feltham Young Offenders Institution and the Probation Service are not wholly innocent in the matter. Director General of the Probation Service, Martin Mearns, said, "Zahad Mahmud's murder was a wicked act by someone whom we now know to be racist." Just how true is this statement? The truth is that prison staff know it well that Stewart held extreme racist prejudices, had violent tendencies and displayed unquestionable hatred but they proceeded to place Mahmud in same cell as him. Stewart's prison showed that he had 18 previous convictions over 18 years including actual bodily harm and common assault. He had

## **Superioriteti vjen nga karakteri e jo nga gjaku**

Përshkrimi i qenieve njerëzore nga Darvini si lloje të zhvilluara kafshësh dhe paraqitja e disa racave si raca që nuk e kanë përfunduar zhvillimin e tyre, ishin jashtëzakonisht të rrezikshme dhe shkatërruese në historinë njerëzore. Ata që e morën këtë pretendim të Darvinit si udhërrëfyesin e tyre, i shtypën pa mëshirë racat e tjera, i detyruan të jetonin në kushtet më të këqija dhe bënë ç'kishin në dorë për t'i shfarosur.

Bryan Appleyard, autor i librit "Brave New Worlds", shpjegon mentalitetin tiranik në themel të racizmit dhe pasojat e tij në këtë mënyrë:

Çështja është se sapo njerëzit vendosin që ti je një krijesë më e ulët për çfarëdo lloj arsyeje, qoftë supersticioze apo shkencore, duket se s'ka kufi deri në ç'masë arrin mizoria e tyre. Ka shumë të ngjarë që të të shkaktojnë vuajtje duke u ndjerë plotësisht të justifikuar, sepse ata i ndan veçse një hap i vogël nga besimi se një qenie tjetër njerëzore është inferiore, për tek besimi se kjo qenie është e dëmshme, e rrezikshme apo kërcënuese për qeniet "superiore". Dhe vërtet, disa mund ta përgjithësojnë çështjen edhe më shumë dhe të këmbëngulin që të gjitha qeniet "inferiore" janë të rrezikshme, sepse ata kërcënojnë jetën apo shëndetin e të gjithë racës njerëzore. Atëherë ata mund të mbështesin idenë e sterilizimit, kufizimeve në martesë apo edhe vrasjeve për të parandaluar cënimin e integritetit të llojit prej të dëbuarve nga shoqëria.<sup>42</sup>

Megjithatë, të gjitha qeniet njerëzore janë krijuar të barabarta. Në Kuran bëhet i ditur krijimi i qenieve njerëzore në këtë mënyrë:

**Zoti është Ai që krijoi gjithçka në mënyrë të përsosur dhe e nisi krijimin e njeriut nga balta. Pastaj krijoi pasardhësit e tij nga një pjesë e një lëngu themelor. Më pas i dha formë dhe fryu Shpirtin e Tij në të... (Sure Es-Sexhde: 7-9)**

Çdo qenie njerëzore, pa dallim race, mendon, ndjen, dashuron, vuan, emocionohet, njeh dashurinë, afrimitetin,

ngrohtësinë e dhembshurinë. Çdo njeri njeh, gjithashtu, tiraninë, përbuzjen dhe vështirësinë. Për këtë arsye, gjatë gjithë historisë, ata që besojnë se popujt e racave të tjera janë kafshë gjysmë të zhvilluara, ata që fyejnë të tjerët, ata që shfrytëzojnë qoftë edhe një njeri të vetëm dhe ata që i përkrahin këto praktika me teoritë e tyre të rreme, kanë bërë një krim të madh ndaj njerëzimit me injorancën e tyre.

Në kohët tona ekzistojnë kultura të shoqërive njerëzore relativisht të pazhvilluara. Të gjithë këta njerëz kanë tipare njerëzore, por u mungojnë ato kritere që, nga aspekti teknik e kulturor, në përgjithësi, sundojnë botën. Për shkak të kushteve klimatike e natyrore, shumë komunitete kanë jetuar të izoluar nga shoqëria e përgjithshme botërore dhe kanë zhvilluar kultura krejt të ndryshme, por në secilën prej tyre i gjen të gjitha tiparet, zakonet e traditat që janë të përbashkëta për gjithë njerëzimin.

Ata që kanë përfitime nga racizmi, e përqaftuan me entuziazëm teorinë e Darvinit dhe i konsideruan ata njerëz, që s'ndryshonin aspak nga të tjerët, si anëtarë të një race inferiore, madje edhe si kafshë. Si rezultat i kësaj pikëpamjeje, edhe në ditët tona ka njerëz që shtypin e përbuzin njerëzit dhe bashkësitë e prapambetura, me pretekstin se këta nuk kanë evoluar aq sa duhet.

Sidoqoftë, Zoti e ndalon rreptësisht racizmin. Ai i krijoi të gjithë njerëzit me ngjyrë e me gjuhë të ndryshme. Ky është një tregues i fuqisë dhe shumëllojshmërisë së krijimit të Tij:

**Ndër mrekullitë e Tij është krijimi i qiejve dhe i tokës, si dhe shumëllojshmëria e gjuhëve dhe e ngjyrave tuaja... (Kuran, surja Er-Rrum: 22)**



## Aleanca e tmerrshme midis Darvinit dhe Fashizmit

### Aleanca e përgjakshme mes Darvinit dhe Hitlerit

Nazizmi (Nacionalsocializmi) lindi në atmosferën kaotike të Gjermanisë, pas humbjes së saj në Luftën e Parë Botërore. Udhëheqësi i Partisë Nacionalsocialiste ishte Adolf Hitleri. Racizmi përbënte bazën e botëkuptimit të Hitlerit. Ai besonte se raca ariane, elementi bazë i kombit gjerman, ishte superiore ndaj të gjitha racave të tjera dhe duhej të sundonte mbi to. Ai ëndërronte që raca ariane të ndërtonte një perandori që do të zgjaste 1000 vjet.

Mbështetja shkencore që Hitleri gjeti për këto teori raciste ishte teoria e Darvinit.

Këshilltari më i rëndësishëm i Hitlerit, historiani racist gjerman Heinrich Von Treitschke, ishte mjaft i ndikuar nga teoria e evolucionit dhe i mbështeste pikëpamjet e tij raciste të Darwinizmi. Ai thoshte se **"kombet mund të arrijnë zhvillim vetëm në kushtet e një konkurrence të fortë si përzgjedhja natyrore e Darvinit"** dhe deklaronte se kjo do të thoshte luftë e përhershme dhe e pashmangshme. Ai ishte i mendimit se **"të zaptosh me anë të shpatës është një mënyrë për t'i sjellë qytetërim barbarizmit dhe dituri injorancës"**. Ai shkruante:

**"Raca e verdhë s'ia thotë fare për aftësi artistike dhe liri politike. Është fati i racës së zezë që t'u shërbejë të bardhëve dhe të jetë objekt i përçmimit të tyre në përjetësi..."**<sup>43</sup>

Ndërkohë që Hitleri zhvillonte teoritë e tij, ai gjeti frymëzim, ashtu si dhe Treitschke, te Darvini dhe

sidomos tek ideja e Darvinit mbi luftën për mbijetesë. Për librin e tij famëkeq "Mein Kampf" (Lufta Ime), ai ishte frymëzuar pikërisht nga ideja e kësaj lufte për mbijetesë. Ashtu si Darvini, Hitleri u dha racave joevropiane statusin e majmunëve dhe tha: "Po hoqët gjermanët nordikë, s'mbetet gjë tjetër përveç vallëzimit të majmunëve."<sup>44</sup>

Në mitingun e partisë në vitin 1933 në Nuremberg, Hitleri shpalli se "një racë superiore e nënshtron një racë inferiore... një e drejtë që e vërejmë në natyrë dhe që mund të konsiderohet si e vetmja e drejtë e imagjinueshme", sepse mbështetet te shkenca.<sup>45</sup>

Hitleri, i cili besonte në epërsinë e racës ariane, mendonte se epërsia i ishte dhënë kësaj race nga natyra. Në librin "Mein Kampf", ai shkruan si vijon:

Çifutët formojnë një kundër-racë nën-njerëzore, të destinuar për ligësi nga trashëgimia biologjike, ashtu siç është e



Hitleri dhe libri i tij "Mein Kampf", në të cilin ai shpalosi ideologjinë e tij.

**destinuar raca nordike për fisnikëri...** Historia do të arrijë kulmin me një perandori të re mijëvjeçare me një shkëlqim të paparë, e mbështetur në një hierarki racore të re, të caktuar prej vetë natyrës.<sup>46</sup>

Hitleri, i cili ishte i mendimit se qeniet njerëzore ishin kafshë të një shkalle të lartë zhvillimi, besonte se në vend që t'ua linte në dorë kontrollin e evolucionit forcave të natyrës apo fatit, me një fjalë rastësisë, ishte e domosdoshme ta merrte vetë në dorë zhvillimin e racës njerëzore. Ishte pikërisht ky qëllimi final i lëvizjes naziste. Që të realizonte këtë qëllim, hapi i parë ishte të ndante e të izolonte racat inferiore nga raca ariane, raca që ata besonin se ishte superiore.

Në këtë gjendje, nazistët iu futën punës për zbatimin e Darwinizmit dhe morën si shembull "Teorinë e Eugjenisë", që e kishte burimin te Darwinizmi.

### **Teoria e Eugjenisë mbështetej tek idetë darviniste**

Teoria e Eugjenisë, e cila u shfaq në gjysmën e parë të shekullit XX, kishte për qëllim spastrimin e të sëmurëve dhe handikapatëve dhe përmirësimin e racës njerëzore duke rritur numrin e individëve të shëndetshëm. Sipas Teorisë së Eugjenisë, sikurse shfaqen lloje më të mira kafshësh, duke kryqëzuar kafshë të shëndetshme me njëra-tjetrën, ashtu mund të përmirësohet edhe raca njerëzore.

Siç mund të pritet, ata që e paraqitën programin e Eugjenisë ishin darvinistët. Në krye të valës eugjenike në Angli u vu kushëriri i Çarls Darvinit, Frensis Galton dhe i biri i Darvinit, Leonard Darvini.

Ishte e qartë se ideja e Eugjenisë ishte rezultat i natyrshëm i Darwinizmit. Në fakt, kësaj të vërtete iu kushtua një rëndësi e veçantë në ato botime që përkrahnin Eugjenisë. Në to thuhej: "Eugjenia është marrja përsipër nga ana e njeriut e evolucionit të vet."

Kenneth Ludmerer, historian mjeksie në universitetin e Uashingtonit, vuri në dukje se ideja e

Eugjenisë është aq e vjetër, sa "Republika" e Platonit, por ai shtoi, gjithashtu, se Darwinizmi ishte arsyeja që u ngjall interesimi për idenë e hedhur në shekullin XIX:

"...mendimi i Eugjenisë moderne lindi vetëm në shekullin XIX. Ngjallja e interesimit për Eugjeninë gjatë atij shekulli kishte rrënjë të shumta. Më e rëndësishmja ishte teoria e evolucionit, sepse idetë e Frensis Galtonit mbi Eugjenitikën – dhe ishte pikërisht ai që krijoi termin "Eugjeni" – ishin rrjedhim logjik i drejtpërdrejtë i doktrinë shkencore të shtjelluar prej kushëririt të tij, Darvinit."<sup>47</sup>

Në Gjermani, i pari që u ndikua dhe e përhap i Eugjeninë ishte biologu i famshëm evolucionist Ernst Haeckel, i cili ishte mik i ngushtë dhe përkrashtues i Darvinit. Për të mbështetur teorinë e evolucionit, ai paraqiti tezën e "përsëritjes", sipas së cilës embrionet e ndryshme të qenieve të gjalla ngjasonin me njëra-tjetrën. Më vonë u zbulua se si ai kishte fallsifikuar të dhënat kur kishte nxjerrë këtë pretendim.

Kur, nga njëra anë, Haeckel bënte mashtrime shkencore të këtij lloji, nga ana tjetër, i bënte propagandë eugjenike. Ai sugjeroi që fëmijët handikapatë të sapolindur të vriten menjëherë, sepse kjo, sipas tij, do të përshpejtonte evolucionin e shoqërisë. Ai shkoi edhe më tej, duke thënë se leprozët dhe njerëzit e sëmurë me kancer dhe me sëmundje mendore duhet të vriten pa iu dhimbsur kujt. Përndryshe këta njerëz do t'i bëheshin barrë shoqërisë dhe do të ngadalësonin evolucionin. Studiuesi amerikan Xhorxh Stein e përmbledhi besnikërinë e verbër të Haeckel ndaj teorisë së



**Frensis Galton**



**Leonard Darvini**

evolucionit në një artikull të tijin në revistën "American Scientist" në këtë mënyrë:

... Ai [Heackel] ishte i mendimit se Darvini kishte të drejtë... njerëzimi, pa dyshim, kishte evoluar nga mbretëria e kafshëve. Si rrjedhim, (dhe këtui hapi fatal ishte hedhur me prezantimin e parë të rëndësishëm të Darwinizmit nga Heackel në Gjermani), ekzistenca shoqërore dhe politike e njerëzimit drejtohet nga ligjet e evolucionit, përzgjedhja natyrore dhe biologjia, siç tregohet qartë nga Darvini. Të mendoje ndryshe ishte bestytni.<sup>48</sup>

Heackel vdiq në 1919, por idetë e tij u trashëguan nga nazistët. Pak kohë pas ardhjes në pushtet të Hitlerit, nisi një program zyrtar Eugjenik. Hitleri e përmbodhi politikën e re në këto fjali:

Në pushtetin popullor, stërvitja e mendjes dhe e trupit do të luajë një rol të rëndësishëm, por edhe përzgjedhja njerëzore është po aq e rëndësishme.... Shteti ka për detyrë të shpallë si të papërshtatshëm për qëllime riprodhimi cilindo që duket qartë se është i sëmurë apo jo i shëndoshë gjenetikiisht dhe **duhet ta çojë deri në fund këtë detyrë pa mëshirë, pavarësisht nga mirëkuptimi apo mungesa e mirëkuptimit nga ana e ndonjërit. Ndalimi i riprodhimit të personave me të meta trupore apo mendore për një periudhë kohe prej vetëm 600 vjetësh do çonte në përmirësim të shëndetit të njeriut, gjë që s'mund të përfytyrohet në ditët e sotme.** Po të realizohej dhe planifikohej pjelloria e anëtarëve më të shëndetshëm të racës, rezultati do të ishte një racë, e cila do t'i kishte humbur farat e kalbjes trupore dhe shpirtërore që bartim ne sot.<sup>49</sup>

Si domosdoshmëri e kësaj politike të ndjekur nga Hitleri, të sëmuret me të meta mendore, invalidët, të verbërit që nga lindja, si dhe individët me sëmundje gjenetike në shoqërinë gjermane, u mblodhën në "qendra sterilizimi" të veçanta. Këta njerëz konsideroheshin si

parazitë të dëmshëm për pastërtinë dhe përparimin evolucionar të racës gjermane. Pak më vonë, në fakt, ata njerëz që ishin spastruar nga shoqëria filluan të vriten me urdhër të fshehtë të Hitlerit.

Këto vrasje u paraqitën si krejt të arsyeshme dhe ata që pranoheshin si inferiorë gjenetikisht, përshkruheshin si "pa përfitim" dhe pengesë për zhvillimin e kombit. Grupe të shumta, duke përfshirë raca e popuj të ndryshëm, që shiheshin si raca inferiore, dalëngadalë filluan të përfshihen në listë. Më vonë u përfshinë njerëzit e sëmurë e të moshuar, ata me verdhëz, ata me të meta të rënda mendore, shurdhmemecët, madje dhe ata me sëmundje të pashërueshme. Kur atleti zezak Xhesi Ouens fitoi 4 medalje ari në Lojrat Olimpike të Berlinit në 1936, Hitleri, edhe pse i uroi të gjithë konkuresit, nuk pranoi të uronte Xhesi Ouensin dhe u largua nga stadiumi. Disa evolucionistë, madje, mbështetën pikëpamjen se femrat ishin inferiore ndaj meshkujve nga pikëpamja e evolucionit.

Dr. Robert Vartenberg, profesor i shquar i neurologjisë në Kaliforni, u përpoq të vërtetonte inferioritetin e femrave duke thënë se ato nuk do të mund të mbijetonin, po mos të kishin "mbrojtjen e meshkujve". Ai arriti në përfundimin se, për shkak se femrat që ishin më të dobta nuk eliminoheshin me shpejtësi falë kësaj mbrojtjeje, kjo sillte ngadalësim në procesin e evolucionit dhe për këtë arsye, përzgjedhja natyrore nuk vepronte aq shumë te femrat sa ç'vepronte te meshkujt. Në bazë të këtyre mendimeve, në Gjermaninë Naziste femrat ndalohehin hapur që të ushtronin profesione të caktuara.<sup>50</sup>

Menjëherë pas zhvillimit të Darwinizmit dhe idesë së Eugjenitikës, në Gjermani, "shkencëtarët racistë" mbështetën hapur vrasjen e anëtarëve dhe segmenteve të padëshiruara të popullsisë. Një prej këtyre shkencëtarëve, Adolf Jost, "nxorri një thirrje për vrasje të drejtpërdrejtë mjekësore" në një libër të botuar në vitin 1895, "Das Recht auf den Tod" (E drejta për vdekjen).

Josti ishte i mendimit se **"për hir të shëndetit të organizmit shoqëror, shteti duhet të marrë përsipër vdekjen e individëve"**. Adolf Jost ishte udhëheqësi

shpirtëror i Hitlerit, që u shfaq në skenën politike pothuajse 30 vjet më vonë. "Shteti duhet të kujdeset që vetëm të shëndetshmit të lindin fëmijë,"- thoshte Hitleri. "Ai duhet të shpallë si të papërshtatshëm për riprodhim të gjithë ata që kanë ndonjë lloj sëmundjeje apo që kanë trashëguar ndonjë mangësi e, si rrjedhim, mund ta lënë trashëgimi te të tjerët".<sup>51</sup>

Në bazë të një ligji të nxjerrë në vitin 1933, 350.000 njerëz me të meta mendore, 30.000 evgjitë dhe qindra fëmijë zezakë u sterilizuan me metoda të tilla si tredhja, rrezet X, injektimet dhe shoku elektrik në zonën e organeve gjinitale. Një oficer nazist, ka thënë: "Nacionalsocializmi s'është gjë tjetër, veçse biologji e vënë në jetë".<sup>52</sup>

Përveç përpjekjeve për të përshpejtuar zhvillimin e racës gjermane me anë të vrasjes dhe politikave të pamëshirshme kundër njerëzve të pafajshëm, Hitleri po praktikonte edhe një formë tjetër të Eugjenitikës. Gra e burra bjondë e



Hitleri mblodhi vajza gjermane bjonde e sykaltra në një kamp dhe u sigurua që ato të shkonin me oficerët e forcave speciale (SS). Në këtë mënyrë, ai ëndërronte të krijonte një racë superiore.

sykaltër, të pranuar si përfaqësues të racës gjermane, u inkurajuan të krijonin lidhje e të bënë fëmijë. Në 1935 "ferma" të veçanta riprodhimi u krijuan për këtë qëllim. Këto ferma, ku u vendosën vajza të reja që i plotësonin kriteret raciste, shpesh frekuentoheshin prej njërive të forcave speciale (SS). Fëmijët e jashtëligjshëm që lindnin në këto ferma rriteshin si ushtarë të mbretërisë së ardhshme gjermane njëmijë vjeçare.

### **Devijimi ariano-racor i nazistëve**

Nazistët përdorën përsëri koncepte darviniste për të vërtetuar superioritetin e racës ariane.

Darvini kishte pretenduar se me evoluimin e njerëzve zmadhohej edhe kafa e tyre. Nazistët e përqafulan fort këtë ide dhe ia nisën punës për matjen e kafkave, për të treguar se raca gjermane ishte superiore. Në çdo cep të

Gjermanisë naziste u bënë krahasime që tregonin se kafkat gjermane ishin më të mëdha sesa ato të racave të tjera. Dhëmbët, sytë, flokët dhe tipare të tjera u



**Ashtu si Hitleri, Heinrich Himmler, shefi i gestapos, si dhe oficerë të tjerë nazistë kishin pikëpamje darviniste dhe kjo i bënte të kishin ide raciste e mizore.**



vlerësuan në bazë të përmasave evolucionare. Individët që nuk përkonin me përmasat e kërkuara, duhej të shfaroseshin në emër të parimeve të Eugjenitikës.

E gjitha kjo marrëzi u krye në emër të zbatimit të parimeve darviniste në shoqëri. Historiani amerikan Michael Gordin, autor i librit "The Nazi Doctors and the Nuremberg Code" (Mjekët nazistë dhe kodi i Nurembergut), e zbulon realitetin në këtë mënyrë:

Unë mendoj se ajo që ndodhi ishte një kombinim i përsosur i ideologjisë naziste, Darwinizmit Social dhe higjenës racore, ashtu siç u shfaq në fund të shekullit XIX.<sup>53</sup>

Xhorxh Stein e shpjegon këtë dukuri:

Nacionalsocializmi, apo çfarëdo të ketë qenë, në fund të fundit ka qenë përpjekja e parë, plotësisht e ndërgjegjshme, për të organizuar një bashkësi politike, duke u mbështetur tek një biopolitikë e hapur: **një biopolitikë në përputhje të plotë me faktet shkencore të revolucionit darvinian.**<sup>54</sup>

Evolucionisti me famë. Sir Arthur Keith, shprehet për Hitlerin si vijon:

**Fyreri gjerman është evolucionist;** ai me vetëdije të plotë ka kërkuar ta bëjë praktikën e ndjekur në Gjermani të përputhet me teorinë e evolucionit.<sup>55</sup>

Autori i librit "*Darwin: Before and After*", Robert Clarke, nxori përfundimin se Adolf Hitleri "... ishte magjepsur nga mësimet evolucioniste, ndoshta, qysh në vegjëli. Hitleri arsyetonte se një racë më e lartë do të sundonte gjithmonë mbi një më të ulët."<sup>56</sup> Filozofia politike e Gjermanisë naziste mori formë nën ndikimin e këtyre ideve të Hitlerit.

Autori i librit "Raca dhe Rajhu", Joseph Tenenbaum shkruan se filozofia politike e Gjermanisë ishte ndërtuar në bazë të bindjes se për ecjen përpara të evolucionit ishin të domosdoshme:

... lufta, seleksionimi natyror dhe mbijetesat e më të

fortit, të gjitha këto nocione dhe vëzhgime studimore të arritura...nga Darvini... por tashmë të zhvilluara që në embrion në filozofinë shoqërore gjermane të shekullit XIX... Në këtë mënyrë, u zhvillua doktrina e të drejtës së natyrshme të Gjermanisë për të sunduar botën në bazë të fuqisë supreme... [të një] marrëdhënieje "çekani dhe kudhre" mes Rajhut dhe kombeve më të dobta.<sup>57</sup>

Adolf Hitleri nuk ishte i vetmi ndër udhëheqësit nazistë në "luftën e tij të evolucionit ideologjik." Hainrih Himler, kreu i gestapos, "pohoi se ligji i natyrës duhet të bëjë të vetën në luftën për ekzistencë." Në fakt, të gjithë udhëheqësit nazistë i ishin kushtuar evolucionit dhe racizmit gjerman, ashtu sikurse vlerësonin shumica e shkencëtarëve dhe industrialistëve gjermanë gjatë atyre viteve të mallkuara.<sup>58</sup>



## **Urrejtja e Hitlerit për fenë**

Një arsye tjetër që shpjegon rëndësinë e madhe që Hitleri i dha teorisë së evolucionit ishte se ai e shikonte teorinë si një armë kundër besimit fetar. Hitleri ndjente një urrejtje të thellë për fetë me origjinë hyjnore. Virtytet morale si dhembshuria, mëshira dhe përvulësia, të urdhëruara nga këto fe, përfaqësonin një pengesë të madhe për njeriun arian të pamëshirshëm dhe luftëtar që nazistët donin të krijonin. Kjo ishte arsyeja që, sapo erdhën në fuqi nazistët në vitin 1933, u përpoqën ta kthenin shoqërinë gjermane në besimet e hershme pagane. Kryqi i thyer (Swastika), simbol nga kulturat e vjetra pagane, ishte një shenjë e këtij rikthimi. Ceremonitë naziste, të mbajtura në çdo cep të Gjermanisë, përbënin një kthim në ritet e lashta pagane. Ideja e evolucionit, trashëgim nga kulturat pagane, shkonte për mrekulli me ideologjinë e Nazizmit. Hitleri një herë zbuloi qëndrimin e tij ndaj Krishtërimit kur e tha hapur se feja është:




**Këto fotografi përmbledhin  
vuajtjen, frikën, tmerrin dhe  
ankthin që i shkaktuan njerëzimit,  
Hitleri dhe ata që mendonin si ai.  
Darwinizmi, i cili ishte burimi i  
parë i këtij makthi, ende vazhdon  
t'i shkaktojë vuajtje njerëzimit  
kudo në botë.**





Fotografi  
që  
tregojnë  
gjendjen e  
njerëzve  
gjatë Luftës  
së Dytë  
Botërore.



Hitleri ishte shkaktar i vrasjeve  
të miliona njerëzve. Ideologjia e  
tij çnjerëzore mbështetej te tezat  
e Darvinit për racat superiore dhe  
inferiore. Ai nuk ngurroi t'i vriste  
ata që i gjykonte si raca inferiore.



Postera nga koha e Hitlerit  
që simbolizonin vrasjet e  
bëra në emër të tij.

... gënjeshtër e organizuar [që] s' duhet t'i mbetet as nam as nishan. Shteti duhet të mbetet padroni absolut. Kur isha më i ri, mendoja se ishte e domosdoshme t'i vihesh [shkatërrimit të fesë] ...me dinamit... Situata përfundimtare duhet të jetë... në *Fronin e Shën Pjetrit*, një prift shërbyes i kaluar në moshë; ballë për ballë me të, ca plaka ogurzeza... Të rinjtë dhe të shëndetshmit janë në anën tonë... Popujt tanë më parë kanë arritur të jetonin mirë e bukur edhe pa këtë fe. Unë kam gjashtë divizione me forca speciale (SS) krejt indiferentë ndaj çështjeve të fesë.<sup>59</sup>

Daniel Gasman i bëri të njohura arsyet e urrejtjes së Hitlerit për fenë në librin e tij "Origjina shkencore e Nationalsocializmit":

Hitleri theksoi dhe veçoi idenë e evolucionit biologjik si armën kryesore kundër fesë tradicionale dhe vazhdimisht dënonte Krishtërimin, sepse ky i fundit kundërshtonte mësimet e evolucionit... Për Hitlerin, evolucioni ishte vula e shkencës dhe e kulturës bashkëkohore.<sup>60</sup>

Faktikisht, shkaku themelor i katastrofave të panumërta që përjetoi bota në shekullin XX ishte karakteri i njerëzve të tillë si Hitleri dhe nazistëve të pafe. Këta njerëz që mohonin ekzistencën e Zotit dhe besonin se qeniet njerëzore kishin evoluar derisa u bënë kafshë të zhvilluara, e shihnin veten si të pakontrolluar, pa kurrëfarë përgjegjësie në botë. Imoraliteti dhe tirania e tyre nuk njihte kufij dhe për këtë arsye ata vranë pa pikë mëshire miliona njerëz. Vështirësitë dhe vuajtjet që lindin në një shoqëri pa fe shihen qartë në shembullin e Hitlerit, Stalinit, Mao Ce Dunit, Pol Potit, Frankos, Musolinit e të tjerë, të cilët e mbytnë në gjak shekullin XX. Sigurisht që duhet nxjerrë një mësim nga makthi që vjen nga mungesa e fesë.

### **Katastrofat e shkaktuara nga Darvino fashisti Musolini**

Në të njëjtën mënyrë që Hitleri përcaktoi politikën e

tij duke përdorur Darwinizmin, po kështu, bashkëkohësi dhe aleati i tij, Benito Musolini, shfrytëzoi pretendimet dhe konceptet darviniste që të hidhte themelet e një Italie imperialiste dhe fashiste.

Musolini ishte një evolucionist kokë e këmbë, i cili mendonte se dhuna kishte qenë një forcë shtytëse në histori dhe se lufta çonte në revolucion. Për të, "mungesa e dëshirës nga ana e Anglisë për të marrë pjesë në luftë shërbeu vetëm për të vërtetuar dekadencën evolucioniste të Perandorisë Britanike."<sup>61</sup>

Në ballë të revistës "Il popolo d'Italia", të cilën e krijoi me ndihmën financiare të qeverisë franceze, ai vuri shprehjen: "Kush ka hekur, do të ketë edhe bukë". Me fjalë të tjera, ai po u thoshte njerëzve se që të mbushnin barkun, atyre u duhej forca e hekurt për të zhvilluar luftë.

Musolini zgjodhi sëpatën si simbol të fashizmit dhe partisë fashiste, sepse sëpata ishte simbol i luftës, dhunës, vdekjes dhe masakrës.

Mënyra e sjelljes së Musolinit, agresive dhe e prirur për dhunë, si e çdo fashisti, përshkruhet në librin e Denis Mack Smith. Në librin e tij, Smith shkruan se një prej besimeve të patundura të Musolinit ishte agresioni dhe instikti i tij bazë ishte përdorimi i dhunës.<sup>62</sup>

Politika agresive dhe shtypëse e Musolinit çoi në masakrimin e shumë njerëzve, lënien e tyre pa shtëpi e familje dhe shndërrimin e vendit në gërmadhë. Dhuna dhe shtypja u praktikuan nëpërmjet këmishëzinjve, jo vetëm në vendin e vet, por edhe në vendet e tjera. Në vitin 1935 ai pushtoi Etiopinë dhe deri në vitin 1941 kishte shfarosur 15.000 njerëz. Ai nuk vonoi të mbronte dhe të justifikonte pushtimin e Etiopisë me pikëpamjet raciste të Darwinizmit. Sipas Musolinit, etiopiasit ishin inferiorë, sepse ata bënë pjesë në racën e zezë dhe duhet ta kishin për nder të qeveriseshin nga një racë superiore si italianët.

Nga ana tjetër, ai e vazhdoi shtypjen e popullsisë muslimane të Libisë, të cilën e pushtoi më 3 tetor 1911

dhe. Pushtimit i erdhi fundi vetëm pas një marrëveshjeje të arritur më 10 shkurt 1947. Gjatë asaj periudhe, 1.5 milionë libianë ranë dëshmorë dhe qindra mijëra u plagosën.

Musolini, që ka hyrë në histori për mizorinë dhe shtypjen e tij, e përshkroi kështu Fashizmin që ai përkrahu dhe vuri në jetë, në një fjalim:

Fashizmi nuk është më çlirim, por tirani, s'është më mburoja e kombit, por mbrojtja e interesave vetjake.<sup>63</sup>

Siç pamë nga shembujt e Hitlerit dhe Musolinit, Fashizmi, ku të fortët dhe mizorët kanë gjithmonë të drejtë e janë superiorë dhe ku e vetmja mënyrë për të arritur sukses dhe zhvillim ishte përdorimi i forcës, agresionit, dhunës dhe luftës, ishte një zbatim i pretendimit të Darwinit se "të fortët jetojnë, të dobët vdesin", parim ky që bëri miliona e miliona njerëz të vuajnë.



## **Fashisti Franko dhe shtypja që solli ai në Spanjë**

Një tjetër shtypës fashist që e shndërroi shekullin XX në një det gjaku ishte Franko. Ai organizoi lëvizjen "Falange" në Spanjë me përkrahjen e fashistëve darvinistë, Hitlerit e Musolinit, dhe i shkaktoi vuajtje të mëdha e shtypje popullit të Spanjës. Frankoja e futi popullin e tij në luftë civile, duke nxitur vëllain kundër vëllait, babain kundër të birit. Gjatë luftës civile në Spanjë, mesatarisht 250 njerëz në ditë vriteshin në Madrid, 150 në Barcelonë dhe 80 në Sevilje. U kryen edhe shumë ekzekutime që u ngulitën fort në kujtesën e njerëzve. Masakra të pamëshirshme kryheshin në të gjithë vendin. Në një fshat të vogël malor në veri të Madridit, 31 fshatarë u arrestuan, sepse nuk kishin votuar për Frankon dhe, nga këta, 13 u nxorën jashtë fshatit me kamion dhe u vranë në anë të rrugës. Fashistët hynë në një qytet pranë Seviljes, me një popullsi prej 11.000 banorësh dhe vranë më shumë se 300 njerëz. Si pasojë e ngjarjeve të dhunshme që vazhduan në këtë mënyrë, rreth 800.000 njerëz u vranë në luftën civile dhe



**S'u tregua pikë mëshirë as për fëmijët në Luftën Civile të Spanjës, për të cilën shkaktar ishte Franko. Njerëzit u nxorën nga shtëpitë e tyre pa asnjë arsye dhe u qëlluan. Njerëz të pafajshëm u vranë, u**

**gjymtuan, humbën familjet dhe të dashurit e tyre. Këto s'ishin gjë tjetër, veçse pasqyrim i mizorisë fashiste në jetën e përditshme.**



200.000 të tjerë u ekzekutuan me urdhër të Frankos. Miliona u plagosën apo u gjymtuan.

### **Frankoja i dhuroi Hitlerit popullsinë e një fshati të tërë për të provuar armët e tij!**

Përkrahësit më të flaktë të Frankos në luftën civile ishin Hitleri dhe Musolini. Franko nuk e la përkrahjen e aleatëve të tij pa e shpërblyer: ai bëri një nga marrëveshjet më mizore e më të pamëshirshme në të gjithë historinë, duke u dhënë nazistëve për dhuratë qytete të vogla si Guernika, për të provuar armët e tyre të reja.

Në mëngjesin e 5 majit 1937 banorët e qytetit të vogël të Guernikës u zgjuan për të parë vdekjen që e sollën aeroplanët bombardues gjigandë dhe tonelatat me bomba, mrekullitë e reja të teknologjisë naziste. Qyteti i vogël ishte lënë nga Frankoja që të bënin prova aeroplanët e nazistëve.<sup>64</sup>

Kjo ngjarje ishte vetëm një nga frytet e asaj filozofie të çmendur që i konsideronte qeniet njerëzore si kavie laborator. Kjo filozofi, që la mijëra njerëz të vdesin vetëm e vetëm që të provohej fuqia e armëve të saj dhe që gjymtoi, dëmtoi e torturoi mijëra të tjerë, është e gjallë ende sot, e fshehur pas maskave të ndryshme. Ajo do të vazhdojë për aq kohë sa të mbahet gjallë filozofia darviniste.

### **Roli paraprak i Darwinizmit në Luftën e Parë dhe të Dytë Botërore**

Në librin e tij "Evropa që prej 1870-ës", profesori i njohur i historisë James Joll shpjegon se një prej faktorëve që çoi në shpërthimin e Luftës së Parë Botërore ishte besimi që kishin udhëheqësit e Evropës së asaj kohe tek idetë darviniste:

Kemi parë se si idetë darviniste patën ndikim të madh në ideologjinë e imperializmit në fund të shekullit XIX, por është e rëndësishme të kuptosh se sa shabllon është

marrë doktrina e luftës për ekzistencë dhe seleksionimi natyror nga pjesa më e madhe e udhëheqësve të Evropës në vitet para Luftës së Parë Botërore. Oficeri madhor austro-hungarez, p.sh., Franc Baron Conrad fon Hoetzendorff, shkroi në kujtimet e tij pas luftës:

"Fetë filantropike, parimet morale dhe doktrinat filozofike sigurisht që nganjëherë mund të shërbejnë për të dobësuar luftën e njerëzimit për ekzistencë në formën e tij më primitive, por ato nuk do t'ia dalin dot kurrë ta përjashtojnë atë si një motiv shtytës të botës... Katastrofa e luftës botërore ndodhi pikërisht në përputhje me këtë parim të madh, si rezultat i forcave shtytëse në jetën e shteteve dhe popujve, si stuhi me bubullima, e cila duhet, për nga natyra që ka, të shkarkohet."

E parë kundrejt këtij sfondi ideologjik, këmbëngulja e Konradit për nevojën e një lufte parandaluese në mënyrë që të ruhet monarkia austro-hungareze, bëhet e kuptueshme.

Kemi parë, gjithashtu, se si këto pikëpamje nuk i kishin vetëm personalitetet ushtarake dhe se Maks Veberi, p.sh., merrej shumë me luftën ndërkombëtare për mbijetesë. Edhe Kurt Ricler, ndihmësi personal dhe njeriu i besuar i kancelarit gjerman Teobald fon Betman-Holvek, shkroi në vitin 1914: "Urrejtja absolute dhe e përjetshme në marrëdhëniet mes popujve është e lindur dhe armiqësia që e vërejmë ngado nuk është pasojë e një shmangieje nga natyra njerëzore, por është thelbi i kësaj bote dhe burimi i vetë jetës."<sup>65</sup>

Fridrih fon Bernhard, gjeneral në Luftën e Parë Botërore dhe darvinist social gjerman, ishte, gjithashtu, një prej këtyre udhëheqësve. "Lufta," deklaronte Bernhard "është nevojë biologjike; ajo është aq e domosdoshme sa ç'është dhe lufta e forcave të natyrës. Ajo jep një vendim të drejtë nga ana biologjike, meqë vendimet e saj mbështeten te vetë natyra e gjërave."<sup>66</sup>

Siç e kemi parë, Lufta e Parë Botërore shpërtheu për

shkak të mendimtarëve, gjeneralëve dhe udhëheqësve evropianë, të cilët e shikonin fillimin e luftës, derdhjen e gjakut dhe shkaktimin e vuajtjeve si një lloj "zhvillimi" dhe ligj të pandryshueshëm të natyrës. Frymëzimi ideologjik që e çoi tërë këtë brez në shkatërrim me këto ide tërësisht të rreme, s'ishin tjetër veçse konceptet e Darvinit mbi "luftën për mbijetesë" dhe "racat e privileguara". Dy vjet pasi Bernardi tha këto fjalë, shpërtheu Lufta e Parë Botërore, që do të sillte zhvillim biologjik (!), duke lënë pas 8 milionë të vdekur, qindra qytete germadhë dhe miliona të plagosur, të gjymtuar, të pastrehë dhe të papunë. Rrënjët e luftës naziste, që nisi 21 vjet më vonë dhe la rreth 50 milionë të vdekur, i gjen, gjithashtu, te Darwinizmi.

Shpesh, Hitleri e lidhte politikën e tij të luftës dhe genocidit me Darwinizmin. Ai e shihte luftën, jo vetëm si mjet për të eliminuar racat më të dobëta, por, gjithashtu, edhe si forcë për të hequr qafe anëtarët e dobët të racës supreme. Gjermania naziste e lëvdonte luftën pjesërisht për këtë arsye,

**Diktatorët dhe tiranët darvinistë që besonin se lufta do t'i çonte drejt përparimit të njerëzimit, e shndërruan shekullin XX në një det gjaku. Ata përhapën dhunë anakënd botës.**



sepse në mendjet e mbrapshta lufta ishte një hap themelor për përparimin e racës.

Evolucionisti A. E. Wiggam e shpjegoi "bindjen se lufta e zhvillon njeriun", tek e cila Hitleri mbështeste politikën e tij, në një libër të botuar në vitin 1922:

... një herë e një kohë zor se mund të thuhet se njeriu kishte më shumë tru se kushërinjtë e tij antropoidë, majmunët, por, **duke shkëlmuar, duke kafshuar, duke u përleshur dhe duke ia kaluar me zgjuars armiqve të tij, truri i njeriut u zmadhua shumë dhe iu shtua mençuria e shkathtësia, në mos përmasa e tij...**<sup>67</sup>

Hitlerin e përkrahnin evolucionistë si Wiggam, ndaj dhe ai e shihte luftën si një detyrim për ata që donin të mbijetonin, gjë që e tha hapur në librin e tij "Mein Kampf":

E gjithë bota e natyrës është një betejë e fuqishme mes fuqisë dhe dobësisë, e cila pason një fitore të përjetshme të të fortit kundër të dobtit. Nuk do të kishte gjë tjetër veçse kalbëzim në të gjithë natyrën, në qoftë se nuk do ndodhte kështu. Ai që do të jetojë, duhet të luftojë. Ai që nuk do të luftojë në këtë botë, ku lufta e përhershme është ligji i jetës, nuk e gëzon të drejtën për të ekzistuar. Të mendosh ndryshe do të thotë të "fyesh" natyrën. Brengat, mundimet dhe sëmundjet janë kundërpërgjigjia e saj.<sup>68</sup>

Duke pasur parasysh pretendimet e Darvinit se i forti mbijeton pas luftës për mbijetesë dhe se llojet e zhvilluara me këtë mënyrë përshtaten në shoqëritë njerëzore, edhe lufrat nisën të shiheshin si domosdoshmëri për zhvillimin e njerëzimit. Për shembull, Hitleri deklaroi se merita për madhësinë e Gjermanisë i takon eliminimit, gjatë lufrave shekullore, të anëtarëve më të dobët të shoqërisë së saj. Gjermanët nuk e kishin të huaj luftën dhe ky justifikim i ri "shkencor" përbënte një forcë për të mbështetur politikat luftëdashëse.

Diku tjetër, Hitleri ka pretenduar se: **"qytetërimi**



## **Lufta e Vietnamit**

**Lufta e Vietnamit, në të cilën u vranë apo u plagosën më shumë se një milion njerëz nga të dy palët, la shumë njerëz në vuajtje e mjerim edhe pas mbarimit të saj. Për më tepër, shumë prej këtyre njerëzve u detyruan ta bëjnë luftën mijëra milje larg shtëpive të tyre.**



**Një baba që po u tregon trupave të Vietnamit Jugor fëmijën e tij të vvarë, gjatë ndjekjeve të forcave guerrilase të Viet Kongut.**



## **Bosnjë dhe Kosovë**

**Ngjarjet e kohëve të fundit në**

**Bosnjë e Kosovë nuk duhet të**

**harrohen kurrë. Mungesa e**

**dhembshurisë për njerëzit e pafajshëm,**

**sepse i përkisnin një feje, një race a**

**kulture tjetër, mosshtrirja e dorës për**

**ndihmë, si dhe shtypja e njerëzve të**

**pafajshëm në mes të Evropës që vazhdoi**

**prej vitesh, tregojnë qartë shthurjen**

**morale dhe mungesën e dhembshurisë që**

**mbizotëron në shekullin XX.**



## **Xhakartë**

**Gjatë kryengritjes së majit në Xhakartë, morgu i qytetit u mbush plot e përplot me të vdekur. Nga luftimet që u bënë në vend u shkatërruan qytete dhe u dogjën makina.**



## **Irlandë e veriut**

**Njerëz që jetonin me frikë e në mjerim dhe rrugë të shkatërruara si pasojë e sulmeve terroriste gjatë përlëshjeve dhjetëra vjeçare midis Britanisë së Madhe dhe Ushtrisë Republikane Irlandeze (IRA).**



**Fotografia anash tregon situatën në 1972. Fotografia poshtë atë të vitit 1986.**



**njerëzor nuk do të ekzistonte, ashtu siç e njohim sot, nëse nuk do të bëhej fjalë për luftën e vazhdueshme."**<sup>69</sup>

Në lidhje me çështjen e luftës, Heackel propozoi që të vihen në jetë metodat e spartanëve të Greqisë së Lashtë. Ai pretendoi se "duke vrarë të gjithë fëmijët, përveç atyre që ishin të fuqishëm e gëzonin shëndet të përkryer", spartanët ishin "vazhdimisht në kulmin e fuqisë dhe energjisë."<sup>70</sup>

Lufta shihej si "një rregullues i domosdoshëm" i popullsisë në të gjithë Evropën dhe jo vetëm në Gjermani. "Po të mos ishte lufta,"- shkruan darvinisti social gjerman Fridrih fon Bernhard, - "ndoshta do të shihnim se raca inferiore dhe të degjeneruara do t'ia kalonin në numër e pasuri racave të shëndetshme dhe rinore.

Rëndësia rigjeneruese e luftimeve qëndron në atë se ajo sjell përzgjedhjen dhe, kështu, lufta kthehet në një domosdoshmëri biologjike."<sup>71</sup>

Siç e kemi parë nga sa kemi treguar deri tani, Hitleri dhe ideologët nazistë që e përkrahnin atë e shihnin luftën si një domosdoshmëri me frymëzim të Darwinizmit. Duke vënë në jetë këtë domosdoshmëri, ata i shkaktuan vuajtje të ndryshme popullit të tyre dhe popujve të tjerë në botë. Nga ky këndvështrim s'do të bënim kurrfarë gabimi po ta cilësonim Çarls Darwinin si një nga përgjegjësit kryesorë për vuajtjet e shkaktuara gjatë Luftës së Dytë Botërore. Profesor Dr. Jerry Bergmann bën fjalë kështu për ndikimin e Darwinizmit mbi Luftën e Dytë Botërore:

Provat se idetë darviniste patën një efekt të jashtëzakonshëm të mendimi dhe praktika gjermane, janë shumë të qarta... Në fakt, idetë darviniste ndikuan në fillimin e Luftës së Dytë Botërore, humbjen e 40 milionë jetëve dhe vajtjen dëm të rreth 6 trilionë dollarëve. Duke qenë i bindur deri në fund se evolucioni nuk ishte një gënjeshtëri, Hitleri e konsideronte veten si shpëtimtarin modern të njerëzimit... Duke zhvilluar një racë superiore, bota do ta mbante si njeriun që e ngriti

njerëzimin në një shkallë më të lartë evolucioni.<sup>72</sup>

Sigurisht që ka pasur luftra të panumërta në botë edhe para se Darvini të nxirrte teorinë e tij, por për shkak të ndikimit që pati teoria e tij, për herë të parë, luftës iu dha një miratim i rremë nga shkenca. Maks Nordaw drejtoi vëmendjen nga roli negativ i Darvinit për çështjen e luftrave në një artikull të titulluar "The Philosophy and Morals of War" (Filozofia dhe etika e luftës) që bëri bujë në Amerikë:

**Personaliteti më i madh nga të gjithë përkrahësit e luftës është Darvini.** Meqë teoria e evolucionit është përhapur, ata mund ta mbulojnë barbarizmin e tyre të lindur me emrin e Darvinit dhe t'i shpallin instiktet gjakatare të skutave më të thella të zemrës së tyre, si fjala e fundit e shkencës.<sup>73</sup>

S'ishte rastësi që shekulli XX njohu luftrat më të përgjakshme që ka parë ndonjëherë bota me sy, pasi ai shekull ishte pasardhësi i shekullit XIX, i cili ishte mburjtur me ide të ideologëve të tillë materialistë si Darvini, Marksi dhe Frojdi. Darwinizmi kishte përgatitur terrenin teorik e të ashtuquajtur shkencor që do të përfundonte në luftë dhe tiranët, që e shikonin luftën si të domosdoshme për zhvillimin e njerëzimit, vranë gjithsej 60 milionë njerëz në të dy luftrat botërore.

### **Luftra nga të gjitha anët e botës Neonazistët**

Edhe pse udhëheqësit fashistë si Hitleri, Musolini dhe organizatat naziste të lidhura me ta (SA, SS dhe Gestapoja) apo "këmishëzinjtë" e Musolinit sot duken sikur i përkasin të kaluarës, organizatat neonaziste që ndjekin idetë e tyre e vazhdojnë ende veprimtarinë. Sidomos në vitet e fundit, lëvizjet raciste e fashiste janë rizgjuar në shumë vende evropiane. Në ballë të këtyre lëvizjeve qëndrojnë neonazistët e Gjermanisë.

Neonazistët kanë në rradhët e tyre rrugaçë të papunë, të droguar dhe tipa të etur për gjak. Ata zotërojnë të

gjitha tiparet e mentalitetit fashist. Një artikull gazete për neonazistët tregon se sa i tërheq ata gjaku dhe dhuna:

Gjaku, nderi dhe fanatizmi... Mjaftojnë këto tri fjalë për të përmbledhur vlerat e anëtarëve të Grupit Fashist të Olimbias. Sot organizata ka 35.000 anëtarë dhe në sytë e të tërëve mund të vihet re dëshira e papërmbajtur për t'u ngritur.<sup>74</sup>

Neonazistët janë ndikuar nga i njëjti arsyetim darvinist, si "të parët" e tyre, Hitleri dhe udhëheqësit e tjerë nazistë. Në faqet e internetit që kanë hapur për propagandë naziste dhe raciste ka mundësi të ndeshësh fjalët e Darvinit dhe lëvdata për të, sepse Darvini u siguron mbështetje të gjitha lëvizjeve dhe ideve neonaziste. Prandaj, në faqet e tyre ata e paraqesin Darwinizmin si teori që duhet të pranohet, pa pasur nevojë për prova.

Sulmet dhe vrasjet që kryejnë neonazistët janë krejt të pamëshirshme. Ata ndjejnë kënaqësi kur i djegin njerëzit të gjallë, kur frikësojnë dhe torturojnë fëmijët e vegjël. Turqit janë ndër grupet kryesore që mbahen veçanërisht në shënjestrën e tyre. Neonazistët shfaqin urrejtjen dhe armiqësinë e tyre për turqit në çdo cep të faqeve të tyre të internetit dhe e tregojnë këtë urrejtje me vepra. Kjo deklaratë për turqit është botuar në një faqe interneti të neonazistëve:

Për shembull, po të ishte në dorën time sot, do të më pëlqente të shihja një pjesë të madhe të turqve në dhomat e gazit.<sup>75</sup>

Emri ku neonazistët mbështesin urrejtjen e tyre ndaj turqve është përsëri Çarls Darvini. Neonazistët mendojnë se po japin një shpjegim të ashtuquajtur



**Neonazistët  
ndërmorën një  
sulm kundër  
turqve në  
qytetin e Mëlnit  
në vitin 1992.**

shkencor për urrejtjen e tyre ndaj turqve, duke iu referuar pretendimeve absurde të Darvinit. Në faqen e fundit të këtij kapitulli mund të shihni disa faqe interneti të neonazistëve, të cilat i thurin lavde Darvinit dhe shprehin mendimet e tyre për kombin turk.

Dhuna neonaziste kundër turqve dhe popujve të tjerë është shtuar kohët e fundit. Gazeta e përditshme turke "Sabah", e datës 12 gusht 2000, bëri të njohur një listë të sulmeve neonaziste gjatë verës së vitit 2000:

- Në qershor u thyen dritaret e xhamisë "Rahman" në qytetin e Gerës në krahinën e Tyingenit
- Dy shishe (molotov) u hodhën në një xhami turke në qytetin e vogël të Epingenit në krahinën e Baden-Vyrtembergut.
- Një shishe me lëndë plasëse u hodh në Xhaminë e Gjelhër në lagjen Utersen të Pinebergut.
- Një ndërtesë ku banonin turq iu vu zjarri në Memingen.

**Faqet e internetit të hapura nga neonazistët. Në këto faqe, neonazistët që nderojnë Darvinin, fyejnë e kërcënojnë turqit.**



Revista "Stern"  
 (Nr. 40/1992) shkruan:  
 GJERMANIA NE RENIE  
 Çdo ditë sheh sulme me  
 gurë dhe bomba  
 zjarrhedhëse kundër  
 kampeve të refugjatëve.  
 Urrejtja e përgjithshme  
 kundër të huajve po rritet  
 dhe frika për të ardhmen  
 sundon. Politikanët janë të  
 pafuqishëm. Lëvizja e  
 krahut të djathtë në  
 Gjermani shihet me ankth  
 nga shtetet e huaja. Ku po  
 shkon ky vend kështu?



"Stern" (Nr.40/1992)  
 shkruan: Këngët e së  
 djathtës radikale  
 përbëjnë muzikën e  
 marshimit për aktet e  
 dhunshme drejtuar të  
 huajve. Të rinjtë, numri  
 i të cilëve shtohet nga  
 dita në ditë, sidomos në  
 krahinat e reja  
 gjermane, po nxiten prej  
 këtyre ritmeve agresive.



- Në Bokolt një lokali turk dhe një godine ku banonin libanezë iu vu zjarri. 14 njerëz u plagosën, njëri në gjëndje të rëndë.

- Në qytetin e Kemnicit në Gjermaninë Lindore foshnja 7-muajshe e një familjeje irakene u hodh përdhe. Fytyra e foshnjes u dëmtua kur preku betonin.<sup>76</sup>

Jo shumë kohë më parë kanë ndodhur incidente edhe më të rënda. Duke marrë për bazë urrejtjen e Darvinit ndaj turqve, neonazistët organizuan një sulm kundër turqve në Mëln në nëntor të 1992-shit. Më vonë, në vitin 1993, 5 turq u dogjën të gjallë në Solingen prej neonazistëve.<sup>77</sup>

Shtypi e përshkroi këtë sulm si "sulmin më mizor racist në historinë e Gjermanisë qysh prej epokës naziste". Sulme të këtij lloji filluan të haseshin shpesh në vitet në vijim. Shtëpive të shumë turqve iu vu zjarri, ndërsa të tjerë u rrahën dhe u plagosën. Sulme të ngjashme u zhvilluan edhe në Hollandë. Në një sulm kundër turqve mbetën të vrarë një grua dhe pesë fëmijët e saj. Njerëzit që morën pjesë në kortezhin e përmortshëm që u mbajt, morën letra kërcënuese me kryqin e thyer përsipër.

Këto incidente janë vetëm disa nga sulmet raciste kundër turqve. Sulmet dhe vrasjet e këtyre grupeve fashiste, pasardhës besnikë të Darvinit dhe fashistëve si Hitleri, vazhdojnë ende. Masat ligjore nuk do të mjaftojnë për të ndaluar sulmet çnjerëzore të këtyre grupeve. Mënyra e sigurtë, për t'u dhënë fund atyre, është lufta serioze ideologjike krahas masave ligjore. Veprimet e dhunshme të këtyre njerëzve që e shohin racizmin si ligj të natyrës nuk do të mbarojnë për sa kohë që idetë darviniste nuk do të jenë hedhur poshtë si antishkencore.



## **Darvinizmi: Burimi i Barbarisë Komuniste**

**I**deologjia që i solli dëmin më të madh njerëzimit në shekullin e mbushur me dhunë e barbarizëm dhe njëkohësisht më e përhapura në botë ishte, pa dyshim, Komunizmi. Kjo ideologji, që arriti kulmin e saj historik me dy filozofët gjermanë Karl Marks dhe Frederik Engels në shekullin XIX, derdhi kaq shumë gjak në botë, sa që ua kaloi edhe nazistëve e imperialistëve të dikurshëm. Komunizmi shkaktoi në vdekjen e njerëzve të pafajshëm dhe përhapri e nxiti dhunë, frikë e dëshpërim ndër njerëz. Edhe sot e kësaj dite, kur flitet për vendet e Perdes së Hekurt dhe Rusinë, imazhet që zgjohen na sjellin parasysh vende të pushtuara nga mjegulla, terri e dëshpërimi, nga rrugë pa jetë, nga shqetësimi dhe frika. Sado që njerëzit mendojnë se Komunizmi u shemb në vitin 1991, gërmadhat që la pas ekzistojnë ende. Sado "liberalë" të jenë bërë një pjesë e komunistëve dhe marksistëve "të papenduar", filozofia materialiste, ana e errët e Komunizmit dhe e Marksizmit që i largoi njerëzit nga feja dhe morali i mirë, ende vazhdon të ndikojë te këta njerëz.

Kjo ideologji që përhapri terror në çdo cep të botës, në fakt, përfaqësonte një ide të ardhur që nga kohët e lashta. Dialektika është një bindje se i gjithë zhvillimi, në gjithësi, erdhi si rezultat i konfliktit. Në bazë të këtij besimi, Marks i dhe Engelsi filluan të analizonin historinë e botës. Marks i pretendonte se historia e njeriut ishte histori konflikti, se konflikti aktual ishte ai mes punëtorëve e kapitalistëve dhe se punëtorët së shpejti do të ngriheshin dhe do të organizonin një revolucion komunist.

Tipari më i spikatur i dy themeluesve të Komunizmit

ishte se, si të gjithë materialistët, ata ushqenin një urrejtje të madhe për fenë. Edhe Marksi, edhe Engelsi ishin ateistë të bindur dhe zhdukjen e besimeve fetare e shikonin si thelbësore nga pikëpamja e Komunizmit.

Por Marksit dhe Engelsit u mungonte diçka e rëndësishme: me qëllim që të bënin për vete një publik sa më të gjerë, e panë të nevojshme t'i jepnin ideologjisë së tyre një pamje shkencore. Dhe kështu, u krijua aleanca e rrezikshme që solli dhimbje, kaos, vrasje masive, nxitje të vëllait kundër vëllait gjatë shekullit XX. Darvini bëri të njohur teorinë e evolucionit në librin e tij "Origjina e llojeve". Interesante është që pretendimet bazë që ai paraqiti ishin pikërisht shpjegimet që po kërkonin Marksi dhe Engelsi! Darvini pretendonte se gjallesat u shfaqën si rezultat i "luftës për mbijetesë" apo "konfliktit dialektik". Për më tepër, ai mohoi krijimin dhe hodhi poshtë besimet fetare. Për Marksine dhe Engelsin ky ishte një rast që s'duhej humbur.

### **Admirimi i Marksit dhe Engelsit për Darwinin**

Darvinizmi pati aq shumë rëndësi për Komunizmin, sa vetëm disa muaj pas botimit të librit të Darvinit, Engelsi i shkroi Marksit: "**Darvini, të cilin e kam në dorë duke e lexuar, është i shkëlqyer.**"<sup>78</sup>


E megjithatë, vetë historia ka treguar se periudha evolucionare që propozoi Marksi nuk ishte e vërtetë. Asnjë shoqëri, në asnjë kohë nuk është parë të kalojë nëpër fazat evolucionare të propozuara nga Marksi. Përkundrazi, ekziston mundësia të shihen në të njëjtën shoqëri, në të njëjtën kohë, sisteme që Marksi pretendonte se vijnë para apo pas njëra-tjetrës. Ndërkohë që një pjesë e një vendi përjeton sisteme të ngjashme me sistemin feudal, në një pjesë tjetër mund të zbatohen rregullat kapitaliste. Kjo është arsyeja që nuk ka asnjë provë se kalimi nga një sistem në tjetrin ndjek modelin evolucionar të propozuar nga Marksi dhe teoria e evolucionit.

Nga ana tjetër, asnjë nga parashikimet e Marksit në lidhje me të ardhmen nuk u vërtetua. U kuptua që teoritë e Marksit nuk ishin të zbatueshme brenda 10 vjetëve nga vdekja e tij. Marksi pretendonte se, njëri pas tjetrit, kombet më të zhvilluara kapitaliste do të pësonin revolucione komuniste, por një periudhë e tillë nuk erdhi. Lenini, një nga pasuesit më të mëdhenj të Marksit, u mundua të shpjegonte pse nuk kishin ndodhur këto revolucione e pastaj parashikoi që revolucionet komuniste do të bëheshin në vendet e Botës së Tretë. E megjithatë, të gjitha pretendimet e Leninit i përgënjeshtroi vetë historia. Në kohët e sotme, vendet ku sundon Komunizmi mund të numërohen me gishtat e një dore. Për më tepër, Marksizmi përdori dhunën në rajonet ku erdhi në fuqi dhe ai nuk erdhi në pushtet nga lëvizjet popullore, siç pretendohet, por me dhunë diktatoriale.

Shkurtimisht, historia e kohëve të fundit e ka përgënjeshtruar periudhën e parashikuar nga filozofia marksiste të evolucionit historik. Teori të tilla, si "dialektika e historisë" dhe "evolucionit historik" në



**Themeluesit e komunizmit,  
Karl Marks dhe Frederik Engels.**



## **Shembja e pikëpamjes marksiste për historinë**

**K**arl Marksi, themelues i Komunizmit, i përshtati idetë e Darvinit që patën ndikim të thellë tek ai, me procesin dialektik të historisë. Sipas Marksit, shoqëria ka kaluar në faza të ndryshme, gjatë historisë dhe faktori që i ka përcaktuar këto faza ishte ndryshimi në mjetet dhe marrëdhëniet e prodhimit. Sipas kësaj pikëpamjeje, ekonomia përcaktonte gjithçka. Historia kaloi nëpër faza evolucioni: bashkësi primitive, shoqëri skllavopronare, shoqëri feudale, shoqëri kapitaliste dhe faza e fundit do të ishte shoqëria komuniste.

E megjithatë, vetë historia ka treguar se periudha evolucionare që propozoi Marksi nuk ishte e vërtetë. Asnjë shoqëri, në asnjë kohë nuk është parë të kalojë nëpër fazat evolucionare të propozuara nga Marksi. Përkundrazi, ekziston mundësia të shihen në të njëjtën shoqëri, në të njëjtën kohë, sisteme që Marksi pretendonte se vijnë para apo pas njëra-tjetrës. Ndërkohë që një pjesë e një vendi përjeton sisteme të ngjashme me sistemin feudal, në një pjesë tjetër mund të zbatohen rregullat kapitaliste. Kjo është arsyeja që nuk ka asnjë provë se kalimi nga një sistem në tjetrin ndjek modelin evolucionar të propozuar nga Marksi dhe teoria e evolucionit. Nga ana tjetër, asnjë nga parashikimet e Marksit në lidhje me të ardhmen nuk u vërtetua. U kuptua që teoritë e Marksit nuk ishin të zbatueshme brenda 10 vjetëve nga vdekja e tij. Marksi pretendonte se, njëri pas tjetrit, kombet më të zhvilluara kapitaliste do të pësonin revolucione komuniste, por një periudhë e tillë nuk erdhi.

Lenini, një nga pasuesit më të mëdhenj të Marksit, u mundua të shpjegonte pse nuk kishin ndodhur këto revolucione e pastaj parashikoi që revolucionet komuniste do të bëheshin në vendet e Botës së Tretë. E megjithatë, të gjitha pretendimet e Leninit i përgënjeshtroi vetë historia. Në kohët e sotme, vendet ku sundon Komunizmi mund të numërohen me gishtat e një dore. Për më tepër, Marksizmi përdori dhunën në rajonet ku erdhi në fuqi dhe ai nuk erdhi në pushtet nga lëvizjet popullore, siç pretendohet, por me dhunë diktatoriale. Shkurtimisht, historia e kohëve të fundit e ka përgënjeshtruar periudhën e parashikuar nga filozofia marksiste të evolucionit historik. Teori të tilla, si "dialektika e historisë" dhe "evolucioni historik" në vëllimet e shumta të shkruara nga ideologët materialistë si Marksi dhe Engelsi, janë thjesht fryt i fantazisë.

vëllimet e shumta të shkruara nga ideologët materialistë si Marks i dhe Engelsi, janë thjesht fryt i fantazisë.

Marks i ktheu përgjigje letrës së Engelsit më 19 dhjetor 1860, duke i shkruar: **"Ky është libri që përmban parimet bazë të historisë së natyrës sipas pikëpamjes sonë."**<sup>79</sup>

Në një letër që Marks i shkroi Lasalit, një tjetër mik i tij socialist, më 16 janar 1861, shkruan: **"Libri i Darvinit është shumë i rëndësishëm e më shërben si bazë në shkencën natyrore për luftën e klasave në histori."**<sup>80</sup> Në këtë mënyrë ai zbulon rëndësinë e teorisë së evolucionit për Komunizmin.

Marks i shfaqti simpatinë e tij për Darwinin, duke ia kushtuar atij veprën e tij më të rëndësishme, "Das Kapital" (Kapitali). Kopja e këtij libri që iu dërgua Darvinit përmbante një dedikim nga ana e vetë Marksit, i cili e përshkruante veten si një "admirues i sinqertë" i natyralistit anglez.<sup>81</sup>

Edhe Engelsi e pranon admirimin e tij për Darwinin:

Natyra është prova e dialektikës dhe nuk duhet lënë pa thënë se, fundja, natyra vepron në mënyrë dialektike e jo metafizike... Lidhur me këtë, **Darvinit duhet t'i përmendet emri para të tjerëve.**<sup>82</sup>

Engelsi lavdëronte Darwinin njëjloj si Marks. Ai shkruan:

"Ashtu sikurse Darvini zbuloi ligjin e evolucionit në natyrën organike, po ashtu edhe Marks i zbuloi ligjin e evolucionit në historinë njerëzore."<sup>83</sup>

Në një vepër tjetër të tij, Engelsi theksoi rëndësinë e nxjerrjes nga Darvini të një teorie që i kundërvihet fesë:

Ai (Darvini) i dha konceptit metafizik të natyrës goditjen më të rëndë, duke provuar se bota e sotme organike – bimët, kafshët, e si rrjedhim edhe njeriu – është produkt i një procesi evolucionar që vazhdon prej miliona vjetësh.<sup>84</sup>

Përveç kësaj, Engelsi tregoi se si e kishte pranuar ai teorinë e Darvinit, duke shkruar një artikull të titulluar

"Roli që ka luajtur puna, në kalimin nga majmuni te njeriu".

Shkencëtari amerikan Conway Zirkle shpjegon se përse themeluesit e Komunizmit e pranuan menjëherë teorinë e Darvinit:

**Marksit dhe Engelsi e pranuan evolucionin thujse menjëherë pasi Darvini botoi librin "*Origjina e llojeve*". Evolucioni, natyrisht, ishte pikërisht ajo që themeluesve të Komunizmit u duhej për të shpjeguar se si njerëzimi mund të kishte ardhur në ekzistencë pa ndërhyrjen e ndonjë force të mbinatyrshe dhe, për pasojë, ai mund të përdorej për të mbështetur bazat e filozofisë së tyre materialiste. Përveç kësaj, interpretimi i evolucionit nga Darvini, sipas të cilit, evolucioni kishte ndodhur nëpërmjet përzgjedhjes natyrore, u dha atyre një hipotezë të ndryshme nga ajo e shpjegimit teologjik mbizotërues të faktit të vërejtur se të gjitha format e jetës u janë përshtatur kushteve të tyre.<sup>85</sup>**

Tom Bethel, gazetar i revistës "Harper Magazine", shpjegon lidhjen midis Marksit dhe Darvinit, si më poshtë:

**Marksit nuk e admironte librin e Darvinit për arsye ekonomike, por për arsyen më thelbësore se universi i Darvinit ishte thjesht materialist dhe se shpjegimi i tij nuk përfshinte më ndonjë lidhje me shkaqe të pavëzhgueshme jomateriale jashtë apo "përtej" tij. Në këtë aspekt të rëndësishëm, Darvini dhe Marksit ishin shokë për kokë.<sup>86</sup>**

Sot, lidhja midis Darwinizmit dhe Marksizmit është një e vërtetë e pranuar nga të gjithë. Biografite e Marksit gjithmonë e bëjnë të qartë një gjë të tillë. Për shembull, një biografi e Karl Marksit e përshkruan këtë lidhje në këtë mënyrë:

"Darvinizmi paraqiti një sërë faktesh që mbështesin Marksizmin dhe shtjellojnë të vërtetën e tij. Përhapja e

ideve darviniste evolucionare krijoi një terren pjellor të përshtatshëm për idetë marksiste dhe i hapi rrugën përvetësimit të tyre nga klasa punëtore... Marksi, Engelsi dhe Lenini u dhanë vlerë të madhe ideve të Darwinit. Ata nxorën në pah rëndësinë e tyre shkencore dhe, në këtë mënyrë, u përshpejtua përhapja e këtyre ideve."<sup>87</sup>

Siç e kemi parë, Marksi dhe Engelsi besonin me gëzim se koncepti i evolucionit përbënte një përkrahje shkencore për botëkuptimin e tyre ateist, por ky gëzim doli i parakohshëm. Teoria e evolucionit u pranua gjerësisht, sepse ishte propozuar në një ambjent shkencor primitiv, si ai i shekullit XIX. Ajo ishte e mbushur me pasaktësi dhe nuk mbështetej në asnjë lloj prove shkencore. Shkenca që njohu zhvillim të madh në gjysmën e dytë të shekullit XX, e nxori të pavlefshme teorinë e evolucionit. (Për hollësi të mëtejshme, shih librin e shkruar nga Harun Jahja: "Gjunjzimi i Evolucionit", i përkthyer dhe në shqip) Kjo, në të njëjtën kohë, nënkuptonte shembjen e mendimit komunist dhe materialist, por ngaqë shkencëtarët me pikëpamje materialiste e dinin se shembja e Darwinizmit nënkuptonte, gjithashtu, edhe rrënimin e ideologjive të tyre, ata provuan të gjitha metodat e mundshme për t'ua mbajtur të fshehtë njerëzve rënien e Darwinizmit.

### **Admirimi i pasuesve të Marksit dhe Engelsit për Darwinin**

Pasuesit e Marksit dhe Engelsit, që shkaktuan vdekjen e miliona njerëzve dhe u bënë shkak që qindra miliona të tjerë të jetonin në vuajtje, dhunë e terror, e pranuan teorinë e evolucionit, duke shprehur gëzim e interes të madh.

John N. Moore flet për lidhjet mes evolucionit dhe udhëheqësve sovjetikë, të cilët vunë në jetë idetë e Marksit dhe Engelsit në Rusi:

Mënyra e të menduarit të udhëheqësve të BRSS-së është rrënjësor thellë në këndvështrimin evolucionist.<sup>88</sup>

Ishte Lenini ai që bëri të mundur që projekti i Marksit për revolucionin komunist të realizohet. Lenini, udhëheqësi i lëvizjes bolshevike komuniste në Rusi, synonte të rrëzonte me forcën e armëve regjimin e carit. Kaosi pas Luftës së Parë Botërore u krijoi bolshevikëve mundësinë që po kërkonin. Në tetor 1917, me Leninin në krye, komunistët morën pushtetin me forcën e armëve. Pas revolucionit, Rusia u shndërrua në arenë lufte civile të përgjakshme 3 vjeçare, mes komunistëve dhe përkrahësve të carit.

Ashtu si udhëheqësit e tjerë komunistë, Lenini shpesh theksonte se teoria e Darvinit ishte baza themelore e filozofisë materialiste dialektike. Një prej thënieve të tij zbulon mendimin e tij për Darwinizmin:

Darvini i dha fund besimit se llojet e botës bimore e shtazore nuk kanë asnjë lidhje me njëra-tjetrën dhe se ato janë krijuar prej Zotit e, si rrjedhim, janë të pandryshueshme.<sup>89</sup>

Edhe Trocki, që pranohej si arkitekti më i rëndësishëm i Revolucionit Bolshevik pas Leninit, i dha rëndësi të madhe Darwinizmit. Ai e pohoi admirimin e tij për Darwinin kështu:

Zbulimi i Darvinit është triumfi më i madh i dialektikës në gjithë fushën e materies organike.<sup>90</sup>

Pas vdekjes së Leninit në vitin 1924, Stalini, që njihet si diktatori më gjakatar në historinë e njerëzimit, u vu në krye të Partisë Komuniste. Gjatë 30 viteve të tij në pushtet, Stalini do të vërtetonte se sa sistem i pamëshirshëm ishte komunizmi. Lëvizja e parë e rëndësishme e Stalinit ishte marrja, në emër të shtetit, e tokave të fshatarëve që përbënin 80% të popullsisë së Rusisë. Në emër të kësaj politike kolektivizimi, që kishte për qëllim zhdukjen e pronës private, të gjitha prodhimet e fshatarëve rusë u mblodhën me dhunë nga zyrtarë të armatosur. Për pasojë, plasi një zi buke e tmerrshme. Miliona gra, fëmijë dhe pleq që nuk gjenin asgjë për të ngrënë vdisnin, duke u përpëlitur nga uria.

Numri i të vdekurve vetëm në Kaukaz arriti 1 milion.

Stalini dërgoi qindra mijëra njerëz që tentuan të mos i bindeshin kësaj politike në kampet e tmerrshme të punës në Siberi. Këto kampe, ku të burgosurve u dilte shpirti në punë, u kthyen në varr për pjesën më të madhe të këtyre njerëzve. Nga ana tjetër, dhjetra mijëra njerëz u ekzekutuan nga policia sekrete e Stalinit. Miliona të tjerë u detyruan të shpërnguleshin në viset më të largta të Rusisë, përfshirë turqit e Krimesë dhe Turkmenistanit.

Me këto politika gjakatare e mizore, Stalini vrau 20 milionë njerëz. Historianët kanë zbuluar se ky barbarizëm i jepte atij kënaqësi të madhe. Ai ndjente kënaqësi kur ulej në tryezën e tij në Kremlin dhe shqyrtonte listën e atyre që kishin vdekur në kampet e përqendrimit ose që ishin ekzekutuar.

Përveç gjendjes psikologjike, në të cilën ndodhej, ndikimi kryesor që e nxiti të bëhej një vrasës i tillë i pamëshirshëm ishte filozofia materialiste që ai besonte. Nga vetë fjalët e Stalinit, baza themelore e kësaj filozofie ishte teoria e evolucionit. Ai shpjegonte rëndësinë që u jepte ideve të Darvinit:

Janë tri gjëra që ne bëjmë për të çliruar mendjet e studentëve tanë. E kishim për detyrë t'u mësonim atyre moshën e tokës, prejardhjen gjeologjike dhe **parimet e Darvinit**.<sup>91</sup>

Kur Stalini ishte ende gjallë, një shok i ngushtë fëmijërie, në librin "Ngjarje të rëndësishme në jetën e Stalinit", tregon si ishte bërë ateist Stalini:

Që në moshë shumë të re, kur ishte ende nxënës në shkollën klerike, shoku Stalin ka treguar se ka pasur një mendje kritike dhe ka shfaqur ndjenja revolucionare. Ai filloi të lexojë Darwinin dhe u bë ateist.<sup>92</sup>

Në të njëjtin libër, G. Glurxhidze, një shok fëmijërie i Stalinit tregon se si Stalini kishte nisur të mos besonte më në Zot dhe i kishte thënë se arsyeja ishte **libri i Darvinit**, duke e nxitur që ta lexonte edhe ai.<sup>93</sup>

Një tregues i rëndësishëm i besimit të verbër të

Stalinit në teorinë e evolucionit ishte mospranimi në sistemin shkollor sovjetik i ligjeve gjenetike të Mendelit në kohën kur erdhi në pushtet. Këto ligje, që ishin pranuar nga e gjithë bota e shkencës që nga fillimi i shekullit XX, mohonin pretendimin e Lamarkut se "tiparet e fituara mund të përcillen te brezat pasardhës". Shkencëtari rus Lisenko e shihte këtë si një goditje të fuqishme kundër teorisë së evolucionit dhe, në të njëjtën kohë, si një rrezik të madh, ndaj dhe ia tregoi Stalinit mendimet e tij. Stalinit i bënë përshtypje mendimet e Lisenkos dhe e emëroi kryetar të shoqatave shkencore zyrtare. Kështu, shkenca gjenetike, e cila i kishte dhënë një goditje të rëndë evolucionit, nuk u pranua nga asnjë shoqatë apo shkollë shkencore në Bashkimin Sovjetik, derisa vdiq Stalini.

Gjatë sundimit të Stalinit, Bashkimi Sovjetik ishte kthyer në një mjedis ku mbretëronte kaosi, ku për miliona njerëz jeta ishte përherë në rrezik dhe ku mund të arrestoheshin nga çasti në çast, paçka se s'kishin bërë asnjë krim për të vuajtur tortura të paimagjinueshme.

Kur analizojnë këto ngjarje, disa komentues të historisë bëjnë gabim kur mundohen të provojnë se shkaku kryesor i gjithë kësaj barbarie e mizorie të pashpirt ishte se njerëz si Lenini, Stalini, Mao, Hitleri dhe Musolini karakterizoheshin nga psikopatia dhe çekuilibri mendor. Çfarë rastësie është kjo që e gjithë bota ra në duart e njerëzve të çekuilibruar psikologjikisht në të njëjtën kohë? Është e qartë se të gjithë këta njerëz dhe ideologji kanë pirë nga i njëjti burim. Me pak fjalë, një palë tjetër ishte fajtorë bashkë me ta. Shkaku që këta udhëheqës të pashpirt tërhiqnin pas vetes miliona njerëz dhe që u lejoi atyre të bënin krime, ishte përkrahja "shkencore" që u dha filozofia materialiste dhe Darwinizmi.

## **Mao Ce Duni: ambasadori i Darunit dhe i Marksit në Kinë**

Ndërkohë që Stalini zbatonte regjimin e tij totalitar, një tjetër regjim komunist, i cili e shihte Darwinin si

mbështetjen e tij shkencore, u vendos në Kinë. Komunistët, nën udhëheqjen e Mao Ce Dunit, erdhën në pushtet në vitin 1949 pas një lufte të gjatë civile. Maoja krijoi një regjim shtypës dhe gjakatar, njëloj si aleati i tij, Stalini, i cili e përkahu mjaft. Kina u bë skena e ekzekutimeve të panumërta politike. Në vitet që do të vinin, militantët e rinj të Maos, të njohur si "Rojet e Kuqe", do ta fusnin vendin në një atmosferë tmerri të vërtetë.

Maoja shpalli hapur bazën filozofike të sistemit që krijoi, duke thënë: **"Socializmi kinez mbështetet te Darvini dhe teoria e evolucionit."**<sup>94</sup>

Duke qenë marksist, ateist dhe ndjekës besnik i evolucionit, Maoja dha urdhër që materialet e leximit që do të përdroreshin në institucionet arsimore gjatë kësaj periudhë fillestare, të pagëzuar me emrin "Hapi i madh përpara", të ishin shkrimet e Çarls Darvinit, si dhe materiale të tjera që përkrahnin paradigmen e evolucionit.<sup>95</sup>

Kur komunistët kinezë erdhën në pushtet, ata përdorën teorinë e evolucionit si bazë për ideologjinë e tyre. Në fakt, intelektualët kinezë e kishin pranuar teorinë e evolucionit kohë më parë.

Gjatë shekullit XIX, Perëndimi e konsideronte Kinën si një gjigand të fjetur, të izoluar dhe të zhytur në traditat e lashta.

Pak evropianë e kuptuan se me sa etje i thithën intelektualët kinezë idetë darviniste evolucioniste dhe panë tek ato ide një nxitës shpresëdhënës për përparim dhe ndryshim. Sipas shkrimtarit kinez Hu Shin ("Living Philosophies:", 1931), kur në vitin 1898 u botua libri i Thomas Huxley, "Evolucioni dhe Etika", ai u brohorit dhe u pranua menjëherë nga intelektualët kinezë. Të pasurit sponsorizuan botime të lira në gjuhën kineze, në mënyrë që ato të përhapeshin në masat e gjera të popullit.<sup>96</sup>

Kështu, njerëzit që u kthyen kah Komunizmit dhe udhëhoqën revolucionin komunist ishin ata intelektualë

që ishin "ndikuar thellë" prej ideve darviniste.

Nuk ishte e vështirë për Kinën, pavarësisht nga historia dhe besimet e saj të forta panteiste, të hynte në darën e Darwinizmit dhe Komunizmit. Në një artikull në revistën "*New Scientist*", filozofi darvinist kanadez Michael Ruse thotë në lidhje me Kinën e fillimit të shekullit të njëzetë:

**Këto ide zunë rrënjë menjëherë, sepse Kina nuk i kishte pengesat e natyrshme intelektuale e fetare për evolucionin që shpesh ekzistonin në Perëndim. Dhe me të vërtetë, nga disa anë, Darvini ngjante pothuajse si kinez!** Mendimi taoist dhe neokonfucian gjithmonë kishte theksuar "sendësinë" te qeniet njerëzore. Fakti që ne kemi gjëra të përbashkëta me kafshët nuk përbënte ndonjë tronditje të madhe... Në kohën e sotme, filozofia zyrtare është Marksizëm-Leninizmi, por **pa mënyrën materialiste laike të Darwinizmit (që tani përbën filozofinë e gjerë sociale), nuk do të ishte përgatitur terreni për Maon dhe revolucionarët e tij që të mbillnin farën e të vilnin të korrat e tyre.**<sup>97</sup>

Siç thotë më lart Michael Ruse, me ngulitjen e ideve darviniste, Kina e përqafoi pa probleme Komunizmin. Populli kinez, i mashtruar nga idetë darviniste, rrinte e bënte sehir kur kryheshin të gjitha masakrat e Mao Ce Dunit, një prej vrasësve më të papërmbajtur të historisë. Jo vetëm në Kinë, por edhe në shumë vende të tjera, Komunizmi ishte shkaku i përleshjeve, akteve të përgjakshme, terrorizmit dhe luftës civile. Turqia ishte një prej tyre. Në vitet '60 dhe '70, grupet që rrëmbyen armët kundër shtetit, me ëndrrën që të zhvillonin një revolucion komunist në vend, e futën Turqinë në një atmosferë të errët terrorizmi. Pas 1980-ës terrorizmi komunist u bashkua me rrymën e separatizmit, duke u bërë shkaku i vdekjes së dhjetëra mijëra turqve, policëve e ushtarëve në krye të detyrës.

Ideologjia komuniste, që solli gjakderdhje në botë në këtë mënyrë për 150 vjet rresht, u gjend gjithmonë krah

për krah me Darwinizmin. Edhe sot e kësaj dite, komunistët janë përkrahësit më të flaktë të Darwinizmit. Sa herë që njeriu hedh sytë nga qarqet që e mbrojnë me kokëfortësi teorinë e evolucionit, gati në çdo vend të botës, shikon marksistët në rreshtin e parë, sepse siç ka thënë Karl Marksi, teoria e evolucionit përbën bazën e ideologjisë komuniste nga aspekti i shkencës natyrore dhe i siguron përkrahjen më të rëndësishme shkencore mungesës së besimit fetar të komunistëve.

### **Baza e aleancës midis Darwinizmit dhe Komunizmit: Urrejtja për fenë**

Siç e shpjeguem më sipër, arsyeja kryesore që materialistët dhe komunistët u kapën fort pas Darwinizmit është përkrahja që siguron Darwinizmi për ateizmin. Filozofia materialiste ka ekzistuar gjatë gjithë historisë, por, deri në shekullin XIX, shumica e filozofëve nuk kishin shkuar më tej se librat e teorisë. Shkaku kryesor për këtë ishte se deri në atë kohë shumica e njerëzve të shkencës besonin në Zot dhe në realitetin e krijimit, por në shekullin XIX, filozofia materialiste dhe teoria e Darvinit filluan të zbatoheshin në shkencat natyrore. Darwinizmi ishte baza më e rëndësishme për kulturën materialiste jofetare, e cila vuri vulën e saj në shekullin XIX, por e tregoi fytyrën e vërtetë kryesisht në shekullin XIX. Ideologjitë që lindën nga kjo kulturë materialiste, siç e kemi shqyrtuar, u bënë shkaku i dy luftrave botërore, i luftrave civile të panumërta, i akteve terroriste, i genocidit, i shfarosjeve dhe barbarizmit. Për shkak të këtyre katastrofave, dhjetëra milliona njerëz humbën jetën, ndërsa qindra miliona u shtypën paturpësisht dhe provuan mbi kurriz keqtrajtimet më barbare. Shembja e qindra kishave dhe xhamive nga Stalini është thjesht një tregues i urrejtjes së Komunizmit ndaj fesë. Në librin e tij "Lufta e gjatë kundër Zotit", Henry Morris përshkruan lidhjen në këtë mënyrë:

Pavarësisht nga mangësitë shkencore, karakteri, gjoja shkencor i evolucionit është përdorur për të justifikuar

## POL POTI DHE "FUSHAT E VDEKJES" TE KMEREVE TE KUQ

**N**ë vitet 1975-1979, gjatë sundimit të Pol Potit, u vranë 2 milionë njerëz nga popullsia 7 milionëshe e Kamboxhias. Duke i llogaritur në përqindje popullsie, vrasjet e Pol Potit, i cili ëndërronte të krijonte një shtet komunist të përsosur, ishin më të mëdha se ato të Hitlerit e Stalinit. Objektivi kryesor i Pol Potit ishin doktorët, inxhinierët e shkencëtarët, me pak fjalë, intelektualët e vendit. Ai i vriste ata pa mëshirë. Madje ishte dhënë edhe urdhër që të vritej "kushdo që mbante syze". Si pasojë e këtyre vrasjeve çnjerëzore, u shfaqën "fushat e vdekjes" që zgjatën me vite.

Logjika që përdornin oficerët e Kmerit të Kuq për të justifikuar masakrat e tyre përmbledhej me këto fjalë: "Po të të mbajmë, nuk fitojmë gjë. Po të të humbasim, nuk humbasim gjë." Ata vranë këdo që e konsideronin apo edhe dyshonin se ishte i padobishëm dhe i dëmshëm. Të paktën një pjesëtar nga çdo familje ka humbur jetën në këto masakra.

Pol Poti, për të cilin jeta e njeriut s'vlente asgjë, besonte se familja i zinte rrugën vizionit të tij radikal për Socializmin. Ai u përpoq ta hiqte qafe idenë e familjes, duke i përçarë familjet e duke i detyruar njerëzit të jetonin në vende të përbashkëta. E njëjta politikë ishte zbatuar nga Stalini në Rusi. Në fillim u morën tokat fshatarëve, pastaj u dhanë parcela të vogla toke në zona të shpërndara qëllimisht dhe shumë larg njëra-tjetrës. Si rezultat, me qëllim që një familje të punonte arat e saj, të ndara në parcela të vogla toke, pjesëtarët e familjes detyroheshin të jetonin të ndarë nga njëri-tjetri.

Robert Templer, "Pol Pot's Legacy of Horror", The Age, 18 prill 1998, <http://dithpran.org/PolPotegacy.htm>.

të gjitha llojet e sistemeve dhe praktikave jofetare. Më i suksesshmi prej tyre, deri tani, duket se është Komunizmi. Ithtarët e tij kudo në botë janë mashtruar të besojnë se Komunizmi duhet të jetë i vërtetë, pasi bazohet në shkencën e evolucionit.<sup>98</sup>

Armiqësia që ushqente komunizmi dhe materializmi

për fenë e tregoi veten gjatë kryengritjes bolshevike. Kishat dhe xhamitë u shembën dhe ndër kategoritë e atyre që u përjashtuan nga "shoqëria e re socialiste", besimtarët zinin një vend të rëndësishëm. Pavarësisht nga fakti se pjesa më e madhe e shoqërisë ishte fetare, ata u penguan të kryenin detyrat fetare. Me qëllim që të evitohej e djela, kur të krishterët shkonin në kishë, u hoq koncepti i një dite pushimi për të gjithë. Çdo njeri do punonte 5 ditë, por dita e pushimit mund të ishte një ditë çfarëdo. Kjo masë u mor nga komunistët "për të lehtësuar luftën për eliminimin e fesë".<sup>99</sup> Pas kësaj, në vitin 1928 dhe 1930, taksat që paguanin besimtarët u rritën 10 herë, u hoqën triskat e tallonat e ushqimit dhe ata nuk mund të përdornin më shërbimet shëndetësore, që do të thotë se *ata nuk gëzonin më të drejta qytetare*. Ata shpesh arrestoheshin, shkarkoheshin nga postet që kishin dhe internoheshin. Në vitin 1936 rreth 65% e xhamiave dhe 70% e kishave ishin shkatërruar.

Masa të dhunshme kundër fesë u morën edhe në Shqipëri. Udhëheqësi komunist i Shqipërisë, Enver Hoxha, në vitin 1967 e shpalli Shqipërinë si vendin e parë "të pafe". Besimtarët u arrestuan pa asnjë arsye e disa prej tyre u vranë kur ishin në arrest. Në vitin 1948 dy peshkopë dhe 5.000 besimtarë u qëlluan. Edhe muslimanët u trajtuan në të njëjtën mënyrë. Revista letrare mujore "Nëntori" njoftoi se 2169 xhami dhe kisha ishin mbyllur, nga të cilat 327 ishin vende adhurimi katolike.

Shkaku i këtyre veprimeve ishte, pa dyshim, qëllimi i Komunizmit për të formuar shoqëri që do të mohonin ekzistencën e Zotit dhe do të besonin e vlerësonin vetëm materien. Në fakt, ky ishte një prej objektivave kryesore të Komunizmit, sepse udhëheqësit komunistë e dinin që ata do të mund të sundonin si të donin vetëm mbi njerëz të pandjeshëm të shndërruar në makina, që nuk e njihnin frikën ndaj Zotit dhe që kishin prirjen të kryenin vrasje e shtypje sa herë të urdhëroheshin.

Pretendimet e Darwinizmit, të cilat i siguruan mbështetje ateizmit dhe justifikuan të gjitha llojet e

shtypjes dhe barbarisë, inkurajuan në këtë mënyrë të gjitha ideologjitë që sollën gjakderdhje dhe e cilësuan jetën njerëzore si diçka të pavlerë. Kjo është arsyeja pse shekulli i fundit kaloi i mbushur me luftra të tejzgjatura, masakra, akte dhune e armiqësi.

### **Shtypja dhe dhuna që i sollën botës komunistët darvinistë**

Anarkia dhe terrori janë dy prej veglave të domosdoshme të Marksizmit dhe Komunizmit. Prirja e Marksizmit për terrorizëm e dhunë u shfaq në eksperimentin e Komunës së Parisit, kur Marks i ishte ende gjallë. Terrorizmi u bë një pjesë e domosdoshme e ideologjisë komuniste për Leninin, sidomos në kohën kur ai po e kthente në praktikë teorinë e Marksit. Siç do të shihet në faqet në vijim, në kohën tonë, udhëheqësit komunistë mbahen mend për shtypjen dhe vrasjet që kanë kryer. Megjithatë, pavarësisht nga kjo, disa qarqe ende mbulojnë muret me fotografitë e këtyre vrasësve të pamëshirshëm, që i kanë duart të lyera me gjak, dhe ende i pranojnë këta sadistë si mësuesit e tyre.

Sado që disa komunistë pretendojnë se dhuna dhe terrorizmi nuk janë praktika komuniste dhe se ato janë shfaqur vetëm në disa mënyra të zbatimit të Komunizmit tek individë të caktuar, e sado që të përpiqen për ta shfajësuar Komunizmin, ka një të vërtetë të pamohueshme: **Themeluesit e Komunizmit personalisht e mbronin dhunën dhe terrorizmin dhe i shihnin si thelbësorë për ideologjinë e tyre.** Analisti politik amerikan Samuel Francis ka thënë kështu lidhur me këtë çështje:

**Marks i Engelsi ishin, në përgjithësi, specifike kur këmbëngulnin se revolucioni gjithmonë do të ishte i dhunshëm dhe se revolucionarët duhet të përdorin dhunën kundër sunduesve e, madje në disa raste, ata e shprehën vërtetë përkrahjen e tyre ndaj terrorizmit.**<sup>100</sup>

Karl Marks i ka thënë: "Kryengritja është një art, po aq sa edhe lufta." Ai pranoi si parim të vetin këto fjalë të

Dantonit, një prej emrave më të shquar në "politikën revolucionare": "De l'audace, de l'audace, ençore de l'audace" (Guxim, guxim, gjithmonë guxim!)<sup>101</sup>

Ka deklarata të qarta nga Lenini në lidhje me domosdoshmërinë e ushtrimit të terrorit në mënyrë sistematike. Ja disa prej tyre:

Në të vërtetë, shteti s'është gjë tjetër, veçse një makinë për shtypjen e një klase nga një tjetër. Diktatura është rregull që mbështetet drejtpërdrejt te forca dhe që nuk kufizohet nga ligjet... Diktatura revolucionare e proletariatit është rregull i fituar dhe i mbajtur nëpërmjet ushtrimit të dhunës nga proletariati kundër borgjezisë, rregull që nuk kufizohet nga ndonjë ligj.<sup>102</sup>

**Ne nuk jemi aspak kundër vrasjeve politike...** Vetëm në lidhje të drejtpërdrejtë e të menjëhershme me lëvizjen e masës, mund dhe duhet të jenë të vlefshme aktet terroriste individuale.<sup>103</sup>

Për t'u shndërruar në forcë, punëtorët me ndërgjegje klasore duhet të fitojnë shumicën në anën e vet. Për sa kohë që nuk përdoret dhunë kundër njerëzve, nuk mbetet rrugë për të ardhur në pushtet.<sup>104</sup>

Duke folur në një mbledhje të punëtorëve, Lenini lëshoi një deklaratë të tmerrshme për të treguar se sa i domosdoshëm ishte për ta terrorizmi:

Në qoftë se masat e popullit nuk ngrihen spontanisht, kjo s'të çon asgjëkund... Sepse për sa kohë që ne nuk arrijmë t'i trajtojmë spekullatorët ashtu siç e meritojnë - me një plumb kokës - nuk do të arrijmë asgjëkund.<sup>105</sup>

Një prej udhëheqësve më të rëndësishëm të Revolucionit të Tetorit në Rusi, Trocki, thotë këtë për të konfirmuar fjalët e Leninit:

Por revolucioni i kërkon klasës revolucionare që të arrijë qëllimin e saj me të gjitha mënyrat e disponueshme, **po të jetë nevoja, me kryengritje të armatosur; po të kërkohet, edhe me terrorizëm.**<sup>106</sup>

Trocki, në një tjetër fjalim, shkon edhe më tej:

"Rrugëzgjdhja jonë e vetme tani është lufta civile. Lufta civile është lufta për bukë... Rroftë lufta civile!"<sup>107</sup>

Këto parime të teoricienëve komunistë si Lenini dhe Trocki u vunë në zbatim në revolucionin bolshevik në Rusi. Gjatë periudhës revolucionare të vjeshtës së 1917-ës filluan masakra në shkallë të gjerë, plaçkitje dhe dhunë e pabesueshme. Ata njerëz që ishin kundër revolucionit, apo që dyshoheshin se ishin kundër revolucionit, i grumbullonin pa asnjë arsye, i arrestonin dhe i pushkatonin, ndërsa shtëpitë ua plaçkitnin dhe ua rrënonin. Terrorizmi, që filloi me Leninin dhe Trockin, vazhdoi dhe u keqësua edhe më shumë gjatë viteve të sundimit të Stalinit. Harrison E. Salisbury, i gazetës "The New York Times", i përshkroi kampet e burgjeve të sistemit sovjetik si:

... një kontinent i tërë terrori... Në krahasim me ata që u bënë shkak për qindra mijëra ekzekutime dhe miliona vdekje në sistemin sovjetik të terrorit, carët duken pothuaj zemërmirë... Na tmerron mendimi i një ligësie sistematike, të shndërruar në rutinë, për shkak të së cilës 3-4, a më shumë, milionë burra e gra u dënuan çdo vit me punë të detyruar dhe internim të përjetshëm. Gjykimet ishin aq arbitrare, saqë të burgosurve shpesh nuk u thuhej se cili ishte dënimi i tyre...<sup>108</sup>

Popujt jorusë dhe sidomos turqit e Krimesë, turqit e Azisë Qendrore dhe kazakët ishin të pambrojtur nga terrorizmi i ushtruar nga sistemi sovjetik. Gjyqe të veçanta, të quajtur "*troiki*", u ngritën për spastrimin e shoqërisë ruse nga kazakët. Vetëm në tetor të vitit 1920, këto "*troiki*" dënuan me vdekje më shumë se 6000 njerëz. Familjet, e nganjëherë edhe fqinjët e atyre që ishin kundërshtarë të regjimit dhe nuk ishin kapur, merreshin rregullisht peng dhe dërgoheshin në kampet e përqendrimit. Martin Latsisi, drejtori i një prej këtyre kampeve në Ukrainë, pohoi në një nga raportet e tij se ato ishin kampe të vdekjes:

Të mbledhur tok në një kamp pranë Maikopit, pengjet, gratë, fëmijët e pleqtë mbijetojnë në kushtet më të tmerrrshme, në të ftohtin e baltën e tetorit... Ata po vdesin si miza. Gratë janë gati të bëjnë gjithçka për t'i shpëtuar vdekjes. Ushtarët që ruajnë kampin përfitojnë nga kjo gjë dhe i trajtojnë si prostituta.<sup>109</sup>

Nën ndikimin e Darvinit, revolucionarët komunistë vrisnin njerëz me mënyra të çmendurish. Nga dokumentet e kohës del se qëllimi i tyre i vetëm ishte shfarosja e plotë. Dukej sikur ata besonin se sa më shumë njerëz të vrisnin, aq më shumë sukses do të korrnin. Që ata kishin në plan të zhduknin cilindo nga ata që dyshohej se ishte kundër revolucionit, del në një prej vendimeve të tyre:

*Pjätigorsk Çeka* (Komiteti i Jashtëzakonshëm për Luftën ndaj Kundërrevolucionit) **vendosi pa hezitar të ekzekutoheshin 300 njerëz në ditë.** Ata e ndanë qytetin në lagje të ndryshme, morën një numër të caktuar njerëzish nga secila dhe urdhëruan partinë të përpilonte lista ekzekutimi... Në Kislovodsk, për shkak se askujt nuk i erdhi ndër mend një ide më e mirë, u vendos të vriteshin njerëz që ishin shtruar në spital.<sup>110</sup>

Siç u njoftua në kryeartikullin e gazetës "*Krasnji Mjeç*" (Shpata e Kuqe), përkrahëse e komunistëve, për ta nuk

kishte gjë të ndaluar dhe besonin se duhej të derdhej gjak që të përftohej ngjyra e flamurit të kuq.

Për ne gjithçka është e lejueshme, sepse ne jemi të parët që ngremë shpatën jo për të shtypur racat dhe për t'i mbajtur në skllavëri, por për të çliruar njerëzimin nga prangat... Gjaku? Le të derdhet gjaku



**lumë! Le ta njollosë gjaku përgjithmonë flamurin e zi të piratëve që valëvit borgjezia dhe le të jetë përgjithmonë i kuq si gjaku flamuri ynë! Sepse vetëm nëpërmjet vdekjes së botës së vjetër mund ta çlirojmë veten përgjithmonë nga kthimi i atyre çakejve!**<sup>111</sup>

Përveç gjithë kësaj torture, Stalini krijoi "njësitë e rekuizimit" për t'ua marrë me dhunë prodhimin fshatarëve. Këto njësi ishin përgjegjëse për të gjitha llojet e shtypjeve. Më 14 shkurt 1922 një inspektor shkruan:

Abuzimet me postin nga njësitë e rekuizimit, të flasim hapur, tani kanë arritur nivele të pabesueshme. Rregullisht, fshatarët që arrestohen mbahen mbyllur në plevica të mëdha pa ngrohje, pastaj qëllohen me kamzhik dhe kërcënohen me ekzekutim.

Ata që nuk e kanë plotësuar të gjithë kuotën e tyre, janë detyruar që të vrapojnë lakuriq përgjatë rrugës kryesore të fshatit dhe pastaj të mbyllen në një hangar tjetër pa ngrohje. Një numër i madh grash janë rrahur derisa kanë humbur ndjenjat dhe pastaj janë flakur lakuriq në gropa të hapura në borë...<sup>112</sup>

Stalini besonte se Spanja paraqiste mundësi të mira për BRSS-në dhe se ndërhyrjet në atë vend do të jepnin frytet e tyre. Për këtë arsye, ai u mbajti anën dhe përkrahu komunistët në Luftën Civile të Spanjës, por bashkë me ta, në Spanjë vërshoi terrorizmi i BRSS. Një shembull i shtypjes dhe torturës në atë vend ishte kampi i përqendrimit ku u mbajtën 200 antistalinistë në fillim të 1938-ës. "Kur stalinistët vendosën të hapnin një *çeka* (komitet i jashtëzakonshëm)..." - kujton një viktimë.

... Ishte një varrezë e vogël që po pastrohej aty afër. Çekistëve u erdhi një ide e mbrapshtë: ata do t'i linin varret hapur, me skeletet dhe trupat që kalben në sy të të gjithëve. Pikërisht atje i zgjidhën çështjet më të vështira. Ata kishin disa metoda torturimi shumë brutale. Shumë të burgosur vareshin nga këmbët, kokëposhtë, për ditë të tëra. Të tjerë i mbyllnin në dollape shumë të vegjël vetëm me një vrimë të vockël

ajri afër fytyrës, për të marrë frymë... Një prej metodave më të tmerrshme njihej si "sirtari": të burgosurit ishin të detyruar të rrinin galiç brenda disa kutive shumë të vogla katrore për ditë të tëra. Disa mbaheshin atje pa qenë në gjendje të lëviznin nga tetë deri në dhjetë ditë.<sup>113</sup>

Në 1931 Papa Piu XI u shpreh në këtë mënyrë rreth dhunës që ushtronte Komunizmi në botë në qarkoren "Quadragesimo Anno":

Komunizmi mëson dhe synon dy objektiva: **luftë të rreptë klasash dhe zhdukje të pronës private.** Ai s'e bën këtë fshehurazi apo me metoda të maskuara, por publikisht dhe duke përdorur çdo lloj mjeti të mundshëm, madje edhe më të dhunshmin. Për të arritur këto objektiva, ai nuk stepet para asgjëje, për të cilën duhet ndjerë respekt apo nderim. Kur vjen në pushtet, ai është i egër në mizorinë dhe veprimet e tij çnjerëzore. **Vrasjet dhe shkatërrimi i tmerrshëm, me anë të të cilave ka lënë të shkreta vise të mëdha të Evropës Lindore dhe Azisë, dëshmojnë për këtë.**<sup>114</sup>

Siç thuhet më sipër, qëllimi kryesor i Komunizmit ishte një



**Përkrahësit komunistë të Maos i ndëshkonin me mënyra mizore kundërshtarët e tyre në luftën civile, në fillim duke i poshtëruar para njerëzve dhe pastaj duke i vrrarë.**

luftë klasash e pamëshirshme, si dhe asgjësimi i plotë e pronës private. Me fjalë të tjera, qëllimi ishte të zbatohej teoria e evolucionit, të cilën Darvini e kishte zbatuar në fushën biologjike, me shoqëritë njerëzore dhe, në të njëjtën kohë, qeniet njerëzore duhet të ishin, si kafshët e egra në natyrë, në konflikt të përhershëm.

Katastrofat që solli komunizmi nuk mbaruan në Rusi. Një prej vendeve që u prek më shumë nga terrori i kuq ishte edhe Kina.

### **Darvinisti Mao Ce Dun dhe masakrat e tij**

Udhëheqësi komunist i Kinës, Mao, kishte dy udhërrëfyes: njëri prej tyre, siç e kemi përmendur më parë, ishte Darvini, kurse tjetri ishte Stalini. Të dy këta emra vdekjeprurës, që bashkoheshin në personalitetin e Maos, çuan në tragjedi të mëdha dhe lanë gjurmën e tyre në një periudhë të gjatë e të errët të historisë së Kinës. Gjashtë deri në dhjetë milionë njerëz u vranë me urdhër të Maos, dhjetra miliona "kundër-revolucionarë" kaluan pjesën më të madhe të jetës së tyre në burg, ku 20 milionë prej tyre vdiqën. 20 deri në 40 milionë njerëz vdiqën nga uria në vitet 1959-1961, gjatë periudhës së quajtur "Hapi i Madh Përpara", si pasojë e politikave ekstremiste të Maos. Masakra e qershorit 1989 në Sheshin "Tienanmen" (rreth 1000 të vdekur) është një shembull i asaj që Kina ka vuajtur në historinë e saj të kohëve të fundit. Vrasjet dhe genocidi kundër turqve muslimanë në Turkmenistanin Lindor vazhdojnë ende.

Gjëra të pabesueshme ndodhën gjatë revolucionit komunist në Kinë. Njerëzit, nën ndikimin e një lloj hipnotizimi masiv, përkrahën të gjitha llojet e barbarizmit dhe e treguan këtë përkrahje duke brohoritur kur shikonin vrasjet. "Libri i Zi i Komunizmit", i përgatitur nga një grup historianësh dhe mësuesish, i përshkruan metodat barbare të Komunizmit në këtë mënyrë:

Të gjithë njerëzit ishin të ftuar në gjyqet publike të "kundër-revolucionarëve", të cilët pothuajse gjithmonë

dënoheshin me vdekje. Të gjithë merrnin pjesë në ekzekutime, duke u ulëritur "vritini, vritini" Rojeve të Kuqe, detyra e të cilëve ishte t'i bënë viktimat copa-copa. Nganjëherë copat gatuhashin dhe hareshin, ose u jepeshin me zor anëtarëve të familjes së viktimës që ishin ende gjallë e që e shihnin skenën me sytë e tyre. Pastaj, që të gjithë ftoheshin në një banket, ku mëlçia dhe zemra e ish-pronarit të tokës ndahej me të gjithë, dhe në mbledhje, ku folësi i drejtohej vargut të kokave të prera të saposhkuara në hell mbi hunj. Kjo dhënie pas kanibalizmit hakmarrës, që më vonë u bë e zakonshme nën regjimin e Pol Potit, të sjell ndërmend një arkitip shumë të lashtë të Azisë Lindore që shfaqet shpesh në çaste kataklizmike në historinë e Kinës.<sup>115</sup>

### **Numri i madh i viktimave të barbarisë komuniste**

Shembuj të ngjashëm barbarizmi pati në çdo vend që gllabëroi Komunizmi, Kamboxhia, Korea e Veriut, Laosi, Vietnami dhe në vendet e Evropës Lindore apo Afrikës. Kjo listë e përgjakur parashtrahet në "*Librin e zi të Komunizmit*" si vijon:

Këto krime duket se i përkasin një modeli të njohur, ndonëse metodat ndryshojnë deri në njëfarë mase, në varësi të regjimit. Modeli përfshin ekzekutimet me mënyra të ndryshme, si p.sh. skuadra pushkatimi, varje, mbytje, rrahje, gaz helmues, "aksidente me makinë", zi buke, internim, punë e detyruar. Periudhat që përshkruhen si kohë "të luftës civile" janë më të ndërlikuara; nuk është gjithmonë e lehtë të bëhet dallimi midis ngjarjeve që shkaktohen nga luftimet mes sunduesve e rebelëve dhe ngjarjeve që mund të përshkruhen me të drejtë si masakër kundër popullsisë civile.

Sidoqoftë, nga diku duhet të fillojmë. Shifrat e dhëna me përafërsi në vijim, të bazuara në përlllogaritje jozyrtare, japin një ide të shkallës dhe peshës së rëndë të këtyre krimeve:

|                 |                    |
|-----------------|--------------------|
| <b>BRSS:</b>    | 20 milionë vdekje  |
| Kinë:           | 65 milionë vdekje  |
| Vietnam:        | 1 milion vdekje    |
| Kore e Jugut:   | 2 milionë vdekje   |
| Kambohia:       | 2 milionë vdekje   |
| Evropa Lindore: | 1 milion vdekje    |
| Amerika Latine: | 150 000 vdekje     |
| Afrikë:         | 1.7 milionë vdekje |
| Afganistan:     | 1.5 milionë vdekje |

Lëvizja ndërkombëtare komuniste dhe partitë komuniste jo në pushtet: afërsisht 10000 vdekje

Shuma e përgjithshme tregon afro 100 milionë njerëz të vrarë.<sup>116</sup>

Gjithë këto regjime e organizata komuniste kishin një psikologji të përbashkët: të gjitha ndjenjat njerëzore si keqardhja, drejtësia e dhembshuria kishin humbur tërësisht. Krejt papritur, shoqëritë njerëzore ishin kthyer në palë ndërluftuese, si kafshët e egra që përpiqen të jetojnë e të gjejnë ushqim. Ashtu si lufton një kafshë e egër me anëtarët e tjerë të llojit të vet për ushqim e territor, po ashtu u sollën edhe këta njerëz, sepse teoria e Darvinit u kishte mësuar se ata ishin me të vërtetë kafshë dhe si të tillë duhet të luftonin për të mbijetuar.

Këto lëvizje çnjerëzore mendonin se kishin fituar respektin me vënien e maskës së rreme shkencore. Arsyeja e vetme pse udhëheqësit bolshevikë flisnin kaq hapur e me guxim për agresion, terrorizëm e masakra ishte se kishin miratimin e teorisë së evolucionit. Në librin e tij "Evolucioni për natyralistët", P. J. Darlington pohon, si evolucionist, se barbaria është rezultat i natyrshëm i teorisë së evolucionit dhe se kjo sjellje, madje, është e justifikueshme:

Pika e parë është se egoizmi dhe dhuna janë të lindura, të trashëguara nga paraardhësit tanë të largët shtazorë... **Dhuna, atëherë, është e natyrshme për njeriun, i cili është pjellë e evolucionit.**<sup>117</sup>

## Shtypja në Turkistanin Lindor

Sado që është pranuar nga njerëzit se shpërbërja e Bashkimit Sovjetik shënoi fundin e Komunizmit si regjim politik, ideologjia dhe praktikat komuniste vazhdojnë të ekzistojnë ende. Praktikrat e ndjekura nga Rusia, ku sundon ende mentaliteti i Ushtrisë së Kuqe, në Çeçeni, apo Kina në Turkistanin Lindor janë treguesit më të rëndësishëm. Me turqit muslimanë që jetojnë sot në Turkmenistanin Lindor po përsëritet e njëjta gjë si në Kinën e Kuqe të Maos. Të rinjtë arrestohen pa asnjë shkak, dënohen me vdekje për arsyen se janë kundërshtarë të regjimit dhe pushkatohen. Muslimanët nuk lejohen të kryejnë detyrat e tyre fetare në grup; fitimet e tyre zhvaten nëpërmjet taksave të pamëshirshme; njerëzit kërcënohen të vdesin urie dhe provat bërthamore që kryhen pranë vendeve ku ata jetojnë u shkaktojnë sëmundje vdekjeprurëse. Ka 250 vjet që turqit muslimanë të Turkmenistanit Lindor jetojnë nën qeverisjen kineze. Kinezët i vunë emrin "Siankiang" ose "toka të pushtuara" Turkmenistanit Lindor dhe e përkufizuan si territorin e tyre. Pasi komunistët e udhëhequr nga Maoja morën pushtetin në vitin 1949, presioni mbi Turkistanin Lindor u rrit më tepër se më parë. Politika e regjimit komunist synonte shkatërrimin fizik të muslimanëve që refuzonin asimilimin. Numri i muslimanëve të vrarë arriti përmasa të frikshme. Nga 1949-1952, 2.800.000 njerëz; nga 1952-1957, 3.509.000; nga 1958-1960, 6.700.000; nga 1961-1965, 13.300.000. Këta njerëz u vranë nga ushtria kineze ose vdiqën si rezultat i krizës së bukës, të shkakuar nga regjimi. Bashkë me masakrat pas vitit 1965, numri i turkmenëve lindorë të vrarë arriti shifrën e pabesueshme prej 35 milionësh. Përveç shfarosjes së muslimanëve që kishte filluar qysh në vitin 1949, regjimi sillte kolonë kinezë në mënyrë sistematike. Në një kohë që në vitin 1953, 75% e popullsisë ishte muslimane dhe 6% kineze, në vitin 1982 shifrat kishin ndryshuar në 43% muslimanë dhe 40% kinezë. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1990, që provoi se popullsia tani ishte 40% muslimane dhe 53% kineze, është shumë i rëndësishëm për njohjen e shkallës së spastrimit etnik.

Ndërkohë, administrata kineze përdori muslimanët e Turkistanit Lindor si kafshë eksperimentale në provat bërthamore. Si pasojë e provave bërthamore, që së pari filluan në vitin 1964, vendasit janë infektuar nga sëmundje vdekjeprurëse dhe kanë lindur rreth 20,000 fëmijë handikapatë. Dihet se numri i muslimanëve që kanë vdekur për shkak të provave bërthamore është 210,000. Me mijëra njerëz janë gjymtuar dhe me mijëra të tjerë kanë rënë pre e sëmundjeve të tilla si verdhëza e kanceri. Nga viti 1964 e deri tani, Kina ka shpërthyer rreth 50 bomba atomike e hidrogjeni. Ekspertët suedezë kanë përcaktuar se një provë bërthamore e nëndheshme e një bombe me një forcë prej 150 tonësh në vitin 1984, kishte shkakuar lëkundje të tokës të një magnitudë prej 8.8 ballësh sipas shkallës Rihter.

Siç shihet qartë edhe nga pohimi i këtij evolucionisti, ishte krejt e natyrshme për ideologjinë komuniste që kishte pranuar teorinë e Darvinit si udhërrëfyese, t'i perceptonte qeniet e tjera njerëzore si kafshë dhe t'i trajtonte në një mënyrë që u shkon për shtat kafshëve. Ai që pranon ideologjinë komuniste darviniste harron që është krijuar nga një Krijues, harron arsyen për të cilën gjendet në botë dhe faktin që Ditën e Gjykimit do të japë llogari para këtij Krijuesi për të gjitha ato që ka vepruar. Për pasojë, si çdo qenie njerëzore që nuk i frikësohet Zotit, ai bëhet një egoist që sheh vetëm interesin e vet, një tiran i pamëshirshëm, madje edhe vrasës i krisur. Kurani na e përshkruan në këtë mënyrë gjendjen e këtyre njerëzve dhe atë që do t'u ndodhë atyre:

**Arsye fajsimi ka vetëm kundër atyre që u bëjnë keq njerëzve dhe sillen si tiranë në tokë, ndërkohë që nuk kanë asnjë të drejtë për ta bërë një gjë të tillë. Për këta do të ketë një ndëshkim të dhimbshëm. (Kuran, Sure "Esh-Shuura":42)**

### **Shtypja pa fund në Çeçeni**

Pushtimi i Çeçenisë nga Rusia në vitin 1991, pavarësisht se u zmbraps nga i ndjeri Xhokar Dudajev, u kthye në një luftë të vërtetë më 11 dhjetor 1994, fill pas trazirave të rënda në nëntor të po atij viti. Ndërkohë që më shumë se 100,000 çeçenë humbën jetën e tyre në atë luftë, dhjetëra mijëra u detyruan të shpërngulen. Çeçenia humbi qindra burime historike dhe ekonomike në luftë. Kur Rusia shpalli se Çeçenia ishte një "çështje e brendshme", asnjë protestë nuk erdhi nga bashkësia ndërkombëtare. Tonelata me bomba u hodhën në Çeçeni. U zhvillua një genocid i paparë ndonjëherë në historinë e botës, me armë kimike, përdorimi i të cilave ishte i ndaluar. Ky genocid vazhdon edhe sot e kësaj dite, por pavarësisht nga vështirësitë e shumta, në gusht 1996 rusët u detyruan të pranojnë humbjen me çeçenët, të cilët qëndruan të paepur dhe luftuan për lirinë e atdheut



“ Gjithësesi, ata që tregohen të padrejtë, shkojnë pas tekave e dëshirave të tyre në padituri të plotë. E kush mund t’i udhëzojë ata që i ka braktisur Zoti?! Askush s’do t’u vijë në ndihmë atyre. ”  
(Kuran, Surja Er-Rum: 29)

të tyre me të gjitha mjetet që kishin në dispozicion.

Rusia, që u detyrua ta pranojë Çeçeninë si shtet të pavarur në marrëveshjet e firmosura në instancat më të larta në gusht 1966 dhe maj 1997, dukej se e kishte pranuar këtë situatë, por në tetor 1997 rusët u rifutën në territorin çeçen dhe filluan përsëri reprezaljet. Objektivat civile u bombarduan pa pushim për muaj të tërë. Me qëllim që të thyenin rezistencën popullore, si objektiva zgjidheshin spitalet, maternitetet, tregjet dhe autokolonat me refugjatë. Në fund u vendos që rusët të përdorin bomba kimike, raketa "Skud" dhe me napalm kundër çeçenëve. Krahas kësaj, rusët hodhën helm në lumin Argun, që përdorej nga shumë fshatra çeçene. Ndërkohë që pjesa më e madhe e grave dhe fëmijëve që pinë ujin e helmuar vdiqën, qindra të tjerë prisnin vdekjen në dyert e spitaleve. Për shkak se uji i lumit ishte helmuar, popullsia civile që nuk kishte ku të gjente ujë për të pirë, kaloi kohë tepër të vështira.

## **Magjia e ideologjisë komuniste Darviniste është prishur**

Komunizmi është një ideologji që u krijua nga njerëz që jetuan në vitet 1800 dhe që mund të përshkruhen si "inJORANTë" nga pikëpamja shkencore. Një nga arsytet më të rëndësishme që ideologjia komuniste fitoi menjëherë ndikim mbi një numër të madh njerëzish në shumë vende është inJoranca e atyre që e pranuan këtë ideologji, pretendimet e së cilës janë vërtetuar shumë herë se janë gënjeshtër.

Pas revolucionit industrial, fakti që një pjesë e shoqërisë jetonte në varfëri të plotë dhe krahas kësaj, pjesa tjetër ngrihej në një nivel të pakrahasueshëm mirëqenieje, solli një tension që ngjalli trazira në grupet shoqërore në shumicën e vendeve. Ky tension u zhvillua më tej në vende si Rusia, që ende jetonin në nivelin e një shoqërie bujqësore, si dhe Kina. Grupet shoqërore në kërkim të të drejtës u ndoqën nga shumë njerëz, por rezultati përfundimtar doli kundër tyre. Ata jetuan në kushte ekonomike shumë më të këqija se më parë; nga njëra anë, luftë për të shmangur vdekjen nga uria, nga ana tjetër, frika e përndjekjeve politike.

Eshtë e qartë se një ideologji që mbështetej në mungesën e besimit në Zot dhe besonte se baza e vetme për zhvillim ishte konflikti dhe se qeniet njerëzore, në thelb, janë kafshë, një ideologji që përmbyste vlerat morale si familja, besnikëria, dhe afria njerëzore, duke i konsideruar si të panevojshme, nuk do t'u sillte njerëzve paqe e lumturi. Por këtyre grupeve shoqërore u mungonte largpamësia dhe logjika për t'i vlerësuar e analizuar këto. Ata shihnin fotografitë e Marksit e Engelsit dhe mendonin se ata ishin mendimtarët më të "mëdhenj", "më të thellë" e "më të ditur". Shihnin pamjen e jashtme mashtruese shkencore e të mistershme dhe magjepseshin nga Komunizmi e Materializmi. Kurse sot, po të ishin gjallë, do ta kishin kuptuar se të gjithë udhëheqësit komunistë kanë qenë të paditur e primitivë.

Sot, shumë nga komunistët "e orëve të para" e kanë kuptuar se çfarë gabimi të madh kanë bërë në të kaluarën

dhe janë penduar. Secili prej tyre e ka kuptuar se ka shkuar verbërisht pas një ideali jofrytdhënës ose më mirë, pas një zhurme të madhe boshe. Të tjerë përpiqen të tregojnë se nuk kanë hequr ende dorë nga ideologjia e tyre që të mos pranojnë humbjen dhe të vërtetën se vitet u kanë shkuar kot e thonë: "Ne do të triumfojmë!"

Ka ardhur një kohë kur shkenca dhe dija e lirë mund të arrijnë kudo e kurdo, kur çdo qenie njerëzore mund t'i kuptojë faktet shumë më lehtë se më parë. Në një ambjent të tillë, metodat e sugjestionit, metodat e komunistëve, materialistëve dhe darvinistëve, fjalët dhe thirrjet e tyre kobndjellëse për luftë, tashmë e kanë humbur fuqinë e tyre. Ideologjitë boshe si Komunizmi, Materializmi dhe Darwinizmi, fuqia magjepsëse e të cilave mund të zhduket me pak shkencë dhe me pak arsyetim, po e humbasin me shpejtësi ndikimin e tyre mbi qeniet njerëzore.

### **Përfundimi: Komunizmi është një terror i vërtetë, i shkaktuar nga mungesa e fesë**

Kur mendon për masakrat, vrasjet dhe vuajtjet e shkaktuara qëllimisht nga komunistët, nazistët apo kolonialistët, kushdo pyet veten se si arritën përkrahësit e këtyre ideve ta distanconin veten kaq shumë nga ndjenjat njerëzore. Arsyeja e vetme për barbarizmin dhe shtypjen e ushtruar nga këta udhëheqës është mungesa e fesë dhe fakti se këta njerëz nuk i frikësoheshin Zotit. Një qenie njerëzore që i frikësohet Zotit dhe që ka besim të patundur në jetën e përtejme, pa dyshim që nuk do të ishte në gjendje të kryente asnjë nga shtypjet apo padrejtësitë që kemi përshkruar. Për më tepër, atë që beson në Zot dhe në jetën e amshuar nuk e bind dot kurrë të ndjekë një ideologji të tillë të shtrembër, sado që ta nxisësh.

Në 1983, shkrimtar rus Aleksandër Sollzhenjicin, fitues i çmimit Nobël në letërsi në vitin 1970, mbajti një ligjëratë në Londër dhe u përpoq të shpjegonte pse i kanë rënë kaq të këqija mbi supe popullit të tij:

Gjysmë shekulli më parë, kur isha ende fëmijë, mbaj mend se kam dëgjuar disa të moshuar që jepnin shpjegimin e mëposhtëm për fatkeqësitë që i kishin rënë



Një regjim me  
pikëpamje  
komuniste-darviniste  
i quan njerëzit e tij të  
pavlerë e i lë ata, me  
ndërgjegje të plotë, të  
vdesin e të jetojnë në  
varfëri. Rusia është  
një shembull i qartë i  
kësaj.



Rusisë: "Njerëzit e kanë harruar Zotin; prandaj dhe ndodhi e gjitha kjo."

Qysh atëherë kam kaluar pothuaj 50 vjet, duke u marrë me historinë e revolucionit tonë; gjatë këtij procesi kam lexuar me qindra libra, kam mbledhur qindra dëshmi personale dhe kam kontribuar me 8 vëllime të miat në përpjekje për të pastruar gërmadhat që la pas ajo turbullirë, por po të më kërkonin sot të formuloj në mënyrë sa më koncize shkakun kryesor të atij revolucionit shkatërrimtar që gllabëroi rreth 60 milionë nga njerëzit tanë, nuk do të mund ta shprehja më saktë, sesa të përsëris: "Njerëzit e kanë harruar Zotin; prandaj dhe ndodhi e gjithë kjo."<sup>118</sup>

Ky identifikim i Sollzhenjicinit ishte plotësisht i saktë. Me të vërtetë, gjëja e vetme që mund ta zvarriste një shoqëri në gjithë atë tmerr dhe ta bënte të mbyllte sytë me indiferentizëm para të gjitha llojet e shtypjes, ishte harrimi i ekzistencës së Zotit. Mirëpo Zoti nuk harron e nuk gabon kurrë. Udhëheqësit komunistë menduan se kishin krijuar sistemin e tyre për të sunduar shoqëritë në botë dhe menduan se zotëronin një pushtet e forcë të madhe. Ata, madje, mbajtën edhe takime sekrete ku biseduan për shtypjen e mëtejshme që do t'u sillnin njerëzve me qëllim që të konsolidonin pushtetin e të rrisnin fuqinë e tyre, por ndërkohë që ata bënë këtë gjë.

E vetmja mënyrë për të parandaluar përsëritjen e këtyre katastrofave është që njerëzit të jetojnë me besimin te Zoti dhe jeta e amshuar, pa harruar se do të japin llogari për gjithçka që bëjnë. Në Kuran thuhet:

**Kujtdo që vepron drejt, goftë mashkull a femër, e që është besimtar, Ne do t'i dhurojmë një jetë të mirë e do ta shpërblejmë shumëfish për veprat e mira që ka kryer. (Kuran, surja En-Nahl: 97)**

# Kapitalizmi dhe lufta për mbijetesë në ekonomi



**T**ermi "Kapitalizëm" do të thotë "sovrانيتet i kapitalit": një sistem ekonomik i lirë e i pakufizuar, i mbështetur tërësisht te përfitimi e ku shoqëria është në konkurrencë brenda këtyre kriterëve. Gjenden tre elemente të rëndësishme në Kapitalizëm: individualizmi, konkurrenca dhe fitimi. Individualizmi është i rëndësishëm në Kapitalizëm, sepse njerëzit e shohin veten jo si pjesë të shoqërisë, por si "individë" që mbahen me këmbët e tyre. "Shoqëria kapitaliste" është një arenë, ku individët konkurrojnë me njëri-tjetrin në kushte shumë shtrënguese. Ajo është një arenë pikërisht si ajo që përshkruan Darvini, ku vetëm më i forti mbijeton, ku i dobtit e i pafuqishmi shtypen e eliminohen dhe ku vetëm konkurrenca e pamëshirshme ka pushtet.

Sipas logjikës, në të cilën mbështetet Kapitalizmi, çdo individ – e ky mund të jetë një njeri, një shoqëri, apo një komb - duhet të luftojë vetë për zhvillimin dhe ruajtjen e avantazhit të vet. Kriteri më i rëndësishëm në këtë luftë është prodhimi. Prodhuesit më të mirë mbijetojnë, të dobtit e të paaftët eliminohen dhe zhduken. Me këtë formë sistemi, harrohet që ata që eliminohen në luftën e hidhur dhe bien kthetrat e varfërisë janë **njerëz**. Ajo çka shihet si diçka që meriton vëmendje nuk janë qeniet njerëzore, por zhvillimi ekonomik dhe mallrat, produkti i këtij zhvillimi. Për këtë arsye, mentaliteti kapitalist nuk ndjen përgjegjësi morale për njeriun që shkelet me këmbë, i cili detyrohet të jetojë në vështirësi të mëdha. Ky është Darwinizmi i vënë në jetë në shoqëri me mënyra ekonomike.

Duke propozuar se ishte e domosdoshme të nxitej konkurrenca në të gjitha fushat e shoqërisë dhe, duke

shpallur, se ishte e domosdoshme të mos siguroheshin mundësi apo mbështetje për të dobtit, në asnjë lloj fushe, teoricienët më të rëndësishëm të Darwinizmit Social përgatitën një mbështetje "filozofike" dhe "shkencore" për Kapitalizmin. Për shembull, sipas Tille, një përfaqësues i rëndësishëm i mentalitetit kapitalist darvinist, do të ishte një gabim i madh të përpiqeshe të parandaloje varfërinë duke ndihmuar "klasat e mundura", sepse kjo do të thoshte të ndërhyje në përzgjedhjen natyrore që sjell evolucioni.<sup>119</sup>

Sipas mendimit të Herbert Spenserit, teoricienit kryesor të Darwinizmit Social, i cili ia mveshi parimet e Darwinizmit jetës së shoqërisë, në qoftë se dikush është i varfër, kjo ndodh për fajin e tij; askush nuk duhet ta ndihmojë këtë person që të ngrihet në këmbë. Nëse dikush është i pasur, edhe sikur ta ketë fituar pasurinë në mënyrë të pandershme, kjo tregon zotësinë e tij. Për këtë arsye, i pasuri mbijeton, kurse i varfri zhduket. Kjo është pikëpamja që ka mbizotëruar pothuajse tërësisht në shoqëritë e sotme dhe është një përmbledhje e moralit kapitalist-darvinist.

Spenseri, i cili e mbrojti këtë moral, e përfundoi



veprën e tij "Social Statistics" në vitin 1850 dhe i kundërshtoi të gjitha sistemet e ndihmës së ofruar nga shteti, masat paraprake për mbrojtjen e shëndetit, shkollat shtetërore dhe vaksininimin e detyruar, sepse, sipas Darwinizmit Social, rendi shoqëror doli nga parimi i mbijetesës së më të fortit. Të përkrahje të varfrit dhe t'i lejoje që të mbijetonin do të thoshte ta shkelje këtë parim. Të pasurit janë të pasur, sepse përshtaten më mirë; disa kombe sundojnë të tjerët, sepse janë superiorë ndaj tyre, disa raca bien nën zgjedhën e të tjerave, sepse këto të fundit janë më inteligjente.

Spenseri e zbatoi këtë doktrinë në shoqëritë njerëzore me të gjitha forcat: "Në qoftë se janë të kompletuar, aq sa duhet për të jetuar, ata jetojnë dhe bëjnë mirë që jetojnë. Në qoftë se nuk janë të kompletuar, sa duhet për të jetuar, ata vdesin dhe është më mirë që vdesin."<sup>120</sup>

Graham Sumner, profesor i shkencave politike e shoqërore në Universitetin e Jejlit, ishte zëdhënësi i Darwinizmit Social në Amerikë. Në një prej shkrimeve të tij, ai i përmbloodhi idetë e veta mbi shoqëritë njerëzore me këto fjalë:

**Njerëz që vuajnë nga uria  
Megjithëse sot në botë gjenden  
burime të konsiderueshme, miliona  
fëmijë lihen të vdesin urie për shkak  
të mentalitetit kapitalist.**





!! Dhe në pasurinë e tyre ka një pjesë të caktuar për lypësin dhe të mjerin. !!  
(Kuran, surja Edh Dharijat: 19)



... në qoftë se ngremë dikë lart, duhet të kemi një pikë mbështetjeje, një pikë kundërveprimi. Në shoqëri, kjo do të thotë se që të ngresh një njeri, do të ulësh një tjetër.<sup>121</sup>

Richard Milner, redaktor i vjetër i "Revistës së Historisë së Natyrës" të Muzeut Amerikan të Historisë së Natyrës në Nju Jork shkruan:

Një prej zëdhënësve kryesorë të Darwinizmit Social, Graham Sumner, mendonte se milionerët ishin individët "më të përshtatshëm" në shoqëri dhe i meritonin privilegjet e tyre. Ata ishin "përzgjedhur natyrshëm në provën e vështirë të konkurrencës".<sup>122</sup> Siç shihet, darvinistët socialë përdorën teorinë e Darvinit për evolucionin si koment "shkencor" mbi shoqëritë kapitaliste. Si pasojë e kësaj, qeniet njerëzore nisën të humbisnin koncepte të tilla, të cilat i kishte sjellë feja, si ndihma reciproke, filantropia e bashkëpunimi dhe, në vend të këtyre virtyteve, filluan



!! Dhe le të mos betohen disa prej jush, të cilëve u është dhënë mirësi e pasuri, për të mos u dhënë (asnjë lloj ndihme) të afërmeve të tyre, të vobektëve dhe atyre që emigruan për hir të Allahut! Le të falin dhe të tregojnë zemërbutësi! A nuk dëshironi që Allahu t'ju falë ju? Allahu është Falës, Mëshirëplotë. !! (Kuran, surja En-Nur: 22)



të mbivlerësonin egoizmin, dredhitë dhe oportunizmin. Sipas njërit prej teoricienëve më të rëndësishëm të Darwinizmit Social, profesorit amerikan E. A. Ross, "Kulti i krishterë i bamirësisë, si burim mëshire, ka krijuar një strehë, nën të cilën janë zvarritur e janë edukuar idiotë e debilë... Shteti mbledh shurdhmemecët në krahët e tij dhe një racë me shurdhmemecë është në formim e sipër... Rruga më e shkurtër për ta shndërruar këtë botë në parajsë është t'i braktisësh e t'i lesh të lirë ata që janë të prirur të nxitojnë drejt ferrit me hapin e tyre."<sup>123</sup>

Siç e kemi parë, Darwinizmi përbën bazën filozofike të të gjitha sistemeve ekonomike kapitaliste në botë si dhe të sistemeve politike që e marrin formën prej tyre.

Kjo është arsyeja që përkrahësit më të flaktë të Darwinizmit Social ishin pronarët e kapitaleve. Ngritja e të fortëve duke shkelur të dobtit dhe ndjekja e politikave ekonomike të ndara prej ndjenjës së keqardhjes dhe ndihmës, nuk dënoheshin më, sepse një

sjellje e tillë u pranua se ishte në përputhje me "shpjegimet shkencore" dhe "ligjet e natyrës". Sipas Richard Hofstadter, autor i librit "Darvinizmi Social në mendimin amerikan", industrialisti i madh i hekurudhave në shekullin XIX Chancey Depew ka pohuar se njerëzit që fitonin famë, pasuri, dhe pushtet në Nju Jork përfaqësonin mbijetesën e më të fortit, nëpërmjet "aftësisë superiore, largpamësisë dhe përshtatshmërisë".<sup>124</sup> Një tjetër bos hekurudhash, James J. Hill, është shprehur se "pasuritë e shoqërive hekurudhore përcaktohen nga ligji i mbijetesës së më të fortit."<sup>125</sup>

Në biografinë e tij, Andrew Carnegie, një tjetër pronar i madh kapitalesh në Amerikë, shpreh besimin e tij tek evolucioni me fjalët: "Kisha gjetur të vërtetën e evolucionit."<sup>126</sup>

Diku tjetër ai ka shkruar këto fjalë:

**Ai (ligji i konkurrencës) është këtu, nuk e shmangim dot, s'janë gjetur zëvendësues për të dhe ligji mund të jetë i ashpër nganjëherë për individin, por është më i mirë për racën, sepse ai siguron mbijetesën e më të fortit në çdo fushë.**<sup>127</sup>

Në artikullin e tij "Tri gabimet e Darvinit", shkencëtari evolucionist Kenet J. Hsy, bën të njohur mendimet darviniste të kapitalistëve më të mëdhenj të Amerikës:

Darvinizmi u përdor, gjithashtu, në mbrojtje të individualizmit konkurrues dhe rrjedhimit ekonomik, kapitalizmit, në Angli e Amerikë. Andrew Carnegie shkroi se "ligji i konkurrencës, qoftë i mirë apo i keq, është këtu, ne nuk e shmangim dot". Rokfeleri bëri një hap më tutje kur tha se "zhvillimi i një biznesi të madh është thjesht mbijetesë e më të fortit; është funksionim i një ligji të natyrës".<sup>128</sup>

Eshtë mjaft interesante që në Amerikë fondacionet e ndryshme si Fondacioni "Rokfeler" apo Instituti "Carnegie", të themeluara nga dinasti të mëdha kapitaliste, japin mbështetje të rëndësishme financiare

për të bërë punë kërkimore në fushën e evolucionit.

Siç e kemi parë nga ajo që është shpjeguar deri tani, Kapitalizmi i ka bërë njerëzit të adhurojnë vetëm paratë dhe pushtetin që sjell paraja. Duke i konsideruar të gjitha llojet e vlerave fetare e etike si të pavlera, shoqëritë, të ndikuara nga idetë evolucioniste, filluan t'i jepnin rëndësi pushtetit material dhe u distancuan nga ndjenja të tilla njerëzore si dhembshuria, mëshira dhe sakrifica.

Ky moral kapitalist ka pasur dhe ka ndikim të fortë në pothuajse të gjitha shoqëritë e ditëve të sotme. Për këtë arsye, në pjesën dërrmuese të vendeve, s'ka më bamirësi për të varfrit, të pashpresët dhe të gjymtuarit. Edhe sikur të bien viktimë e sëmundjeve më të rënda e vdekjeprurëse, ata nuk janë në gjendje të gjejnë ndonjë ndihmë fizike apo njerëzore për t'u mbrojtur. I varfri lihet në varfërinë e tij. Në shumë vende ndeshen shpesh praktika të padrejta e çnjerëzore, p.sh. fëmijë të vegjël që detyrohen të punojnë dhe lihen pa asnjë të drejtë shoqërore. Sot, arsyeja që shtete të tilla si Etiopia kanë rënë pre e thatësirës dhe urisë është dominimi i këtij morali kapitalist. Në një kohë që ndihma dhe përkrahja e shumë shteteve mund t'i shpëtonte këta njerëz të uritur, ata lihen të vdesin urie. Në këtë pikë duhet të tërhiqet vëmendja në një çështje të rëndësishme: Gjatë gjithë historisë kanë ekzistuar gjithnjë shoqëri ku të varfrit e të dobtit nuk liheshin të ngrinin kokën, ku vetëm vlerat materiale kishin rëndësi dhe ku egoizmi, interesi vetjak dhe mashtrimi shiheshin si e vetmja rrugë për t'u pasuruar. Edhe në të kaluarën jetonin njerëz, të cilët mendonin se vetëm gjërat materiale mund të kishin vlerë dhe të cilët ishin shumë larg nga tiparet e çfarëdo lloji morali të kënaqshëm. Por nga gjysma e dytë e shekullit XIX, njerëz me pikëpamje të tilla hynë në një periudhë krejt të ndryshme. Këto 150 vitet e fundit, njerëzit dhe shoqëritë që zotërojnë këto cilësi mizore kanë filluar të mos dënohen apo kritikohen. **Një sjellje e tillë nisi, më në fund, të pranohet si ligj i natyrës dhe në këtë pikë Darwinizmi u kthye në një fe të rreme që**

justifikonte pandershmërinë dhe mizorinë. Robert E. D. Clark e shpjegon këtë situatë në këtë mënyrë:

Evolucioni, me pak fjalë, e la të qetë ndërgjegjen e keqbërësit. Për sjelljen më të paskrupullt kundrejt një konkurrenti mund të jepej një shpjegim i arsyeshëm; e keqja mund të quhej e mirë.<sup>129</sup>

H. Enoch shkruan në librin e tij "Evolucion apo Krijim":

J. Holmes thotë se "Darvinizmi i zbatuar në mënyrë të vazhdueshme do ta maste të mirën e shprehur në vlerë mbijetese" ... Ky është ligji i xhunglës, ku "i forti ka të drejtë" dhe më të fortët mbijetojnë. Qoftë dredhi a mizori, burracakëri a mashtrim, çfarëdo që do t'ia bëjë të mundur individit të mbijetojë, është e mirë dhe e drejtë për atë individ apo atë shoqëri.<sup>130</sup>

Siç e kemi parë, Darwinizmi dhe mungesa e fesë qëndrojnë prapa gjithë atyre njerëzve, sistemeve dhe ideologjive që kanë sjellë dhimbje dhe dëshpërim në botë, sidomos në 150 vitet e fundit. Ata që menduan se mund të mbronin interesat e tyre në mjedisin egoist e të pamëshirshëm, të shkaktuar nga mungesa e fesë, e shihnin Darwinizmin si shpëtimtarin e tyre. Ata përdorën tezën e Darwinizmit "të dobtit zhduken, ndërsa të fortit jetojnë" si filozofi për veten e tyre.

Sa për ata që nuk janë ndikuar nga mënyra e të menduarit darvinist-kapitalist dhe nuk kanë harruar arsyen e ekzistencës në këtë botë, ata i shohin qeniet e tjera njerëzore si krijesa të Zotit. Ata gjithmonë i trajtojnë qeniet e tjera njerëzore me dashamirësi, ndjejnë dashuri e dhembshuri dhe bëjnë ç'është e mundur për t'i larguar vështirësitë dhe shqetësimet e tyre. Ata flasin gjithmonë fjalët më të mira, kujdesen për jetimët, ndihmojnë të sëmurët dhe të gjymtuarit.



## Rrënimi moral që solli Darwinizmi

Fatkeqësia më e madhe që Darwinizmi i solli njerëzimit ishte, pa dyshim, largimi masiv i njerëzve nga feja. Një boshllëk i madh moral e shpirtëror u krijua menjëherë te shoqëritë që u larguan nga besimi në Zot. Ka shumë shembuj për këtë në shoqëritë e ditëve tona. Disa njerëz do të thonë që Darwinizmi nuk mund të quhet përgjegjës për mungesën e besimit në Zot, sepse një numër i madh i këtyre njerëzve që bëjnë një jetë jofetare nuk i kanë dëgjuar kurrë pretendimet e Darwinizmit. Pjesa e dytë e këtij kundërshtimi është e vërtetë. Numri i njerëzve që mbrojnë Darwinizmin, duke qenë të mirinformuar është i kufizuar, por kjo pakicë e kufizuar përbëhet nga njerëz që drejtojnë idetë e shoqërisë në pjesën më të madhe të fushave. Ndikimi që kanë arritur të kenë në shoqëri vepron te një numër mjaft i madh njerëzish. Ata kanë mundësinë të imponojnë botëkuptimin e tyre te një pjesë e madhe e shoqërisë. Për shembull, profesorët më në zë të universiteteve, një pjesë e mirë e regjisorëve të famshëm të kinemasë dhe redaktorëve të shtëpive botuese, gazetave e revistave me famë botërore janë evolucionistë dhe, për pasojë, ateistë. Kjo është arsyeja që ajo pjesë e shoqërisë, të cilës ata i drejtohen, ndikohet prej mendimeve të tyre evolucioniste e antifetare. Si pasojë, lindin shoqëri, te të cilat këto ide perverse pranohen gjerësisht.

Ernst Mayr, biolog në universitetin e Harvardit dhe një prej evolucionistëve më të njohur në botë, përshkruan vendin që zë teoria e evolucionit në jetën e shoqërisë me këto fjalë:

Qysh nga koha e Darvinit, çdo njeri i ditur është i mendimit që njeriu ka rrjedhur nga majmuni... Evolucioni ka ndikim në çdo aspekt të mendimit njerëzor: në filozofi, metafizikë, etikë...<sup>131</sup>

Mbizotërimi i përgjithshëm i darvinistëve në jetën e

shoqërisë vepron si një lloj i fuqishëm "hipnoze" te njerëzit. Një pjesë e madhe, sidomos brezi i ri, me përvojë jete jo të mjaftueshme për të krijuar një pikëpamje mbi botën, qoftë edhe shumë sipërfaqësore, mund të mashtrohen lehtë nga ide të këtij lloji. Është jashtëzakonisht e lehtë t'i përpunosh mendjet e këtyre njerëzve, sipas dëshirës, nëpërmjet revistave, filmave, pjesëve teatrale apo videoklipeve muzikore dhe, më e rëndësishmja, nëpërmjet edukimit që marrin nëpër shkolla. Ky ndikim është arsyeja që prej 150 vjetësh, shumë njerëz besojnë se teoria e evolucionit është e vërtetë, pavarësisht nga mashtrimet dhe karakteri i saj joshkencor. (Për më tepër hollësi mbi karakterin joshkencor të teorisë së evolucionit, shih librin Gjunjëzimi i Evolucionit, i të njëjtit autor. Ky libër është përkthyer edhe në gjuhën shqipe.)

Në qoftë se e vini re, propaganda antifetare rrallëherë zhvillohet haptazi në ditët tona. Askush nuk sugjeron hapur se askush nuk duhet të ketë fe, por në të njëjtën kohë, për këtë qëllim, përdoren metoda të fshehta, të pakapshme në pamje të parë. Vënia në lojë e fesë, lëndëve fetare apo njerëzve të njohur për besimin e tyre fetar, si dhe përdorimi i fjalëve që nënkuptojnë mospranimin e ekzistencës së Zotit, fatit dhe fesë në tekstet e këngëve, në romane, filma, gazeta dhe anekdota, janë vetëm disa prej këtyre metodave të fshehura.

Subjektet e Darwinizmit, nga ana tjetër, janë veglat më të zakonshme të propagandës antifetare. Madje edhe në çështjet që s'kanë të bëjnë fare me to, theksohet gënjeshtria se paraardhësit tanë janë majmunët. Pretendimet e teorisë së evolucionit mund t'i gjes, po të dish të lexosh midis rreshtave, edhe në analizën e psikologjisë njerëzore. Në këtë mënyrë, lindin shoqëri që nuk i kushtojnë rëndësi fesë dhe përgjegjësisë morale. Njerëzit që nuk besojnë apo nuk kanë frikë nga Zoti, nuk njohin kufij në asnjë çështje dhe fillojnë të jetojnë si kafshët, nga të cilat ata mendojnë se e kanë prejardhjen. Nuk mund të presësh nga këta njerëz të ruajnë pastërtinë morale, sepse ata mendojnë se nuk ekzistojnë kufij që duhet të respektohen. Ata tregohen të gatshëm për të bërë çfarëdo lloj veprimi

të pamoralshëm, përsa kohë që mund ta bëjnë larg syve të botës. Në ditët tona, kapërcimi gjithmonë e më shumë i kufirit të asaj që është e lejuar dhe përhapja e një mentaliteti që s'i merr parasysh vlerat morale dhe urdhëresat e Zotit, janë pasojë e sugjerimeve të Darwinizmit. Njerëzit që e shohin veten të lirë nga kufizimet dhe besojnë se nuk do t'i japin llogari askujt, janë të prirur për shthurje. Të rinj e të reja u rrëfejnë gazetave hollësitë më të imta për jetën e tyre seksuale, të cilat botohen nga gazetatat dhe lexuesit nuk reagojnë. Tradhëtia bashkëshortore që përshkruhet e nxitet nga media, është kthyer në një veprim që të gjithëve u duket më se i zakonshëm. Po të vërehet me kujdes, pas vrasjeve, prostitucionit, gënjeshtreve, mashtrimeve, marrjes e dhënies së ryshfeteve, shkurt, në themel të të gjitha sjelljeve imorale, shihet qartë mungesa e fesë. Mënyra më e efektshme për të përhapur këtë mungesë feje ka qenë ndikimi i dhunshëm i gënjeshtres së Darvinit se "qeniet njerëzore u krijuan si rezultat i rastësisë".

Ken Ham, autor i librit "The Lie: Evolution" (Gënjeshtër: Evolucion), diskuton mungesën e fesë që solli Darwinizmi dhe thotë:

Nëse mohoni Zotin dhe e zëvendësoni Atë me një besim tjetër, i cili në vend të Zotit vë rastësinë, nuk do të keni parime bazë që të vendosin se çfarë është e drejtë e çfarë është gabim. Rregullat i bën si t'i duash ti. Nuk ka gjëra absolute, as parime, të cilave duhet t'u përmbahesh. Njerëzit do t'i vendosin vetë rregullat e tyre.<sup>132</sup>

Evolucionisti i mirënjohur Theodious Dobzhanski pranon se ideja e "përzgjedhjes natyrore", parimi bazë i Darwinizmit, sjell një shoqëri moralisht të degjeneruar:

Përzgjedhja natyrore mund të favorizojë egoizmin, burracakërinë, mashtrimin dhe shfrytëzimin, kurse etika e grupit, në pothuajse të gjitha shoqëritë, ka prirjen të kundërveproje apo të ndalojë një sjellje të tillë "të natyrshme" dhe t'u thurë lavde të kundërtave të tyre: mirësisë, bujarisë e madje edhe vetësakrifikimit për të mirën e anëtarëve të tjerë të fisit apo kombit, ose për të mirën e vetë njerëzimit.<sup>133</sup>

Po të hedhim sytë përreth, mund të vërejmë menjëherë

gjurmët e shkatërrimit më të rëndësishëm të shkaktuar nga morali darvinist. Mendimi se zhvillimi dhe qytetërimi janë rezultat i jetës së ndarë nga njëri-tjetri, pa detyrime për ndihmë reciproke, devotshmëri dhe respekt, po u imponohet njerëzve e shoqërive. Sugjerimi se një rezultat i tillë duhet të pranohet për një prodhueshmëri e zhvillim më të lartë, ndeshet shumë shpesh, por, në të vërtetë, kjo vjen si rezultat i uljes së njerëzve në "stadin e kafshëve" dhe jo si rezultat i zhvillimit të qytetërimit të arritur prej tyre. E vërteta qëndron se njeriu nuk është një lloj kafshe dhe nuk erdhi në jetë nga ndonjë kafshë. Njeriu, të cilin Zoti e krijoi dhe e pajisi me inteligjencë, ndërgjegje dhe shpirt, është, në sajë të këtyre cilësive, një krijesë krejt e ndryshme nga gjallesat e tjera, por nën ndikimin e magjisë së moralit materialist-darvinist, qeniet njerëzore i harrojnë këto cilësi dhe e ulin veten deri në zemërngushtësi, imoralitet dhe në një mungesë vetëdijeje që nuk ndeshet as te kafshët. Pastaj thonë: "Ne nga kafshët e kemi prejardhjen, ndaj edhe cilësitë tona janë trashëgim gjenetik prej tyre." Me këtë, ata kanë për qëllim të përgatisin një bazë "psedoshkencore" për mungesën e vullnetit dhe ndërgjegjes te vetvetja. Shumë shkencëtarë darvinistë bihejvioristë marrin këtë logjikë si pikënisje dhe dalin me pretendimin se shfaqja e prirjes për krim te qeniet njerëzore është trashëgim nga paraardhësit e tyre, kafshët. Evolucionisti i famshëm Stephan Jay Gould e nxjerr këtë pretendim, në fillim të sugjeruar prej fizikantit italian Lambrozo, në librin e tij "Ever Since Darwin":

Teoritë biologjike mbi kriminalitetin zor se mund të thuhet se ishin të reja, por Lambrozo i dha argumentit një kthesë të re evolucionare. Kriminalët e lindur nuk janë thjesht të çmendur apo të sëmurë; ata janë, me plot kuptimin e fjalës, kthim prapa në një stad të mëparshëm evolucionari. Tiparet e trashëguara nga paraardhësit tanë primitivë mbeten në repertorin tonë gjenetik. Disa njerëz të pafat lindin me një numër jashtëzakonisht të madh të këtyre tipareve të të parëve. Sjellja e tyre mund të kishte qenë e përshtatshme në shoqëritë primitive të së kaluarës, ndërsa sot, ne i vëmë vulën e krimit. Ne

mund të na vijë keq për kriminelët e lindur, sepse ata nuk e kanë veten në dorë, por nuk mund të tolerojmë veprimet e tyre.<sup>134</sup>

Me fjalë të tjera, sipas pretendimeve darviniste, vrasja e një njeriu nga një tjetër, shkaktimi i vuajtjeve, vjedhja etj., janë trashëgim i përcjellë gjenetikut nga paraardhësit e njeriut, majmunët. Është kjo arsyeja, sipas këtij pretendimi, që këto krime nuk i përkasin atij personi dhe shikohen si të justifikueshme. Siç mund të shihet nga këto pretendime, mënyra darviniste e të menduarit e nxjerr të pavlerë ndërgjegjen dhe forcën e vullnetit të njeriut dhe pranon se njeriu është një krijesë jointeligjente, e cila sillet sipas instiktit, njëlloj si kafshët. Sipas kësaj pikëpamjeje, ashtu sikurse luani i egër nuk e ndalon dot egërsinë brenda tij dhe nuk mund të shfaqë sjellje të virtytshme, si p.sh. të mposhtë inatin apo të tregojë falje dhe durim, po ashtu edhe njeriu sillet në të njëjtën mënyrë. Është e qartë se do të ketë një mungesë paqeje dhe sigurie, çrregullime, konflikte dhe përleshje në një shoqëri që strehon njerëz të tillë.

### **Mënyra e pamëshirshme dhe pesimiste e jetesës që ka propozuar Darwinizmi për njerëzimin**

Sipas darvinistëve dhe materialistëve, gjithësia e tërë, duke përfshirë edhe qeniet njerëzore, është vepër e kaosit dhe rastësisë. Me rritjen e ndikimit të kësaj pikëpamjeje në shoqëri, shfaqen njerëz të papërgjegjshëm, të cilët besojnë se janë krejt të pakufizuar.

Një njeri që nuk qëllime në jetë, është moskokëçarës, i pandjeshëm, nuk ndikohet nga asgjë, nuk e përdorë ndërgjegjen e tij dhe nuk njeh rregulla e kufij. Ai nuk mund të zotërojë virtyte apo cilësi të mira. Në këndvështrimin e tij pervers, si kafshë e zhvilluar që është, në këtë botë ai duhet të kërkojë ushqim dhe të shumohet në të njëjtën mënyrë si krijesat e tjera të gjalla dhe, pas plotësimit të disa nevojave, duhet të gjejë sa më shumë dëfrim e kënaqësi që të jetë e mundur dhe të presë vdekjen. Mund të shihet se, edhe pse shumica e njerëzve nuk janë në dijeni të hollësive të Darwinizmit, ata jetojnë jetën që parashikoi Darwinizmi për njerëzimin.

Për shkak të jetës mizore, së cilës një ditë do t'i vijë fundi, këta njerëz i pushton depresioni, pesimizmi dhe mungesa e shpresës. Mendimi se gjithçka do të mbarojë me vdekjen e ata do të shndërrohen në asgjë, i bën këta njerëz të mos jenë të lumtur e të mbyllen në vetvete. Një nga arsyet për vetvrasjet, problemet psikologjike dhe depresionet është ndikimi negativ i magjisë darviniste mbi psikologjinë njerëzore.

Richard Dawkins, një prej mbrojtësve më të tërbuar të evolucionit në kohën tonë, jep një shembull të kësaj. Ai pretendon se qeniet njerëzore janë makineri gjenesh dhe se e vetmja arsye për ekzistencën e tyre është që t'ia kalojnë këto gjene brezave pasardhës. Sipas mendimit të Dawkins, nuk ka qëllim tjetër as për ekzistencën e gjithësisë, as për atë të njeriut. I gjithë universi dhe qeniet njerëzore janë produkte të kaosit e rastësisë. Njerëzit që mashtrohen nga një pretendim i tillë bien shumë lehtë pre e depresionit dhe gjendjes së pashpresë. Ai që beson se i vetmi qëllim i jetës është që t'u përcjellë brezave të ardhshëm gjenet e tij, se gjithçka mbaron me vdekjen, se asgjë që bën ai në botë nuk ka kuptim, se miqësia, dashuria, mirësia dhe bukuria nuk kanë vlerë, patjetër do të mendojë se jeta është mizore dhe e panevojshme dhe nuk do të jenë në gjendje të gjejë kënaqësi në asgjë. Në parathënien e librit të tij "Duke shpërndarë ylberin", Dawkins pohon efektin negativ që shkakton te njerëzit pretendimi i tij lidhur me qëllimin e jetës njerëzore:

Një botues i huaj i librit tim të parë e pohoi se **nuk e kishte zënë dot gjumi për tri net**, pasi e kishte lexuar. Kaq i tronditur ishte ndjerë nga ajo që ai e kuptonte si **mesazhin e ftohtë e të zymtë që përcillte libri!** Të tjerë më kanë pyetur se si duroj që zgjohem në mëngjes. Një mësues nga një vend i largët më shkroi duke më qortuar se një nxënëse i kishte shkruar me lot në sy pas leximit të të njëjtit libër, sepse e kishte bindur se jeta ishte e kotë dhe e paqëllimtë. Ai e kishte këshilluar të mos ia tregonte librin asnjërit prej shokëve e shoqeve të saj, se mos u ngjitej edhe atyre i njëjti **pesimizëm nihilist**. Akuzime të ngjashme për dëshpërim të kotë, për dhënien e një mesazhi të thatë e të zymtë bëhen shpesh

kundër shkencës në përgjithësi dhe shkencëtarët e kanë të lehtë t'i marrin me të mirë. Kolegu im Piter Atkins e nis librin e tij "Ligji i dytë" (1984) në këtë mënyrë:

Ne jemi bijtë e kaosit dhe struktura e thellë e ndryshimit është kalbësirë. **Në rrënjë ka vetëm korrupsion dhe valë të pandalshme të kaosit. Synime s'ka më;** ajo ç'ka ka mbetur është drejtimi. **Kjo është zymtësia që na duhet të pranojmë,** ndërsa vështrojmë ngultazi thellë e me gjakftohtësi në zemër të gjithësisë.<sup>135</sup>

Një tjetër darvinist, i cili doli me idenë se jeta s'ka kuptim dhe bëri që jeta të shihet me pesimizëm, ishte filozofi gjerman Niçe (Nietzsche), tezat e të cilit për superioritet racor siguruan një përkrahje filozofike për Hitlerin. Mendimi i paraqitur nga Niça, i njohur si "nihilizmi" ose "asgjëizmi", në thelb është ky: Njeriu duhet të ketë një arsye që të jetojë, por ky qëllim, sipas Niçes që e mohonte ekzistencën e Zotit, s'ka të bëjë fare me krijimin e njeriut nga Zoti. Për këtë arsye, në filozofinë e Niçes, njeriu vazhdimisht kërkon një qëllim, por nuk është në gjendje ta gjejë një të tillë, ndaj përjeton pesimizmin dhe ndjenjën e të qenurit i pashpresë, që lind nga kjo. Ajo çka duhet bërë, është të kërkohet qëllimi prapa ekzistencës së njeriut, por nëse, ashtu si Niça, një njeri e mohon plotësisht qëllimin bazë dhe nis e kërkon një qëllim jashtë rrezes së kësaj të vërtete, atëhere sigurisht që ai nuk do të jetë në gjendje ta gjejë atë. Le të shtojmë këtu se Niçe vdiq i çmendur.

Shoqëritë që harrojnë se Zoti i ka krijuar për një qëllim të caktuar janë të destinuara pashmangshmërisht të pësojnë një rënie morale e shpirtërore. Pasuria, mirëqenia dhe zhvillimi ekonomik në asnjë mënyrë nuk u sjell këtyre njerëzve paqe dhe siguri. Shumë gjëra i shtyjnë njerëzit që nuk e dëgjojnë zërin e arsyes dhe e shohin veten si krijesa pa kufizime e pa qëllime në jetë, të ndjehen fatkeqë, të pashpresë dhe pesimistë.

Kurse një njeri që beson te Zoti dhe te jeta e ardhshme është i vetëdijshëm se për çfarë qëllimi përfundimtar e të rëndësishëm po jeton. Ai rron me gëzimin e shpresën se do të fitojë mëshirën e Zotit. Për çfarëdo që t'i ndodhë, ai falenderon Zotin: është kjo arsyeja që ai nuk bie kurrë pre e pesimizmit dhe gjendjes së pashpresë.



PERFUNDÏM

## Moçali i Darwinizmit duhet tharë

**G**jatë gjithë historisë ka pasur luftra, shtypje, vrasje dhe konflikte, por shkakun që numri dhe shtrirja e këtyre fatkeqësive ka qenë kaq e madhe në shekullin e kaluar është velloja e rreme shkencore që u hodhi atyre përsipër Darwinizmi. Për shkak se pretendimet krejt të pabaza të Darwinizmit rreth natyrës shkonin paralel me shfaqjen e këtyre ideologjive, vrasësive, diktatorët dhe ideologët sadistë ia dolën mbanë të demonstrojnë se kishin të drejtë dhe ishin të justifikuar për politikën e tyre, sepse "ligji i natyrës, gjithashtu, vllente edhe për shoqëritë njerëzore".

Në ditët tona, teoria e evolucionit mbrohet ende për arsye filozofike dhe ideologjike. Kolonializmi që shpërtheu me teorinë e evolucionit në shekullin XIX, Gjermania naziste dhe Bashkimi Sovjetik tashmë i përkasin të kaluarës, por filozofia materialiste-darviniste që ishte baza e tyre absolute, mbrohet ende me pasion nga qarqe të caktuara dhe pasojat shkatërruese të kësaj filozofie ende vazhdojnë të ndjehen në të gjithë botën.

Pavarësisht nga fakti se është evolucionist, Kenet J. Hsy ka shkruar kështu për katastrofat, drejt të cilave e ka çuar Darwinizmi njerëzimin:

Ne ishim viktimë të një ideologjie shoqërore mizore, e cila kujton se konkurrenca mes individëve, klasave, kombeve dhe racave është **gjendja e natyrshme e jetës dhe se është, gjithashtu, e natyrshme që më i forti të shpronësojë më të dobëtin...** Unë mendoj se ligji i përzgjedhjes natyrore nuk është shkencë. Është një ideologji, madje shumë e ligë...<sup>136</sup>

Sigurisht që masa paraprake juridike e fizike duhet të merren, por këto masa paraprake vetëm sa i mbulojnë

plagët e hapura nga këto ideologji. Zgjidhja përfundimtare qëndron në një trajtim kulturor dhe shkencor. Me rënien e Darwinizmit, nga pikëpamja kulturore e shkencore, këto filozofi që e gjejnë forcën e burojnë prej tij, gjithashtu, do të zhduken. Kjo do të thotë çlirim i botës nga shtypja.

Për këtë arsye, një përgjegjësi e madhe bie mbi ata që kanë ndërgjegje, besim dhe njohuri për vlerat shpirtërore. Nuk është e drejtë të injorohen apo nënvlerësohen fatkeqësitë që i solli botës Darwinizmi, veçanërisht në shekullin e fundit dhe vuajtjet që përjetuan njerëzit dhe shoqëritë. Kushdo që e kupton sa urgjente është çështja, duhet të bëjë çfarë të mundet për një sulm kulturor për t'i dhënë fund këtij mashtrimi që zgjat qysh prej 150 vjetësh.

E vetmja gjë që mund t'i japë fund këtij mashtrimi në kuptimin e vërtetë të fjalës e që mund t'i japë një përgjigje pyetjes thelbësore që e bren njerëzimin, është jeta sipas moralit të Kuranit. Këtyre fatkeqësive do t'u vijë fundi, kur njerëzit t'i kthehen besimit të vërtetë, kur bukuria, dashuria, ngrohtësia, dhembshuria, drejtësia, devotshmëria, bashkëveprimi dhe toleranca që sjell Kurani në jetën e njerëzve të ndjehen e jetohen plotësisht. Ashtu siç thuhet në një nga vargjet e shenjta: "e vërteta do të vijë" dhe "gënjeshtra do të zhduket":



**Thuaj: "Erdhi e vërteta dhe u zhduk gënjeshtra. Gënjeshtra gjithnjë zhduket." (Kuran, Surja El-Isra: 81)**

## SHENIME

- 1 Robert Wright, *The Moral Animal*, Vintage Books, New York: 1994, fq.7
- 2 Anton Pannekoek, *Marxism and Darwinism*, Translated by Nathan Weiser, Chicago, Charles H. Kerr & Company, 1912, <http://csf.colorado.edu/psn/marx/Other/Pannekoek/Archive/1912-Darwin/>
- 3 Theodore D. Hall, *The Scientific Background of the Nazi "Race Purification" Program*, <http://www.trufax.org/avoid/nazi.html>
- 4 Francis Darwin, *The Life and Letters of Charles Darwin*, D. Appleton and Co., 1896, vol. 2, fq.294
- 5 Stephen Jay Gould, *The Mismeasure of Man*, W.W. Norton and Company, New York, 1981, fq. 72
- 6 Jacques Barzun, *Darwin, Marx, Wagner*, Garden City, N.Y.: Doubleday, 1958, fq.94-95, cituar në librin e Henry M. Morris, *The Long war Against God*, Baker Book House, 1989, fq. 70
- 7 A.E. Wilder-Smith, *Man's Origin Man's Destiny*, The Word for Today Publishing, 1993, fq.166
- 8 Charles Darwin, *The Descent of Man*, botimi i dytë, New York, A.L. Burt Co., 1874, fq. 178
- 9 Charles Darwin, *The Descent of Man*, botimi i dytë edition, New York, A. L. Burt Co., 1874, fq. 171
- 10 Godfrey Lienhardt, *Social Anthropology*, Oxford University Press, fq. 11
- 11 Benjamin Farrington, *What Darwin Really Said*, London: Sphere Books, 1971, fq. 54-56
- 12 James Ferguson, *"The Laboratory of Racism"*, *New Scientist*, vol. 103, (Shtator 1984, fq. 18)
- 13 Lalita Prasad Vidyarthi, *Racism, Science and Pseudo-Science*, Unesco, France, Vendôme, 1983, fq. 54
- 14 David N. Menton, Ph.D., *The Religion of Nature: Social Darwinism*, St. Louis MetroVoice, September 1994, Vol. 4, Numër. 9
- 15 Stephen Jay Gould, *Ever Since Darwin*, W. W. Norton & Company, New York 1992, fq. 217
- 16 Stephen Jay Gould, *Ever Since Darwin*, W. W. Norton & Company, New York 1992, fq. 220
- 17 Alaeddin fiemel, *Irak ve Irkçilik Düşüncesi (Ideja e racës dhe Racizmi)*, Ankara: Bilim ve Sanat Yayınları, 1993, fq. 67-68
- 18 Thomas Gossett, *Race: The History of an Idea in America*, Dallas: Southern Methodist University Press, 1963, fq.81 Cituar në Alaeddin fiemel, *Irak ve Irkçilik Düşüncesi (Ideja e racës dhe Racizmi)*, Ankara: Bilim ve Sanat Yayınları, 1993, fq. 68
- 19 Jacques Attali, 1492, Librairie Arthème Fayard, 1991, fq.197
- 20 François de Fontette, *Le Racisme (Racism)*, botimi i gjashtë, Presses Universitaires de France, 1988, fq. 40-41
- 21 James Joll, *Europe Since 1870: An International History*, Penguin Books, Middlesex, 1990, fq. 102-103
- 22 Kenneth J. Hsü., *"Darwin's Three Mistakes"*, *Geology*, vol. 15, April 1987, fq. 377
- 23 Süleyman Kocabalı, *Hindistan Yolu ve Petrol Urunu Yayınlılar: Türkiye ve İngiltere (Kruza për në Indi dhe çfarë është bërë për hir të naftës: Turqia dhe Britania)*, I.baski, İstanbul: Vatan Yayınları, 1985, fq. 231
- 24 Francis Darwin, *The Life and Letters of Charles Darwin*, Vol.I, 1888. New York D. Appleton and Company, fq. 285-286
- 25 Henry M. Morris, *The Long War Against God*, Baker Book House, 1989, fq. 70
- 26 Henry M. Morris, *The Long War Against God*, Baker Book House, 1989, fq. 71
- 27 Thomas Gossett, *Race: The History of an Idea in America*, Dallas: Southern Methodist University Press, 1963, fq.188
- 28 Alaeddin fiemel, *Irak ve Irkçilik Düşüncesi (Ideja e racës dhe Racizmi)*, Ankara: Bilim ve Sanat Yayınları, 1993, fq. 85-90
- 29 Henry Fairfield Osborn, *"The Evolution of Human Races"*, *Natural History*, April 1980, fq. 129 – ribotuar në botimet nga Janar/Shkurt 1926
- 30 François de Fontette, *Le Racisme*, botimi i gjashtë, Presses Universitaires de France, 1988, fq. 101
- 31 François de Fontette, *Le Racisme*, botimi i gjashtë, Presses Universitaires de France, 1988, fq. 105
- 32 Jani Roberts, *How New-Darwinism Justified Taking Land From Aborigines and Murdering Them in Australia*, <http://www.gn.apc.org/inquirer/ausrace.html>
- 33 Jani Roberts, *How New-Darwinism Justified Taking Land From Aborigines and Murdering Them in Australia*, <http://www.gn.apc.org/inquirer/ausrace.html>
- 34 Jani Robert, *How New-Darwinism Justified Taking Land From Aborigines and Murdering Them in Australia*, <http://www.gn.apc.org/inquirer/ausrace.html>
- 35 Creation Ex Nihilo, Vol 14, Numër. 2, Mars-Maj 1992, fq. 17
- 36 Philadelphia Daily News, 28 prill 1997
- 37 Philips Verner Bradford, *Harvey Blume, Ota Benga, The Pygmy in the Zoo*, Canada, October 1993 fq. 269
- 38 Philips Verner Bradford, *Harvey Blume, Ota Benga, The Pygmy in the Zoo*, Canada, October 1993, fq. 267
- 39 Philips Verner Bradford, *Harvey Blume, Ota Benga, The Pygmy in the Zoo*, Canada, October 1993, fq. 266
- 40 Philips Verner Bradford, *Harvey Blume, Ota Benga, The Pygmy in the Zoo*, Canada, October 1993, fq. 264
- 41 Philips Verner Bradford, *Harvey Blume, Ota Benga, The Pygmy in the Zoo*, Canada, October 1993, fq. 259
- 42 Bryan Appleyard, *Brave New Worlds*, Harper Collins Publishers, London 1999, fq. 49-50
- 43 Alaeddin fiemel, *Irak ve Irkçilik Düşüncesi (Ideja e racës dhe Racizmi)*, Ankara: Bilim ve Sanat Yayınları, 1993, fq.62-6
- 44 *War Against Religion* <http://www.geocities.com/Heartland/Meadows/1733/book2-ch3.html>
- 45 J. Tenenbaum, *Race and Reich*, Twayne Pub., New York, fq. 211, 1956; cituar nga Jerry Bergman, *Darwinism and the Nazi Race Holocaust*, <http://www.trueorigin.org/holocaust.htm>
- 46 L.H. Gam, *"Adolf Hitler, The Complete Totalitarian"*, *The Intercollegiate Review*, Fall 1985, fq. 24; cituar në librin e Henry M. Morris, *The Long war Against God*, Baker Book House, 1989, fq. 78
- 47 K. Ludmerer, *Eugenics, Inc: Encyclopedia of Bioethics*, Edited by Mark Lappe, The Free Press, New York, fq. 457, 1978; cituar nga Jerry Bergman, *Darwinism and the Nazi Race Holocaust*, [www.trueorigin.org/holocaust.htm](http://www.trueorigin.org/holocaust.htm)
- 48 G. Stein., *Biological science and the roots of Nazism*, *American Scientist* 76(1): fq. 54, 1988; cituar nga Jerry Bergman, *Darwinism and the Nazi Race Holocaust*, <http://www.trueorigin.org/holocaust.htm>
- 49 Adolf Hitler, *Mein Kampf*, München: Verlag Franz Eher Nachfolger, 1993, fq. 44, 447-448; cituar nga A.E. Wilder Smith, *Man's Origin Man's Destiny*, The Word For Today Publishing 1993, fq. 163, 164
- 50 P. Weindling, *Health, Race and German Policies Between National Unification and Nazism 1870-1945*, Cambridge University Press, Cambridge, MA, 1989, cituar nga Jerry Bergman, *Darwinism and The Nazi Race Holocaust*, [www.trueorigin.org/holocaust.htm](http://www.trueorigin.org/holocaust.htm)
- 51 Theodore D. Hall, *The Scientific Background of the Nazi "Race Purification" Program*, <http://www.trufax.org/avoid/nazi.html>
- 52 Theodore D. Hall, *The Scientific Background of the Nazi "Race Purification" Program*, <http://www.trufax.org/avoid/nazi.html>
- 53 John J. Michalczuk (editor), *Nazi Medicine: In The Shadow of The Reich (film dokumetar)*, First Run Features, New York, 1997
- 54 George J. Stein., *"Biological Science and the Roots of Nazism"*, *American Scientist*, vol. 76, (Janar/Shkurt 1988), fq. 52
- 55 Sir Arthur Keith, *Evolution and Ethics*, New York: G.P. Putnam's Sons, 1947, fq. 14
- 56 Robert Clark, *Darwin: Before and After*, Grand Rapids International Press, Grand Rapids, MI, 1958, fq.115
- 57 A. Keith, *Evolution and Ethics*, G. P. Putnam's Sons, New York, fq. 230, 1946, cituar by Jerry Bergman, *Darwinism and the Nazi Race Holocaust*, [www.trueorigin.org/holocaust.htm](http://www.trueorigin.org/holocaust.htm)
- 58 Francis Schaeffer, *How Shall We Then Live?*, Old Tappan, N.J.: Revell, 1976, fq. 151; cituar nga Henry M. Morris, *The Long war Against God*, Baker Book House, 1989, fq. 78
- 59 A. Hitler, *Hitler's Secret Conversations 1941-1944*, With an introductory essay on The Mind of Adolf Hitler by H.R. Trevor-Roper, Farrar, Straus and Young, New York, fq. 117, 1953; cituar nga Jerry Bergman, *Darwinism and the Nazi Race Holocaust*, <http://www.trueorigin.org/holocaust.htm>
- 60 Daniel Gasman, *The Scientific Origins of National Socialism: Social Darwinism in Earnest Haeckel and the German Monist League*, New York: American Elsevier Press, 1971, fq. 168
- 61 Robert E.D. Clark, *Darwin: Before and After*, London: Paternoster Press, 1948, fq. 115, cituar nga Henry M. Morris, *The Long War Against God*, Baker Book House, 1989, fq. 81
- 62 Denis Mack Smith, *Mussolini*, fq. 14
- 63 John P. Diggins, *Mussolini and Fascism*, Princeton University Press, 1972, fq. 15
- 64 Cagdas Liderler Ansklopedisi, Vol. 2, fq. 669
- 65 James Joll, *Europe Since 1870: An International History*, Penguin Books, Middlesex, 1990, fq. 164
- 66 M.F. Ashley-Montagu, *Man in Process* (New York: World. Pub. Co. 1961) fq. 76, 77 cituar nga Bolton Davidheiser, W E Lammers (ed) *Scientific Studies in Special Creationism*, 1971, fq. 338-339
- 67 A.E. Wiggam, *The New Dialogue of Science*, Garden Publishing Co., Garden City, NY, fq. 102, 1922; cituar nga Jerry Bergman, *Darwinism and the Nazi Race Holocaust*, <http://www.trueorigin.org/holocaust.htm>
- 68 Robert Clark, *Darwin: Before and After*, Grand Rapids International Press, Grand Rapids, MI, 1958, fq. 115-116; Cituar nga Jerry Bergman, *Darwinism and the Nazi Race Holocaust*, <http://www.trueorigin.org/holocaust.htm>

- 69 Jerry Bergman, *Darwinism and the Nazi Race Holocaust*, <http://www.trueorigin.org/holocaust.htm>
- 70 Earnest Haeckel, *The History of Creation: Or the Development of the Earth and Its Inhabitants by the Action of Natural Causes*, Appleton, New York, 1876, fq. 170; cituar nga Jerry Bergman, *Darwinism and the Nazi Race Holocaust*, <http://www.trueorigin.org/holocaust.htm>
- 71 Theodore D. Hall, *The Scientific Background of the Nazi "Race Purification" Program*, <http://www.trufax.org/avoid/nazi.html>
- 72 Marshall Hall, *Hitler, Lenin, Stalin, Mao et al: The Role of Darwinian Evolutionism in Their Lives*, <http://www.fixedearth.com/hlsm.html>
- 73 Max Nordau, *The Philosophy and Morals of War*, North American Review 169 (1889):794 cituar nga Richard Hofstadter, *Social Darwinism in American Thought*, Boston: Beacon Press, 1955, fq. 171
- 74 Tempo Magazine, 14 Korrik 1991
- 75 <http://chefsseite.tx.org/>
- 76 Sabah Daily, 12 Gusht 2000
- 77 San Francisco Examiner, 1 prill 1997
- 78 Conway Zirkle, *Evolution, Marxian Biology and the Social Scene*, Philadelphia: University of Pennsylvania Press, 1959, fq. 85-87
- 79 Conway Zirkle, *Evolution, Marxian Biology and the Social Scene*, Philadelphia: University of Pennsylvania Press, 1959, fq. 85-87
- 80 Conway Zirkle, *Evolution, Marxian Biology and the Social Scene*, Philadelphia: University of Pennsylvania Press, 1959, fq. 85-87
- 81 Stephen Jay Gould, *Ever Since Darwin*, W. W. Norton & Company, New York 1992, fq. 26
- 82 Friedrich Engels, *Socialism: Utopian and Scientific*, Foreign Languages Press, Peking 1975, fq. 67
- 83 Gertrude Himmelfarb, *Darwin and the Darwinian Revolution*, London: Chatto & Windus, 1959, fq. 348-9
- 84 Friedrich Engels, *Socialism: Utopian and Scientific*, Foreign Languages Press, Peking 1975, fq. 67
- 85 Conway Zirkle, *Evolution, Marxian Biology and the Social Scene*, (University of Pennsylvania Press, 1959), fq.85- 86
- 86 Tom Bethell, »Burning Darwin to Save Marx«, Harper's Magazine, (December 1978), fq.37
- 87 Karl Marx Biyografi, Öncü Yayinevi, fq. 368
- 88 John N. Moore, *The Impact of Evolution on the Social Sciences*, Impact No. 52, [www.icr.org/pubs/imp/imp-052.htm](http://www.icr.org/pubs/imp/imp-052.htm)
- 89 Marshall Hall, *Hitler, Lenin, Stalin, Mao et al: The Role of Darwinian Evolutionism in Their Lives*, <http://www.fixedearth.com/hlsm.html>
- 90- Alan Woods and Ted Grant, *Reason in Revolt: Marxism and Modern Science*, London:1993
- 91- Kent Hovind, *The False Religion of Evolution*, <http://www.royalse.com/scroll/evolve/ndxng.html>
- 92- E. Yaroslavsky, *Landmarks in the Life of Stalin*, Moscow: Foreign Languages Publishing House, 1940, fq. 8.; Cituar nga Paul G. Humber, *Stalin's Brutal Faith*, Vital articles on Science/Creation Tetor 1987, Impact No. 172
- 93 E. Yaroslavsky, *Landmarks in the Life of Stalin*, Moscow: Foreign Languages Publishing House, 1940, fq. 8.; cituar nga Paul G. Humber, *Stalin's Brutal Faith*, Vital articles on Science/Creation Tetor 1987, Impact No. 172
- 94 K. Mehnert, *Kampf um Mao's Erbe*, Deutsche Verlags-Anstalt, 1977
- 95 Marshall Hall, *Hitler, Lenin, Stalin, Mao et al: The Role of Darwinian Evolutionism in Their Lives*, <http://www.fixedearth.com/hlsm.html>
- 96 Robert Milner, *Encyclopaedia of Evolution*, 1990 fq.81
- 97 Michael Ruse: *The Long March of Darwin*, New Scientist 103, 16 Gusht, 1984: 35; cituar nga Henry M. Morris, *The Long war Against God*, Baker Book House, 1989, fq.85-86
- 98 David Jorafsky, *Soviet Marxism and Natural Science*, New York: Columbia University Press, 1961, fq.4
- 99 Nicolas Werth, »Le Pouvoir soviétique et l'Eglise orthodoxe de la collectivisation à la Constitution de 1936«, Revue d'études comparatives Est-Quest nos. 3-4, 1993, fq.41-49 cited by Stéphane Courtois, Nicolas Werth, Jean-Louis Panné, Andrzej Paczkowski, Karel Bartosek, Jean-Louis Margolin, *The Black Book of Communism*, Harvard University Press, 1999, fq. 172
- 100 Samuel T. Francis, *The Soviet Strategy of Terror*, The Heritage Foundation, 1981, fq. 46
- 101 V. I. Lenin; *Collected Works*, botimi i katërt, Progress Publishers, Moscow, 1964, fq. 180
- 102 V. I. Lenin, *The Proletarian Revolution and The Renegade Kautsky* (Moscow: Foreign Languages Publishing House, 1952, fq. 32-33, 20)
- 103 V. I. Lenin, *Collected Works*, Moscow, Volume 35, fq. 238
- 104 V. I. Lenin, *Collected Works*, Vol. 24, fq. 38-41, Progress Publishers, Moscow, 1964.
- 105 V.I. Lenin, *Polnoe sobranie sochinenii*, Moscow, Gos.-izd-vo polit. Lit-ry, 1958-1966, 35: 311, cituar nga Stéphane Courtois, Nicolas Werth, Jean-Louis Panné, Andrzej Paczkowski, Karel Bartosek, Jean-Louis Margolin, *The Black Book of Communism*, Harvard University Press, 1999, fq. 59
- 106 Ann Arbor, Leon Trocki, *Terrorism or Communism*, University of Michigan Press, 1961, fq. 58
- 107 Protokoly zasedanii VSIK 4-sozyu, *Stenograficheski otchet* (Moscow, 1918), fq. 250
- 108 Harrison E. Salisbury, »Reading The Gulag Archipelago is like no other reading experience of our day,« Book-of-the-Month Club NEWS, Midsummer, 1974, fq. 4,5.
- 109 Russian Center for the Conservation and Study of Historic Documents, Moscow, 17/84/75/59, cituar nga Stéphane Courtois, Nicolas Werth, Jean-Louis Panné, Andrzej Paczkowski, Karel Bartosek, Jean-Louis Margolin, *The Black Book of Communism*, Harvard University Press, 1999, fq. 100
- 110 Quoted in V.I. Brovkin, *Behind the Front Lines of the Civil War: Political Parties and Social Movements in Russia*, 1918- 1922, Princeton: Princeton University Press, 1981, fq. 353, cituar nga Stéphane Courtois, Nicolas Werth, Jean-Louis Panné, Andrzej Paczkowski, Karel Bartosek, Jean-Louis Margolin, *The Black Book of Communism*, Harvard University Press, 1999, fq. 101
- 111 Krasnyi Mech, no.1 (18 August 1919), fq.1 cituar nga Stéphane Courtois, Nicolas Werth, Jean-Louis Panné, Andrzej Paczkowski, Karel Bartosek, Jean-Louis Margolin, *The Black Book of Communism*, Harvard University Press, 1999, fq. 102
- 112 Stéphane Courtois, Nicolas Werth, Jean-Louis Panné, Andrzej Paczkowski, Karel Bartosek, Jean-Louis Margolin, *The Black Book of Communism*, Harvard University Press, 1999, fq. 119
- 113 Quoted in Julian Gorkin, *Les Communistes contre la révolution espagnole*, Paris: Belfond, 1978, fq.181, cituar nga Stéphane Courtois, Nicolas Werth, Jean-Louis Panné, Andrzej Paczkowski, Karel Bartosek, Jean-Louis Margolin, *The Black Book of Communism*, Harvard University Press, 1999, fq. 342
- 114 Stéphane Courtois, Nicolas Werth, Jean-Louis Panné, Andrzej Paczkowski, Karel Bartosek, Jean-Louis Margolin, *The Black Book of Communism*, Harvard University Press, 1999, fq. 29
- 115 Stéphane Courtois, Nicolas Werth, Jean-Louis Panné, Andrzej Paczkowski, Karel Bartosek, Jean-Louis Margolin, *The Black Book of Communism*, Harvard University Press, 1999, fq. 470-471
- 116 Stéphane Courtois, Nicolas Werth, Jean-Louis Panné, Andrzej Paczkowski, Karel Bartosek, Jean-Louis Margolin, *The Black Book of Communism*, Harvard University Press, 1999, fq. 4
- 117 P.J. Darlington, *Evolution for Naturalists*, 1980, 243-244
- 118 Edward E. Ericson, Jr., »Solzhenitsyn - Voice from the Gulag«, *Eternity*, October 1985, fq. 23, 24.
- 119 Alaeddin fielen, Irk ve Irkçili Düflünçesi, Ankara: Belem ve Sanat Yayıncıları, 1993, fq. 61
- 120 Herbert Spencer, *Social Status*, 1850, fq. 414-415
- 121 *The Challenge of Facts and Other Essays, as quoted in Mason Drukmán, Community and Purpose in America: An Analysis of American Political Theory*, New York: McGraw- Hill, 1971, fq. 202.
- 122 R. Milner, *Encyclopedia of Evolution* 1990 fq. 412
- 123 Thomas F. Gossett, *Race: The History of an Idea in America*, Dallas: Southern Methodist University Press, 1963, fq. 170
- 124 Chauncey Depew, *My Memories of Eighty Years*, New York, 1922, fq.383-4
- 125 James J. Hill, *Highways of Progress*, New York, 1910, fq. 126, 137
- 126 Andrew Carnegie, *Autobiography*, Boston 1920, fq. 327, cituar nga Richard Hofstadter, *Social Darwinism in American Thought*, Boston: Beacon Press, 1955, fq. 45
- 127 Andrew Carnegie, *Wealth*, North American Review 148, 1889, s. 655-657, cituar nga Richard Hofstadter, *Social Darwinism in American Thought*, Boston: Beacon Press, 1955, fq. 45-46
- 128 Kenneth J. Hstü, »Darwin's Three Mistakes«, *Geology*, vol.14, June 1986, fq. 534
- 129 Bolton Davidheiser, W E Lemmerts (ed) *Scientific Studies in Special Creationism*, 1971 fq. 338-339.
- 130 H. Enoch, *Evolution or Creation*, 1966 fq.145
- 131 Ernst Mayr, »Interview«, *Omni*, March/April 1988, fq. 46; cituar nga Henry M. Morris, John D. Morris, *The Modern Creation Trilogy*, Vol. 3, fq. 12
- 132 Kenneth A. Ham, *The Lie Evolution*, Master Books, April 1997, fq. 84
- 133 Theodosius Dobzhansky, »Ethics and Values in Biological and Cultural Evolutions«, *Zygon*, the Journal of Religion and Science, as reported in Los Angeles Times, part IV (June 16, 1974), fq. 6
- 134 Stephen Jay Gould, *Ever Since Darwin*, W. W. Norton & Company, New York 1992, fq. 223
- 135 Richard Dawkins, *Unweaving The Rainbow*, Houghton Mifflin Company, Newyork, 1998, fq. IX)
- 136 Earthwatch, March 1989, fq. 17; cituar nga Henry M. Morris, *The Long War Against God*, Baker Book House, 1989, fq. 57

## LIBRA TE BOTUAR NGA HARUN JAHJA



## LIBRA TE RINJ

